



**RAPORT PËRFUNDIMAR MBI**  
**“ AUDITIMI FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIE MBI VEPRIMTARINË E**  
**USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË PYJEVE”**

<b>I</b>	Përmbajtja	1
<b>II</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	1-2
	1.Përshkrim i shkurtër Projektit të Auditimit	2-2
	2.Përshkrim i gjetjeve kryesore	2-6
	3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	6-9
	<b>HYRJE</b>	9-9
	1.Objekti i auditimit	9-9
	2.Qëllimi i auditimit	9-9
	3. Identifikimi i çështjes	9-9
	4.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9-9
	5.Përgjegjësitë e audituesve	9-9
	6.Kriteret e vlerësimit	10-10
	7.Standardet e Auditimit	10-10
	8.Metodat e auditimit	11-11
	9. Dokumentimi i auditimit	11-11
<b>III</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	12-12
	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	12-12
	2.Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	12-81
Pika 1	1.Mbi hartimin dhe Zbatimin e buxhetit të shtetit	13-23
Pika 2	Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe pagave	23-27
Pika 3	2.1. Auditimi i Pasqyrave financiare dhe plotësimi i formularëve të bilancit	27-40
	2.2. Inventarizimi i pronës shtetërore, paraqitja e tyre në pasqyrat financiare	46-54
Pika 4	4. Auditimi mbi masat e marra për mbrojtjen e pyjeve , inventarizimindhe dixhitalizimin e fondit pyjorë, përfshirë monitorimin dhe kontrollin e pyjeve.	54-63
Pika 5	5 Mbi auditimin e menaxhimit dhe mbarështimit të pyjeve, kontrollin dhe monitorimin subjekteve të licencuara në shfrytëzimin e pyjeve , mbikëqyrjen dhe zbatimin e akteve ligjore /nënligjorë, akteve administrative, politikat nga strukturat e kontrollit të pyjeve bashki dhe në zonat e mbrojtura.	63-81
Pika 6	<b>Të tjera gjatë auditimit</b>	-
<b>IV.</b>	<b>GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>	81-89
<b>V.</b>	<b>ANEKSE</b>	89-99



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

### I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

AKP është themeluar në vitin 2020 dhe ka një aktiviteti 2 vjeçar me një buxhet rreth 48 miljon lekë, me funksione kryesisht monitorues dhe menaxhues të bazës kombëtare mbi fondin pyjor.

-Nga detyrat që i atribuon ligji dhe kuadri rregullator, AKP është përgjegjëse për procesin:

a) inventarizimit të fondit pyjor dhe përditësimit të sistemit të integruar të informacionit

b) monitoron, kontrollon të drejtat e akorduara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore tek operatorët publike ose privatë, për shfrytëzimin e fondit pyjor, për sa i takon përputhshmërisë dhe respektimit të kriterëve.

c) monitoron, kontrollon veprimtarinë e strukturave të administrimit e të inspektimit në bashkitë, për sa i përket zbatimit dhe respektimit të legjislacionit në fuqi të planeve të miratuara, të cilat ndërhyjnë për marrjen e masave të detyrueshme në rastet kur evidentohen shkelje apo shmangie nga përmbajtja dhe kërkesat e tyre.

Veprimtaria kryhet në zbatim të:

VKM –së, nr. 570 datë. 17.07.2019 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve” ngarkojnë Agjencinë Kombëtare të Pyjeve për vlerësimin e gjendjes së pyjeve”, si dhe me Urdhrin nr.24, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve”;

Ligji. “Për Pyjet” Nr. 57/2020 datë 30.04.2020.

Dokumenti i Politikave Pyjore në Shqipëri 2019-2030 miratuar me VKM nr. 814, datë 31.12.2018.

Ligji nr. 10120, datë 23.04.2009 “Për mbrojtjen e Fondit të Bimëve Mjekësorë, Eterovajore e Tanifere Natyrore”, i ndryshuar dhe azhornuar me ligjin nr. 42/2013. Datë 14.02.2013.

Ligji nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullosor” të ndryshuar.

#### I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit

Veprimtaria kryhet në zbatim të:

VKM –së, nr. 570 datë. 17.07.2019 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve” ngarkojnë Agjencinë Kombëtare të Pyjeve për vlerësimin e gjendjes së pyjeve”, si dhe me Urdhrin nr.24, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve”;

Ligji. “Për Pyjet” Nr. 57/2020 datë 30.04.2020.

Dokumenti i Politikave Pyjore në Shqipëri 2019-2030 miratuar me VKM nr. 814, datë 31.12.2018.

Ligji nr. 10120, datë 23.04.2009 “Për mbrojtjen e Fondit të Bimëve Mjekësorë, Eterovajore e Tanifere Natyrore”, i ndryshuar dhe azhornuar me ligjin nr. 42/2013. Datë 14.02.2013.

Ligji nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullosor” të ndryshuar,

#### I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit

I.2. Auditimi i ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
I	Aktet nënligjore plotësuese në zbatim të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet” ende nuk janë miratuar, konkretisht mungojnë rreth 18	Fq 54-63	E Larte	Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa për identifikimin e të gjitha akteve



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

	VKM dhe udhëzime, ndër të tjera, si më poshtë: Në zbatim të nenit 5, pika 4, nuk është miratuar VKM pika c.Në zbatim të nenit 38 pika 8.			nënligjore që nuk janë miratuar dhe t'i kërkojë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit informacion mbi këto çështje.
2	Agjencia Kombëtare e Pyjeve nga auditimi rezultoi së është jashtë sistemit të inspektimit, kryesisht për shkak se nuk janë unifikuar me Inspektoratin Qendror praktikat e kontrollit dhe inspektimit në fondin pyjor kombëtar nga strukturat përgjegjëse në ushtrimin e kompetencave të tyre, sipas nenit 40 të ligjit nr.57/2020 për Pyjet. Për pasojë, kjo Agjenci për periudhën 2020-2022, nuk ka pasur kompetencat për të ushtruar veprimtari të mirëfilltë inspektuese. Paqartësia vet brenda ligjit si dhe mungesa e harmonizimit me ligje të tjera,ka bërë që funksionin e inspektimit të pyjeve ta realizojë Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, institucion ky nuk njihet si institucion monitorues inspektues sipas ligjit nr.57/2020.	<b>Fq 54-63</b>	<i>E Larte</i>	Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit si dhe me Inspektoratin Qendror, të marrë masa për unifikimin e praktikave të kontrollit dhe procesit të inspektimit në fondin pyjor.
3	Në lidhje me procesin inventarizimit të fondit pyjor konstatohet se inventari i fundit i përket vitit 2018 e për rrjedhojë rezulton se nuk ka nisur cikli i radhës 8 vjeçar i riinventarizimit kombëtar të pyjeve, duke inventarizuar 25% çdo 2 vjet të fondit pyjor, në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet. Nga krahasimi i inventarëve 2003-2018, nga vëllimi total drunor, është hequr për 15 vjet një vëllim prej 32.9 mln m <sup>3</sup> (përfshi materialin drusor te djegur nga zjarret ne pyll), pra 2.2 mln/m <sup>3</sup> /vit, ose dyfishin e mundësisë vjetore të shfrytëzimit.	<b>Fq 54-63</b>	<i>E mesme</i>	Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa që të nisë procesin e inventarizimit të fondit pyjor, duke parashikuar në buxhetin e vitit 2023 të gjitha kostot e mundshme, përfshirë ngritjen e agjencive rajonale të pyjeve, për përfundimin e procesit.



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

4	<p>Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor (RKFP) nuk është i plotë, pasi në këtë fond pyjor nuk janë të pasqyruara ato sipërfaqe pyjorë të cilat i kanë kaluar në pronësi Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet VKM-së Nr. 707, datë 21.11.2018 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Shkodër-Fier. Sipas nenit 2 të ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”.</p>	<b>Fq 54-63</b>	<i>E meme</i>	<p>Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa për përditësimin e regjistrit kombëtar të fondit pyjor me sipërfaqet që i kanë kaluar në administrim Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.</p>
5	<p>Nga auditimi rezultoi se në Agjencia Kombëtare të Pyjeve, nuk ka gjete zbatimi Vkm-ja nr.570 datë 17.7.2019 “Për Krijimin organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, pika 5.4 “Në lidhje me menaxhimin e pyjeve pika ç) -Nga 385 ekonomi pyjore në gjithë vendin vetëm (20 %) prej tyre janë të pajisura me plane mbarështimi apo plane që janë në proces.</p> <p>-Në 21 bashkitë që kanë mbuluar 4% - 100% të territorit me plane mbarështimi, pjesa tjetër prej 40 bashkish nuk kanë hartuar asnjë plan mbarështimi të paktën 10 vitet e fundit,</p> <p>veprime në kundërshtim të ligjit 57/2020, neni 11. Hartimi i planit të mbarështimit është një detyrim ligjor për pronarët e pyjeve.</p>	<b>Fq 63-81</b>	<i>E Lartë</i>	<p>Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në bashkëpunim me ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe drejtoritë përkatëse të marrin masa që në çdo rast planet e menaxhimit të përcillen parandë AKP, për dhënie mendimi, deri në finalizimet procesit të hartimit dhe miratimit të planeve të mbarështimit.</p>
6	<p>Procesi i dixhitalizimi të fondit pyjor në sistemin ALFIS është i paplotë, pasi rezulton se është pasqyruar pjesërisht vetëm fondi pyjor nën administrimin e bashkive dhe jo sipërfaqet pyjore të ministrive dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Sipërfaqja totale kombëtare e dixhitalizuar është</p>	<b>Fq 63-81</b>	<i>E mesme</i>	<p>Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në bashkëpunim me AKSHI-n, të marrë masa për ngritjen e një grupi ekspertësh të fushë së pyjeve, specialistë IT dhe programues për analizimin e</p>



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

	<p>1.213.427,83 ha, (për 61 bashkitë). Në veçanti, sipërfaqet pyjore që preken nga investimet strategjike nuk janë të pasqyruara në ALFIS. Nga kontrolli i VKM-ve të miratuara sipas “Listave të transferimit të ngastrave pyjore kullimore në pronësi të bashkisë” për periudhën 2020-2021, rezulton me mospërputhje të konsiderueshme në zërat kadastral si “Kategoria e Përdorimit të Territorit”, “Pronësia”, “Sipërfaqja” etj.</p>			<p>popullimit të të dhënave të hasura me probleme dhe plotësimin e sistemit ALFIS me sipërfaqet që janë nën administrim të Agjencisë së Zonave të Mbrojtura dhe Ministrive.</p>
7	<p>Me vendimet e Komitetit të Investimeve Strategjike lihen detyra për heqjen nga fondi pyjor para marrjes në përdorim të sipërfaqes përkatëse apo ngarkimin e AKP-së me saktësimin e koordinatave apo verifikime të pronës. Po ashtu, kërkohet çregjistrimi nga kadastra dhe fondi pyjor, shoqëruar me detyrimin e subjektit përfitues që të paguajë vlerat përkatëse të pakësimit të volumit të lëndës drusore, të sipërfaqes që do të hiqet nga fondi pyjor si dhe pyllëzimin e një sipërfaqeje tjetër. Për këto detyra, rezulton se Agjencia Kombëtare e Pyjeve gjendet e përjashtuar nga këto procese, së pari ende nuk administron në mënyrë të plotë fondin pyjor, së dyti rezulton e përjashtuar nga proceset e kadastrës pyjore, sa i përket çregjistrimit, heqjes nga fondi pyjor dhe zëvendësimit, pasi kjo agjenci nuk harton/miratton asnjë akt administrativ mbi këto çështje dhe nuk informohet nga MTM mbi vendimet e Këshillit të Ministrave për heqjen nga fondi pyjor.</p>	<b>Fq 54-63</b>	<i>E Lartë</i>	<p>AKP të marrë masa që procedurat për heqjen nga regjistri i fondi pyjor të sipërfaqeve që preken nga investimet strategjike, t’i nisë vetëm pas administrimit të projekteve për zëvendësimit e këtyre sipërfaqeve dhe marrjes së konfirmimit nga MTM për nxjerrjen e akteve(VKM apo Ligji) për heqjen nga fondi pyjor.</p>
8	<p>Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe</p>	<b>Fq.40-46</b>	<i>E Lartë</i>	<p>Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e</p>



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

<p>Shërbimeve të Brendshme), për të 3 vitet 2020, 2021, 2022, nuk ishin hapur ditarët e analitikë dhe pasqyrat financiare të viteve 2020 dhe 2021 ishin përgatitur nga jashtë (extra kontabël).</p> <p>Kështu nuk ishin hapur, mungonin dhe nuk kryheshin veprime kontabël në ditarët e bankës, magazinës, të ardhurave dhe shpenzimeve, ditarin e veprimeve të ndryshme, ditari i pagave, dhe të gjithë ditarët e tjerë, analizat, centralizatori / libri i madh, në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 15, dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 28.si dhe llogaritë 214,215 218, në regjistër të aktiveve, veprime në kundërshtim me pikën 30, të Udhëzimit-it të Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.11.2011.</p>		<p>Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa dhe të hapë ditarët analitikë, si dhe teknikat e tjera të nxjerrjes së pasqyrave, centralizatori / libri i madh/mastro dhe mbi bazën e këtyre të përgatisë pasqyrat financiare të vitit 2022. Për pasqyrat financiare, të përgatiten inventarët dhe analizat sipas posteve të bilancit si dhe të krijohet e të mbahet regjistri i aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv.</p>
---	--	--

### A. KONKLUSIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT

#### **1.Opinion mbi auditimin financiar.**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve Tiranë për vitin e fundit ushtrimor 2021, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në to, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra .

*“Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të kundërt për llogaritë vjetore të subjektit AKP duke arritur në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2021”* të shprehura në bazën për opinion (trajtuar më poshtë).

**Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare, i kundërt.**



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

Ne audituam pasqyrat financiare të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve Tiranë, më datë 31.12.2021, mbështetur në standarde të kontabilitetit, ligjit mbi kontabilitetin, udhëzimeve e kushteve të vendosura apo termave mbi raportimin financiar, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit financiar) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar; pasqyrën e performancës financiare; pasqyrën e flukseve monetare; pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto; pasqyrën mbi gjendjen dhe ndryshimin e aktiveve afatgjata; pasqyrën e amortizimit të aktiveve; shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare.

- Në pasqyrat financiare u evidentua se transaksionet financiare të realizuara gjatë aktivitetit të subjektit, të cilat në përgjithësi nuk paraqiten në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të viteve 2021, nuk paraqiten në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, në kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

- Për të 3 vitet 2020, 2021, 2022, nuk ishin hapur ditarët e analitikë dhe pasqyrat financiare të viteve 2020 dhe 2021 ishin përgatitur nga jashtë (extra kontabël), mungonin dhe nuk kryheshin veprime kontabël në ditarët e bankës, magazinës, të ardhurave dhe shpenzimeve, ditarin e veprimeve të ndryshme, ditari i pagave, dhe të gjithë ditarët e tjerë, analizat, centralizatori / libri i madh, në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15, dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

- Në pasqyrat financiare, nuk paraqiten shumat e amortizimit të akumuluar 219, 681 “Kuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytëzimit” nuk është plotësuar me amortizimin vjetor (Kosto historike minus amortizimin e akumuluar), veprim ky moszbatim të me Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 31

- Lidhur me shënimet shpjeguese (Pasqyra F5) nuk ishin plotësuar me të gjitha ekstremet rubrikat si më poshtë: Rubrika 1 Rubrika 2: pasqyrave financiare

- Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), lidhur me plotësimin e llogarive të aktiveve afatgjatë dhe rakordimin me inventarët kontabël dhe fizikë, kishte plotësuar llogarinë sintetike 215 “Mjete Transporti” për shumën me vlerë të mbetur 9,750,526 lekë e cila nuk përputhet me vlerën e 5 automjeteve deri më datë 31.12.2021, të cilat janë bërë hyrje me vlerë fillestare 19,529,571 lekë dhe në vlerë neto 6,550,526 lekë.

### 2.Për auditimin e përputhshmërisë

Ne kemi audituar veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve Tiranë, përsa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve, termave dhe kushteve mbi të cilat është rënë dakord kriteret, e auditimit të përputhshmërisë dhe bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve Tiranë, të krijuar me VKM-së nr.570, datë 17.07.2019 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve” dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 24, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi.

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë Agjencisë Kombëtare të Pyjeve Tiranë me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, ku rezultuan mospërputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionin të modifikuar/kualifikuar,

#### Baza për opinionin (I modifikuar/kualifikuar)

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura, si vijon:



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

- titullari i institucionit nuk ka nxjerrë urdhër për krijimin e komisioneve për procesin e vlerësimit të aktiveve dhe procesin e nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi, në kundërshtim me pikën 5, pikën 96, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*",
- mungojnë 18 VKM dhe udhëzime, si: udhëzimi për klasifikimin e pyjeve; për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit të sipërfaqeve në volum nga fondi pyjor kombëtar; për procedurat dhe vendimmarrja për kundërvajtjet administrative dhe inspektimin,
- Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor (RKFP) nuk është i plotë, pasi në këtë fond pyjor nuk janë të pasqyruara ato sipërfaqe pyjorë të cilat i kanë kaluar në pronësi Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet VKM-së Nr. 707, datë 21.11.2018 "*Për kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Shkodër-Fier*". Sipas nenit 2 të ligjit nr.57/2020 "*Për pyjet*", ligji i shtrin efektet për çdo sipërfaqe pyjore pavarësisht pronësisë, për sa kohë plotësohet kushti i përkufizimit të "pyllit", pavarësisht administrimit qoftë privat apo publik.
- Nuk është kryer inventarizimi i viti 2021, pasi ka qenë mungesa e të dhënave mbi VKM-të e hartuara ndër vite për sipërfaqet e hequra nga fondi pyjor/kullosor si dhe sipërfaqet pyjore kullosore pronë private. Në evidencat e tregueseve kadastral që përcaktojnë fondin pyjor/kullosor të bashkive, nuk janë hedhur të dhënat kadastrale të konfirmuara nga planet e reja të mbarështimi të 3-4 viteve të fundit.
- Nga 385 ekonomi pyjore në gjithë vendin vetëm 76 (20 %) prej tyre janë të pajisura me plane mbarështimi apo plane që janë në proces. Sqarojmë se disa ekonomi janë të ndara mes dy apo më shumë bashkive për shkak të ndarjes së re territoriale, ndaj dhe numri i ekonomive të raportuara për plane mbarështimi rezultojnë me i lartë 477.
- Nga 61 bashki 21 prej tyre kanë të mbuluar 4% -100% të territorit me plane mbarështimi, ndërsa pjesa tjetër e bashkive nuk kanë hartuar asnjë plan mbarështimi të paktën 10 vitet e fundit,

### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve Tiranë.**

Strukturat drejtuese të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve Tiranë, janë përgjegjëse për ruajtjen e zonave pyjore dhe zhvillimin e qëndrueshëm, në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), për hedhjen e të dhënave në Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor (RKFP)

- Monitorimin dhe zbatimin i kushteve për ruajtjen e pyjeve, vlerësimet periodike të situatave, aktivitetin mjedisor e zhvillimor dhe ruajtjen e tyre,
- Hartimi i plan-menaxhimit dhe zbatimin i tyre,
- Bashkëpunimi me institucione dhe organet të kontrollit etj.

### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin Financiar dhe Përputhshmërisë:**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kriterëve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne





## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

### **I. HYRJA**

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr.891/1datë 13.10.2022, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 17.10.2022, deri në datë 09.12.2022, në subjektin Agjencia Kombëtare e Pyjeve për periudhën nga 01.09.2020 deri në 30.11.2022, u krye auditimi “Financiar dhe përputhshmërisë”, nga **Grupi i Auditimit me përbërje:**

- 1.V. B, përgjegjës grupi
- 2.Sh.H, anëtare
- 3.A. P, anëtar
- 4.A. V, anëtar
- 5.R. A, anëtar,

**1.Objektivat dhe qëllimi i auditimit:** Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Agjencinë Kombëtare të Pyjeve duke i kushtuar vëmendje të posaçme çështjeve që lidhen me;

- vlerësimin e Sigurimit e performancës ne Pyje,
- vlerësimin e gjendjes ne pyje ,
- organizimin e punës për inventarizimin edhe kërkimin në fushën e pyjeve,
- organizimin e punës dhe hartimin dokumenteve për menaxhimin e pyjeve,
- Organizimin e punës për monitorimin he kontrollin e pyjeve,

në zbatim të ligjit nr.57/2020 “Për Pyje”, Ligjin nr.9228“Për Kontabilitetin dhe pasqyrat Financiare “Ligjin nr.9936datë 26.06.2008”Për Menaxhimin e sistemit Buxhetore në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve ne Njësitë e Sektorit Publik”. Ligjin nr.5/2016 datë 04.02.2016 “Për shpalljen moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”.

**2.Oëllimi i auditimit:** është vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare të Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, mbi çështjet që lidhen me ruajtjen, menaxhimin, monitorimin kontrollin në fushën e pyjeve.

### **3. Identifikimi i çështjes**

- 1-Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit,
- 2-Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe pagave,
- 3-Mbi auditimin e Pasqyrave Financiare, inventarizimi i pronës shtetërore,
- 4-Auditimi mbi masat e marra për mbrojtjen e pyjeve , inventarizimin dhe dixhitalizimin e fondit pyjorë, përfshirë monitorimi dhe kontrollin e pyjeve.
- 5-Auditimi mbi menaxhimin dhe mbarështimin r pyjeve , kontrollin monitorimin e subjekteve te licencuara në shfrytëzimin e pyjeve dhe mbikëqyrjen e akteve ligjore/nënligjore , akteve administrative, politikave nga strukturat e kontrollit të pyjeve në bashki dhe në zonat e mbrojtura.

### **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:**

Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, Referuar VKM-së nr.570,datë 17.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të “Agjencinë Kombëtare të Pyjeve” dhe Urdhrit nr. 24, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, ligjit nr. 57/2020 “Për Pyjet”.

-Ligjit nr152/2013 ”Për nëpunësit civil” ‘i ndryshuar.

Ligjin nr.9228“PërKontabilitetin dhe pasqyrat Financiare “Ligjin nr.9936datë 26.06.2008”Për Menaxhimin e sistemit Buxhetore në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr.30datë



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. Ligjin nr.5/2016 datë 04.02.2016 “Për shpalljen moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”.

-Si dhe udhëzimeve të dalura nga Ministria Mjedisit dhe Turizmit.

-Kontrollet kryera nga strukturat e AKP në njësitë e Qeverisjes Vendore

### **5. Përgjegjësitë e audituesve:**

Grupi i auditimit të KLSH<sup>së</sup>, për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, grupi i auditimit ka zbatuar Kodin e Parimet Etike të cilat drejtojnë përgjegjësitë profesionale të audituesit, si dhe Standardet e Miratuara të Auditimit të cilat kanë në qendër të vëmendjes:

- Auditimi i zbatimit të buxhetit

-Pasqyrat Financiare, marrëdhëniet e punës me pagat,

-Kontrollet kryera në njësitë e Qeverisjes Vendore, si në kontrollin e dokumentacionit ligjor të subjekteve me kontrata me afat 10 vjeçar.

-Të dhënat mbi inventarizimin e pyjeve programit ALFIS, si dhe të dhënat e marra nga kadastra.

- Ballafaqimi dhe diskutimi i rezultateve të auditimit me personat përgjegjës.

- Përcaktimi i rekomandimeve në bazë të gjetjeve nga auditimi, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, mbi përmirësimin e punës në veprimtarinë që kryen institucioni.

### **6. Kriteret e vlerësimit:**

Përcaktimet ligjore dhe rregullat e funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, normat dhe metodat e përcaktuara sipas kërkesave të ligjeve, akteve administrative, rregullores së institucionit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe të dhënat mbi veprimtarinë e subjektit të audituar

Në të gjitha fazat e auditimit sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit, në referencë me problematikën është patuar si kriter vlerësues në radhë të parë ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,- VKM-së nr.570, datë 17.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të “Agjencinë Kombëtare të Pyjeve” dhe Urdhrit nr. 24, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencinë Kombëtare të Pyjeve ligjit dhe me ligjin nr. 57/2020 “Për Pyjet” datë 30.4.2020.

-Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësit civil” i ndryshuar.

Ligjin nr.9228 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat Financiare” i ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e sistemit Buxhetore në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. Ligjin nr.5/2016 datë 04.02.2016 “Për shpalljen moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”.

-Si dhe udhëzimeve të dalura nga Ministria Mjedisit dhe Turizmit.

Ky angazhim ka patuar si mision auditimit, përputhshmërisë dhe financiar, asetet, sistemin organizativ të funksionimit të kontrollit /monitorimit të pyjeve.

Në vlerësimin e mekanizmave të auditimit, janë marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

-llojet e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve të cilat mund të ndodhin;

-procedurat e mekanizmave të auditimit, që i shërbejnë parandalimit dhe zbulimit të këtyre gabimeve, të metave, parregullsive dhe shkeljeve;

-nëse janë miratuar procedurat e duhura dhe nëse niveli i respektimit të tyre, është i kënaqshëm;

-anët e dobëta të mekanizmave ekzistuese të auditimit, që çojnë në mos zbulimin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve prej tyre;

-ndikimi që këto anë të dobëta kanë, dhe:

-shpërndarjen në kohë dhe intensitetin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve.



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik dhe Standardet duke përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë së procesit të legalizimit dhe rregullshmërisë së veprimtarisë, konfirmo me parimet, normat, rregullat dhe ligjet në fuqi.

### **7. Standardet e auditimit**

Rregullorja e Brendshme “Mbi Organizimin dhe Funksonimin Administrativ të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH, Nr. 85, datë 30.06.2015; Rregullorja e Brendshme “Për procedurat e auditimit të KLSH”; Udhëzimi i Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi Procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit zbatimit rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t” (ISSAI), “Standardet e Kontrollit të KLSH”, “Manualeve” si dhe udhëzimeve dhe rregullave të nxjerra në zbatim të tyre.

### **8. Metodatat e auditimit**

Për arritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike. Metodatat e përdorura gjatë auditimit në arritjen e konkluzioneve janë:

*Metoda e ekzaminimit:* Kjo është një procedurë e cila ka shërbyer për të shqyrtuar të dhëna që lidhen me kryerjen e auditimit. Në këtë mënyrë, ajo që është vëzhguar dhe identifikuar të mund të testohet më tej. Vlerësimi ka përfshirë procedura testimi, si dhe gjykimin profesional të audituesve në lidhje me përshtatshmërinë dhe evidencën e veprimeve.

*Metoda e ekzaminimit kryq:* Është përdorur kur është marrë informacioni për një ngjarje nga një burim i caktuar. Ky informacion është marrë dhe është krahasuar me një informacion të marrë për të njëjtat ngjarje, por me origjinë nga një burim tjetër. Kjo metodë është përdorur për të arritur nivelin e mjaftueshëm të besueshmërisë së përfundimeve.

*Metoda e intervistimit:* Është konsideruar si një nga metodatat më të mira dhe më të përshtatshme të përdorura gjatë procesit të auditimit për të gjetur informacion të menjëhershëm. Duke qenë se kjo metodë kufizohet nga besueshmëria e evidencës së mbledhur gjatë përdorimit të saj, kjo metodë është përdorur për kontrollin dhe verifikimin e informacionit gjatë përdorimit të ekzaminimit kryq, ose forma të tjera si p.sh. caktimi i takimeve, intervistat me punonjësit e tjerë të institucionit, ballafaqimi midis punonjësve që kanë patuar përgjegjësi në procesin e punës etj. Është intervistuar stafi menaxheria dhe operacionet gjatë fazës së njohjes së aktiviteteve dhe proceseve të njësive të audituar. Intervistat kanë ofruar një mundësi për parashtrimin e pyetjeve për sqarim të informacionit shtesë në bazë të përgjigjeve të dhëna. Audituesit kanë qenë të paanshëm dhe janë munduar të jenë sa më efektiv duke iu shmangur anshmërisë së informacioneve duke bërë pyetje të hapura (që kërkojnë përgjigje dhe shpjegime disi të gjera). Evidencat e auditimit që përftohet nga takimi janë mbajtur saktë dhe në mënyrë korrekte.

*Metoda e testimit të detajuar:* Audituesit kanë kryer ekzaminimin e dokumenteve të institucionit sipas objektivave të auditimit, dhe kanë marrë evidenca më të besueshme se sa intervistimi ose në mbështetje të informacioneve të mbledhura gjatë intervistimit.

### **9. Dokumentimi i auditimit**

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë. Konkluzionet janë arritur duke u bazuar në rezultatet e procedurave të kryera dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe në çështjet e rëndësishme që dolën gjatë auditimit.



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

### II-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

#### 1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

AKP është themeluar në vitin 2020 dhe ka një aktiviteti 2 vjeçar me një buxhet rreth 48 mln lekë, me funksione kryesisht monitorues dhe menaxhues të bazës kombëtare mbi fondin pyjor.

-Nga detyrat që i atribuon ligji dhe kuadri rregullator, AKP është përgjegjëse për procesin:

a) inventarizimit të fondit pyjor dhe përditësimit të sistemit të integruar të informacionit  
b) monitoron, kontrollon të drejtat e akorduara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore tek operatorët publike ose privatë, për shfrytëzimin e fondit pyjor, për sa i takon përputhshmërisë dhe respektimit të kriterëve.

c) monitoron, kontrollon veprimtarinë e strukturave të administrimit e të inspektimit në bashkitë, për sa i përket zbatimit dhe respektimit të legjislacionit në fuqi të planeve të miratuara, të cilat ndërhyjnë për marrjen e masave të detyrueshme në rastet kur evidentohen shkelje apo shmangie nga përmbajtja dhe kërkesat e tyre.

Veprimtaria kryhet në zbatim të:

VKM –së, nr. 570 datë. 17.07.2019 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve” ngarkojnë Agjencinë Kombëtare të Pyjeve për vlerësimin e gjendjes së pyjeve”, si dhe me Urdhër nr.24, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve”;

Ligji. “Për Pyjet” Nr. 57/2020 datë 30.04.2020.

Dokumenti i Politikave Pyjore në Shqipëri 2019-2030 miratuar me VKM nr. 814, datë 31.12.2018.

Ligji nr. 10120, datë 23.04.2009 “Për mbrojtjen e Fondit të Bimëve Mjekësorë, Eterovajore e Tanifere Natyrore”, i ndryshuar dhe azhornuar me ligjin nr. 42/2013. Datë 14.02.2013.

Ligji nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullosor” të ndryshuar,

#### **Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:**

#### 2.Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve

Në zbatim të pikës 1 të Programit të Auditimit nr. 891/1, datë 13.10.2022, “Mbi auditimin e hartimit dhe zbatimit të Buxhetit”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar;
2. Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”;
3. Ligjet vjetore të buxhetit;
4. Udhëzimet e hartimit dhe zbatimit të buxhetit të dala nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë;
5. VKM nr. 570 datë. 17.07.2019 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të pyjeve ngarkojnë për vlerësimin e gjendjes së pyjeve”;

**“Mbi auditimin e hartimit dhe zbatimin e buxhetit të shtetit. Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në udhëzimet e Ministrisë së Financave mbi hartimin e buxhetit të shtetit. Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimin e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar. Realizimi i planit të buxhetit).**

#### **Objekti i këtij verifikimi është: Auditimi i hartimit dhe zbatimit të shtetit.**

Auditimi i programimit dhe realizimit të fondeve buxhetore u krye duke mbajtur parasysh legjislacionin e më poshtëm:

-Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

- Shqipërisë, ndryshuar me Ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”;
- Ligji nr. 137, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”
- Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”
- Udhëzimi nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”;
- Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 2, datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”;
- Vendimi i KM nr. 570, datë 17.07.2019 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” nr. 09, datë 17.07.2019 “Për krijimin organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”
- Udhëzimi plotësues i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”
- Urdhri i Kryeministrit nr. 24, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”

**a.** Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në udhëzimet e Ministrisë së Financave për hartimin e buxhetit të shtetit.

### **Shtator 2020-2021-2022**

Referuar Ligjit nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” nr. 09, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 24, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, nga ana e këtij institucioni është kërkuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, kërkesa nr. 49, datë 21.09.2020, ku paraqitet gjendja financiare dhe fakti i mungesës së buxhetit, si rrjedhojë pamundësia e përmbushjes së detyrave të caktuara me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

*Për vitin 2020, referuar ligjit “Për buxhetin e vitit ...”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” nr. 09, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, janë paraqitur kërkesat për fonde buxhetore për këto vite, në një kohë që sipas Sektorit të Financës, nevojat për buxhetet përkatëse janë marrë nga drejtoritë e institucionit nëpërmjet rrugës elektronike, të cilat nuk u gjetën nga ana e grupit të KLSH, për faktin e njohur të zhdukjes së tyre nga sulmi kibernetik dhe moskthimi deri në kohën e kryerjes së auditimit.*

Përsa më sipër është kërkuar një fond prej 1,600,000 lekësh, prej të cilave 960,000 lekë dieta dhe pjesa tjetër prokurime me vlerë të vogël si: mjete kancelarie, uji, energji, telefon, tarifë postare, shërbim mirëmbajtje automjete, materiale pastrimi, mirëmbajtje dhe riparime pajisje zyre, mirëmbajtje dhe riparime pajisje informatike dhe shpenzime të tjera.

**Argumentimi i kërkesave Megjithatë, kërkesat e bëra ishin të fryra, gjë që le shteg për keqpërdorim të fondeve, gjë që ndikon në aktivitetin dhe performancën, si dhe në rezultatet e arritura të AKP, sipas ligjeve dhe akteve nënligjore.**

### **Viti 2021**

*Kërkesat e pba të cilat nuk u gjetën nga ana e grupit të KLSH, për faktin e njohur të zhdukjes së tyre nga sulmi kibernetik dhe moskthimi deri në kohën e kryerjes së auditimit.*

**Argumentimi i kërkesave Megjithatë, kërkesat e bëra ishin të fryra, gjë që le shteg për keqpërdorim të fondeve, gjë që ndikon në aktivitetin dhe performancën, si dhe në rezultatet e arritura të AKP, sipas ligjeve dhe akteve nënligjore.**

### **Viti 2022**

Referuar Ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” nr. 09, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, është dërguar kërkesa nr. 9327, datë 30.12.2021 drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për detajimin e buxhetit të shpenzimeve



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

korrente për vitet 2022-2024, ku pas miratimit nga kjo e fundit, MTM me shkresë nr. 547, datë 21.01.2022, ka dërguar miratimin e buxhetit për AKP për vitin 2022, në shumën prej 50,860,000 lekësh.

*Për vitin 2022, referuar ligjit “Për buxhetin e vitit ...”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” nr. 09, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, janë paraqitur kërkesat për fonde buxhetore për këto vite, në një kohë që sipas Sektorit të Financës, nevojat për buxhetet përkatëse janë marrë nga drejtoritë e institucionit nëpërmjet rrugës elektronike, të cilat nuk u gjetën nga ana e grupit të KLSH, për faktin e njohur të zhdukjes së tyre nga sulmi kibernetik dhe moskthimi deri në kohën e kryerjes së auditimit.*

**Argumentimi i kërkesave:** Megjithatë, kërkesat e bëra ishin të fryra, gjë që le shteg për keqpërdorim të fondeve, gjë që ndikon në aktivitetin dhe performancën, si dhe në rezultatet e arritura të AKP, sipas ligjeve dhe akteve nënligjore.

**b.** Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit, detajimi i planit fillestar, transferimi i fondevebuxhetore si dhe plani përfundimtar.

### Viti 2020

Referuar Ligjit nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” nr. 09, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 24, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, si dhe në mbështetje të kërkesës nr. 49, datë 21.09.2020 të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, këtij institucioni i akordohet fondi për shpenzimet korrente, në shumën 3,180,000 lekë, në llogaritë ekonomike 600, 601, 602, për projektet: “Inventarizim dhe kadastër e kryer” dhe “Plane menaxhimi për pyjet”.

Gjithashtu, po në zbatim të ligjit nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit), me shkresë nr. 17630/1, datë 28.09.2020, lënda: “Dërgohet rialokim i numrit te punonjësve, për vitin 2020”, në bazë të akteve ligjore e nënligjore të përmendura më sipër si dhe në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr. 6290, datë 21.09.2020, është miratuar rishpërndarja e numrit të punonjësve, gjithsej 32 (tridhjetedy) punonjës për vitin 2020.

Në sa u trajtua më sipër, në mungesë të argumentimit të kërkesës për fonde buxhetore, në bazë të shkresave të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr. 6425/1, datë 08.10.2020 dhe nr. 7545, datë 12.11.2020 “Akordim fondi për shpenzimet korrente”, janë akorduar fondet për vitin 2020, sipas tabelës së mëposhtme:

### Plani Fillestar

**TABELA E BUXHETIT - FONDET E MIRATUARA PËR VITIN 2020**

Entiteti qeveritar	Grupi	Kapitulli	Programi	Llog. Ekonomike	Emertimi i projektit	Shuma
001	26	01	04260	6000000	Inventarizim dhe kadastër e kryer	4,970,000
001	26	01	04260	6010000	Inventarizim dhe kadastër e kryer	847,000
001	26	01	04260	6000000	Plane menaxhimi per pyjet	2,130,000
001	26	01	04260	6010000	Plane menaxhimi per pyjet	363,000
001	26	01	04260	6020000	Inventarizim dhe kadaster e kryer	350,000
001	26	01	04260	6020000	Plane menaxhimi per pyjet	150,000
					<b>Gjithsej</b>	<b>8,810,000</b>

Transferimi i fondeve buxhetore2021



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

(shitesa/pakësime) të fondeve buxhetore të akorduara.

### **Viti 2021**

Referuar Ligjit nr. 137, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” nr. 09, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, si dhe në mbështetje të shkresës shkresës së MTM nr. 522, datë 21.01.2021, janë akorduar fondet për shpenzime korrente për vitin 2021, sipas tabelës së mëposhtme:

Përveç sa u përmend më sipër, mbi bazën e shkresës nr. 4301/1, datë 10.03.2021 së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit), në zbatim të akteve ligjore e nënligjore të përmendura më sipër, si dhe të Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, dhe të shkresës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr. 1604, datë 02.03.2021, është dërguar miratimi i detajimit të fondit të veçantë për vitin 2021 për Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, në shumën 100,000 lekë.

Entiteti qeveritar	Grupi	Kapitulli	Programi	Llog. Ekonomike	Emertimi i projektit	Shuma
001	26	01	04260	6000000	Inventarizim dhe kadastër e kryer	10,200,000
001	26	01	04260	6010000	Inventarizim dhe kadastër e kryer	2,820,000
001	26	01	04260	6000000	Plane menaxhimi per pyjet	6,800,000
001	26	01	04260	6010000	Plane menaxhimi per pyjet	1,880,000
001	26	01	04260	6020000	Inventarizim dhe kadaster e kryer	7,800,000
001	26	01	04260	6020000	Plane menaxhimi per pyjet	5,200,000
001	26	01	04260	6060000	Inventarizim dhe kadaster e kryer	100,000
					<b>Gjithsej</b>	<b>34,800,000</b>

### **Transferimi i fondeve buxhetore**

1.Mbi bazën e shkresës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr. 3266/1, datë 08.06.2021, “Kthim përgjigje mbi kërkesën për shtesë fondi”, në përgjigje të shkresës së Agjencisë Kombëtare të Pyjeve nr. 341, datë 12.05.2021, ligjit nr. 137, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” nr. 09, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të Udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, të Vendimit të KM nr. 570, datë 17.07.2019 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, gjatë vitit 2021 janë bërë ndryshime në planin fillestar, shtesa, në llogaritë ekonomike 602, sipas tabelës së mëposhtme:

Llog Ek	Kodi i Instituc.	Emër Institucioni	Emërtimi i Produktit	Shuma
		<b>SHTESA</b>		
602	1026095	Agjencia Kombëtare e Pyjeve	Inventarizim dhe kadastër e kryer	7,001,275
		<b>PAKËSIME</b>		
602	1026001	Aparati i Min.Turizmit dhe Mjedisit	Raporte monitorimi në ZM	7,001,275



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

2.Mbi bazën e shkresës së Ministrisë së Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit) nr. 11017/3, datë 26.07.2021, “Transferim fondi për vitin 2021”, drejtuar Degës së Thesarit Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 137, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, të Udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, si dhe në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr. 4296, prot., datë 21.06.2021, ku është paraqitur kërkesa për rialokim të fondeve për shpenzime korrente për vitin 2021, janë bërë ndryshime në planin fillestar, shtesa, në llogaritë ekonomike 600, sipas tabelës së mëposhtme:

Llog Ek	Kodi i Instituc.	Emër Institucioni	Emërtimi I Produktit	Shuma
		<b>SHTESA</b>		
600	1026087	Agjencia Kombëtare e Pyjeve	Raporte Monitorimi në ZM	<b>6,800,000</b>
600	1026095	Agjencia Kombëtare e Pyjeve	Inventarizim dhe kadastrë e kryer	<b>6,748,725</b>
		<b>PAKËSIME</b>		
602	1026001	Aparati I Min.Turizmit dhe Mjedisit	Raporte monitorimi në ZM	<b>13,548,725</b>

### Plani përfundimtar.

Pas ndryshimeve të kryera gjatë vitit në shtesa të buxhetit fillestar, rezulton një buxhet i rishikuar për shpenzimet korrente të vitit 2021 prej 48,450,000 lekë, sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela e buxhetit - fondet e rishikuara  
Për vitin 2021

Llog. Ekonomike	Emertimi i projektit	Plani Fillestar	Shtesat/ pakesimet	Buxheti i rishikuar
6000000	Inventarizim dhe kadastrë e kryer	10,200,000	6,748,725	16,948,725
6010000	Inventarizim dhe kadastrë e kryer	2,820,000	-	2,820,000
6000000	Plane menaxhimi per pyjet	6,800,000	-	6,800,000
6010000	Plane menaxhimi per pyjet	1,880,000	-	1,880,000
6020000	Inventarizim dhe kadastrë e kryer	7,800,000	7,001,275	14,801,275
6020000	Plane menaxhimi per pyjet	5,200,000	-	5,200,000
6060000	Inventarizim dhe kadastrë e kryer	100,000	(100,000)	-
	<b>Gjithsej</b>	<b>34,800,000</b>	<b>13,650,000</b>	<b>48,450,000</b>

### Viti 2022

Referuar Ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” nr. 09, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 229222, datë 07.01.2022 “Dërgohet miratimi i detajimit të buxhetit për vitet 2022-2024 për shpenzimet korrente”, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me shkresë nr. 547, datë 21.01.2022 dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, kanë dërguar detajimin e buxhetit të shpenzimeve korrente për vitet 2022-2024, ku Agjencisë Kombëtare të Pyjeve i është akorduar një buxhet në total prej 50,860,000 lekë, sipas tabelës:





## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

### plani fillestar Tabela e buxhetit - fondet e miratuara për vitin 2022

Entiteti qeveritar	Grupi	Kapitulli	Programi	Llog. Ekonomike	Emërtimi i projektit	Shuma
001	26	01	04260	6000000	Inventarizim dhe kadastër e kryer	18,200,000
001	26	01	04260	6010000	Inventarizim dhe kadastër e kryer	3,420,000
001	26	01	04260	6000000	Plane menaxhimi për pyjet	10,800,000
001	26	01	04260	6010000	Plane menaxhimi per pyjet	2,280,000
001	26	01	04260	6020000	Inventarizim dhe kadaster e kryer	9,800,000
001	26	01	04260	6020000	Plane menaxhimi per pyjet	6,200,000
001	26	01	04260	6060000	Inventarizim dhe kadaster e kryer	160,000
					<b>Gjithsej</b>	<b>50,860,000</b>

1.Mbi bazën e shkresës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr. 2927/4, datë 01.04.2022, “Miratimi i detajimit të ndryshimeve sipas Aktit Normativ nr. 3, datë 12.03.2022”, dërguar me shkresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 4934/57, datë 29.03.2022 “Dërgohet miratimi i detajimit të ndryshimeve sipas Aktit Normativ nr. 3, datë 12.03.2022 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar”; të Udhëzimit nr. 09, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të Udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, të ndryshuar, gjatë vitit 2022 janë bërë ndryshime në planin fillestar, pakësime, në llogaritë ekonomike 600, 601, 602, sipas tabelës së mëposhtme:

Llog Ek	Kodi i Instituc.	Emër Institucioni	Emërtimi I Produktit	Shuma
		<b>PAKËSIME</b>		<b>7,525,250</b>
600	1026095	Agjencia Kombëtare e Pyjeve	Inventarizim dhe kadastër e kryer	<b>3,000,000</b>
601	1026095	Agjencia Kombëtare e Pyjeve	Inventarizim dhe kadastër e kryer	<b>550,250</b>
602	1026095	Agjencia Kombëtare e Pyjeve	Inventarizim dhe kadastër e kryer	<b>3,975,000</b>

### Plani përfundimtar.

Pas ndryshimeve të kryera gjatë vitit në pakësime të buxhetit fillestar, rezulton një buxhet i rishikuar për shpenzimet korrente të vitit 2022 prej 43,334,750 lekë, sipas tabelës së mëposhtme:

Llog. Ekonomike	Emertimi i projektit	Buxheti fillestar	Shtesat/pakesimet	Buxheti rishikuar
6000000	Inventarizim dhe kadaster e kryer	18,200,000	(3,000,000)	15,200,000
6010000	Inventarizim dhe kadaster e kryer	3,420,000	(550,250)	2,869,750
6000000	Plane menaxhimi per pyjet	10,800,000		10,800,000
6010000	Plane menaxhimi per pyjet	2,280,000		2,280,000
6020000	Inventarizim dhe kadaster e kryer	9,800,000	(3,975,000)	5,825,000
6020000	Plane menaxhimi per pyjet	6,200,000		6,200,000
6060000	Inventarizim dhe kadaster e kryer	160,000	-	160,000
	<b>Gjithsej</b>	<b>50,860,000</b>	<b>7,525,250</b>	<b>43,334,750</b>

### c. Realizimi i planit të buxhetit



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

### Viti 2020

Plani i buxhetit të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, për vitin 2020, rezulton në vlerën total **8,810,000 lekë**. Tabela në vijim paraqet në mënyrë të detajuar programet dhe realizimet sipas zërave, për vitin 2020, të rakorduara me Degën e Thesarit Tiranë, deri më datë 31.12.2020, si më poshtë:

GR	PROG.	PROJEKT	ART	PLAN VJETOR	PL THESARI	SHPENZ THESARI	SIG + TATIME	BANKA	DIF SHPENZ-BANKA	NR PUNONJ	
										PLAN	FAKT
26	04260	92602AD	600	4,970,000		2,635,496	488,797	2,146,699	488,797	22	13
26	04260	92602AE	600	2,130,000		2,130,000	400,437	1,729,563	400,437	10	10
26	04260	92602AD	601	847,000		438,764	438,764	0	438,764		
26	04260	92602AE	601	363,000		357,070	357,070	0	357,070		
			<b>600999</b>	<b>8,310,000</b>	<b>8,310,000</b>	<b>5,561,330</b>	<b>1,685,068</b>	<b>3,876,262</b>	<b>1,685,068</b>	<b>32</b>	<b>23</b>
26	04260	92602AD	602	350,000		343,500	0	343,500	0		
26	04260	92602AE	602	150,000		147,720	0	147,720	0		
			<b>602999</b>	<b>500,000</b>	<b>500,000</b>	<b>491,220</b>	<b>0</b>	<b>491,220</b>	<b>0</b>		
26	04260	92602AD	606	0		0		0	0		
26	04260	92602AE	606	0		0		0	0		
				<b>8,810,000</b>	<b>8,810,000</b>	<b>6,052,550</b>	<b>1,685,068</b>	<b>4,367,482</b>	<b>1,685,068</b>	<b>32</b>	<b>23</b>

Për vitin 2020, shpenzimet buxhetore, të realizuara nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve, rezultojnë në programin 04260 dhe sipas natyrës së artikujve buxhetore dhe produkteve, janë në zërin **shpenzimet Korrente të AKP**, në total janë planifikuar në vlerën 8,810,000 lekë. Nuk ka patur transferime fondesh gjatë vitit 2020.

Grupi i auditimit analizoi pagesat e kryera gjatë vitit 2020, për prokurimet publike me vlerë të vogël, gjithsej 491,220 lekë, sipas tabelës :

#### REGJISTRI I REALIZIMEVE TE PROKURIMEVE PUBLIKE PER VITIN 2020

Nr.	Objekti i Prokurimit	Investim	Shpenzime (Art. 602)	Burimi i Financimit
Kod Art.				
6020100	Mjete kancelarike dhe leter A4		59,960	Buxheti
6020300	Tonera per printera dhe fotokopje		119,500	Buxheti
6021011	Faturë për regjistrim domaini		5,000	Buxheti
6022004	Posta		6,260	Buxheti
6024100	Dieta (Udhetim i brendshem)		214,500	Buxheti
6025600	Shërbime riparimi dhe mirëmbajta automjete		36,000	Buxheti
6027400	Shpenzime gjyqesore		50,000	Buxheti
	<b>Totali</b>	<b>0</b>	<b>491,220</b>	

### Viti 2021

Plani përfundimtar i buxhetit të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, për vitin 2021, rezulton në vlerën total **48,450,000 lekë**. Tabela në vijim paraqet në mënyrë të detajuar programet dhe realizimet sipas zërave, për shpenzimet korrente, të rakorduara me Degën e Thesarit Tiranë deri më datë 31.12.2021, sipas tabelës së mëposhtme:



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

GR	PROG	PROJEKT	ART	PLAN VJETOR	PL THESAR	SHPENZ THESARI	SIG TATIME	FAT. PAPAG. VITI 2021	BANKA
26	04260	92602AD	600	16,948,725		16,521,904	2,716,964		13,804,940
26	04260	92602AE	600	6,800,000		6,770,874	1,505,765		5,265,109
26	04260	92602AD	601	2,820,000		2,444,705	2,444,705		0
26	04260	92602AE	601	1,880,000		1,531,990	1,531,990		0
			<b>600999</b>	<b>28,448,725</b>	<b>28,448,72</b>	<b>27,269,473</b>	<b>8,199,424</b>	<b>0</b>	<b>19,070,049</b>
26	04260	92602AD	602	14,801,275		14,799,827	1,536	-	14,798,291
26	04260	92602AE	602	5,200,000		3,300,475	1,025	581,371	2,718,079
26	04260	92602AD	606	0		0	0		0
26	04260	92602AE	606	0		0	0		0
			<b>602999</b>	<b>20,001,275</b>	<b>20,001,27</b>	<b>18,100,302</b>	<b>2,561</b>	<b>581,371</b>	<b>17,516,370</b>
				<b>48,450,000</b>	<b>48,450,00</b>	<b>45,369,775</b>	<b>8,201,985</b>	<b>581,371</b>	<b>36,586,419</b>

Për vitin 2021, nga ana e AKP ishin hartuar evidencat sintetike dhe analitike të shpenzimeve të kryera, lidhur me nivelin e realizimit të tyre referuar planit të rishikuar të këtij viti, diferencat e rezultuara në mosrealizimin e tyre në vlerë absolute dhe në përqindje për vitin 2021, sipas tabelës së mëposhtme:

Artikulli	Të Ardhurat	Gjithsej	Institucioni	Buxheti
	<b>Totali</b>	<b>395,400</b>	-	<b>395,400</b>
<b>7115</b>	<b>Gjoha, kamatëvonesa, sekuestrime dhe zhëndime</b>	<b>395,400</b>	-	<b>395,400</b>
7115403	Gjoha të Policisë Pyjore	203,000	-	203,000
7115600	Derdhje në buxhet zhëndim	192,400	-	192,400

**REALIZIMI**  
L

### SHPENZIMEVE Janar - Dhjetor 2021

Grupi	Titulli	Kapit.	Artikulli	Emertimi	Plani Vjetor	Fakti Progres.	Diferenca	%
26	04260	01	600+601	Shpenzime Personeli	28,448,725	27,269,473	1,179,252	96%
26	04260	01	602+604+605+606	Shpenzime te Tjera	20,001,275	18,100,302	1,900,973	90%
				<b>Totali</b>	<b>48,450,000</b>	<b>45,369,775</b>	<b>3,080,225</b>	<b>94%</b>

Nga sa duket sipas tabelës së mësipërme, rezulton se buxheti i vitit 2021 është realizuar në masën 94 përqind, pra me mosrealizim, dhe në vlerë absolute me një vlerë prej 3,080,225 lekë diferencë e parealizuar, nga të cilat:

- shpenzimet e personelit (600+601) rezultojnë me një mosrealizim prej 96% dhe në vlerë absolute 1,179,252 lekë



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

- shpenzimet e tjera (602+604+605+606) rezultojnë me një mosrealizim prej 90% dhe në vlerë absolute 1,900,973 lekë.

Siç shihet mosrealizimet janë të konsiderueshme, sidomos në “shpenzimet e tjera korrente” (602+604+605+606), ku si shkak i tyre është planifikimi i fryrë dhe i paargumentuar i shpenzimeve, ashtu siç u trajtua në nën/pikën përkatëse të hartimit të planit të buxhetit për vitin 2021, e cila ka lënë shteg për shpërdorimin e fondeve, si rezultat i tepricave të tyre në planifikim.

Nga analiza sipas artikujve, rezulton se mosrealizimet janë të theksuara në llogaritë ekonomike “Shpenzime te tjera operative” me 64 %; “Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme” me 67 %; “Materiale zyre dhe te përgjithshme” me 73 % (sidomos kancelaria me 66%); “Shpenzime udhëtimi” me 84 %, etj.

Zërat e mësipërm, në mosrealizimin e tyre, tregojnë në mënyrë eksplicite faktin se sa i shkëputur ka qenë procesi i hartimit të planit nga situatë dhe nevojat faktike, sidomos për mirëmbajtjen e automjeteve, të pajisjeve të zyrave, deri tek zëri 6029099 “Shpenzime për te tjera materiale dhe shërbime” prej 300,000 lekë më realizim 0 %, etj.

Grupi i auditimit analizoi pagesat e kryera gjatë vitit 2020, për prokurimet publike me vlerë të vogël, gjithsej 491,220 lekë, sipas tabelës .

### REGJISTRI I REALIZIMEVE TE PROKURIMEVE PUBLIKE (me vlerë të vogël) PER VITIN 2021

Nr.	Objekti i Prokurimit	Investim	Shpenzime (Art. 602)	Burimi i Financimit
6020100	Mjete kancelarike dhe leter A4		238,800	Buxheti
6020200	Materiale pastrimi		118,296	Buxheti
6020300	Tonera per printera dhe fotokopje		257,760	Buxheti
6022001	Elektricitet		-	Buxheti
6022002	Uje		-	Buxheti
6022003	Sherbim Telefonik (Fiks)		-	Buxheti
6022003	Sherbim Interneti		118,800	Buxheti
6022004	Posta		48,680	Buxheti
6022010	Sherbime te printimit dhe publikimit		117,600	Buxheti
6022099	Sherbime te tjera (sherbim perkthyesi)		50,000	Buxheti
6023100	Karburant		958,800	Buxheti
6023200	Goma dhe bateri per makina		197,040	Buxheti
6023300	Shpenzimet e siguracionit te mjeteve te transportit		74,735	Buxheti
6024100	Dieta (Udhetim i brendshem)		2,612,000	Buxheti
6025600	Shpenzime per sherbim konstatim defektesh te automjeteve		36,000	Buxheti
6025600	Shpenzime per riparimin e automjeteve		766,680	Buxheti
6025800	Shpenzime per mirembajtjen e paisjeve te zyrave		-	Buxheti
6026100	Shpenzime per qiramarrje ambjentesh		-	Buxheti
6027400	Shpenzime per ekzekutim te vendimeve gjyqesore per largim nga puna		11,680,247	Buxheti
6029001	Shpenzime per pritje e percjellje		30,000	Buxheti
6029003	Shpenzime gjyqesore		730,728	Buxheti
6029008	Shpenzime per tatime dhe taksa		64,136	Buxheti
6029099	Shpenzime te tjera operative		-	Buxheti



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

	<b>Totali</b>	<b>0</b>	<b>18,100,302</b>	
--	---------------	----------	-------------------	--

### Viti 2022

Plani i përfundimtar i buxhetit të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve për 8 mujorin Janar-Gusht 2022, rezulton në vlerën total **43,334,750 lekë**. Tabela në vijim paraqet në mënyrë të detajuar programet dhe realizimet sipas zërave:

G R	PROG	PROJEK T	ART	PLAN VJETOR	PL THESARI	SHPENZ THESARI	XHIR BREND S H	SIG + TATI ME	FATURA TE PAPAGUARA VITI 2021	BANKA
26	04260	92602AD	600	15,200,000		10,918,393		1,919,773		8,998,620
26	04260	92602AE	600	10,800,000		7,370,261		1,442,891		5,927,370
26	04260	92602AD	601	2,869,750		1,757,273		1,757,273		0
26	04260	92602AE	601	2,280,000		1,320,676		1,320,676		0
			<b>6009999</b>	<b>31,149,750</b>	<b>29,000,000</b>	<b>21,366,603</b>	<b>0</b>	<b>6,440,613</b>	<b>0</b>	<b>14,925,990</b>
26	04260	92602AD	602	5,825,000		2,343,314	2,000	-	-	2,341,314
26	04260	92602AE	602	6,200,000		2,549,130		241,956	581,371	2,888,545
26	04260	92602AD	606	160,000		0	0	-		0
26	04260	92602AE	606	0		0	0	-		0
			<b>6029999</b>	<b>12,185,000</b>	<b>12,025,000</b>	<b>4,892,444</b>	<b>2,000</b>	<b>241,956</b>	<b>581,371</b>	<b>5,229,859</b>
				<b>43,334,750</b>	<b>41,025,000</b>	<b>26,259,047</b>	<b>2,000</b>	<b>6,682,569</b>	<b>581,371</b>	<b>20,155,849</b>

### Institucioni Agjencia Kombëtare e Pyjeve REALIZIMI I SHPENZIMEVE Janar Shtator 2022

Gru pi	Titulli	Kapit.	Artikulli	Emertimi	Plani Vjetor	Limiti Progres.	Fakti Progres.	Diferenca	%
			<b>600+601</b>	<i>Shpenzime Personeli</i>	<b>31,149,750</b>	<b>26,000,000</b>	<b>21,366,603</b>	<b>9,783,147</b>	<b>69%</b>
			<b>602+604+605+606</b>	<i>Shpenzime Tjera</i>	<b>12,185,000</b>	<b>12,025,000</b>	<b>4,892,444</b>	<b>7,292,556</b>	<b>40%</b>
			<b>231</b>	-	-	-	-	-	-
				<i>Totali</i>	<b>43,334,750</b>	<b>38,025,000</b>	<b>26,259,047</b>	<b>17,075,703</b>	<b>61%</b>

### Titulli: Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit

**Situata:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për të 3 vitet 2020, 2021, 2022, nga ana e këtij institucioni është kërkuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, kërkesa nr. 49, datë 21.09.2020, ku paraqitet gjendja financiare dhe fakti i mungesës së buxhetit, si rrjedhojë pamundësia e përmbushjes së detyrave të caktuara më aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

*Për vitin 2020, janë paraqitur kërkesat për fonde buxhetore për këto vite, në një kohë që sipas Sektorit të Financës, nevojat për buxhetet përkatëse janë marrë nga drejtoritë e institucionit nëpërmjet rrugës elektronike, të cilat nuk u gjetën nga ana e grupit të KLSH, për faktin e njohur të zhdukjes së tyre nga sulmi kibernetik dhe moskthimi deri në kohën e kryerjes së auditimit.*

*Argumentimi i kërkesave Megjithatë, kërkesat e bëra ishin të fryra, gjë që le shteg për keqpërdorim të fondeve, gjë që ndikon në aktivitetin dhe performancën, si dhe në rezultatet e arritura të AKP, sipas ligjeve dhe akteve nënligjore.*

-Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për vitin 2021, sipas tabelës së paraqitur rezulton se buxheti i vitit 2021 është realizuar në masën 94



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

përqind, pra me mosrealizim, dhe në vlerë absolute me një vlerë prej 3,080,225 lekë diferencë e porealizuar, nga të cilat:

- shpenzimet e personelit (600+601) rezultojnë me një mosrealizim prej 96% dhe në vlerë absolute 1,179,252 lekë
- shpenzimet e tjera (602+604+605+606) rezultojnë me një mosrealizim prej 90% dhe në vlerë absolute 1,900,973 lekë.

Siç shihet mosrealizimet janë të konsiderueshme, sidomos në “shpenzimet e tjera korrente” (602+604+605+606), ku si shkak i tyre është planifikimi i fryrë dhe i paargumentuar i shpenzimeve, e cila ka lënë shteg për shpërdorimin e fondeve, si rezultat i tepërcave të tyre në planifikim.

Nga analiza sipas artikujve, rezulton se mosrealizimet janë të theksuara në llogaritë ekonomike “Shpenzime të tjera operative” me 64 %; “Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme” me 67 %;

“Materiale zyre dhe të përgjithshme” me 73 % (sidomos kancelaria me 66%); “Shpenzime udhëtimi” me 84 %, etj.

Zërat e mësipërm, në mosrealizimin e tyre, tregojnë në mënyrë eksplicite faktin se sa i shkëputur ka qenë procesi i hartimit të planit nga situatë dhe nevojat faktike, sidomos për mirëmbajtjen e automjeteve, të pajisjeve të zyrave, deri tek zëri 6029099 “Shpenzime për të tjera materiale dhe shërbime” prej 300,000 lekë me realizim 0 %, etj.

### **Kriteri:**

-Ligjet “Për buxhetin e vitit 2020, 2021, 2022”, të ndryshuar

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” nr. 09, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit,

- Urdhri i Kryeministrit nr. 24, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”,

**Efekti:** Lenje shteg për keqpërdorim të, gjë që ndikon në aktivitetin dhe performancën, si dhe në rezultatet e arritura të AKP, sipas ligjeve dhe akteve nënligjore.

**Shkaku:** Fakti i krijimit nga e para e AKP Tiranë, si dhe mos përgatitja e duhur e stafit për performancën financiare

**Rëndësia:** E mesme

### **Rekomandim:**

-Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen, të argumentojë kërkesat për fonde me vërtetësi dhe realizëm, duke shmangur si keqpërdorimin e fondeve në rastin e planifikimit të fryrë, ashtu edhe mosrealizimin e detyrave ligjore operative të institucionit në funksion të ligjit, me qëllim rritjen e performancës në aktivitetin e tij.

-Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen, duke shmangur keqpërdorimin e fondeve në rastin e planifikimit të fryrë, nëpërmjet transferimit të fondeve të tepërta brenda vitit, në funksion të mirë menaxhimit dhe kursimit të fondeve buxhetore brenda vitit, duke u vetëmjaftuar me fondet e nevojshme për realizimin eficient të detyrave ligjore operative të institucionit në funksion të ligjit, me qëllim rritjen e performancës në aktivitetin e tij.

## **2. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave në “Agjencinë Kombëtare të Pyjeve”**

a. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.

Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.

### **Baza ligjore:**

-Kodi Procedurës Civile



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”
- Ligji nr.152/2013, “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar
- Ligi nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”
- Ligji nr.9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”
- Ligji nr. 187, datë 8.3.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën elartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”
- Ligj nr. 57/2020 “Për pyjet”
- VKM nr. 570, datë 17.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të AKP-së”
- Urdhri nr. 24 i Kryeministrit “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së AKP-së”
- VKM Nr. 117, datë 05.03.2014, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelite të regjistrit qendror të personelit”

Grupi i audituesve të KLSH-së, për të realizuar objektin e auditimit, në lidhje mbi auditimin *Për zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave*, drejtimi nr.2 i Programit të mësipërm duke fokusuar, në përputhshmërinë e akteve ligjore dhe nënligjore për çështjet si vijon:

a) *Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.*

b) *Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.*

### a) **Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin**

Agjencia Kombëtare e Pyjeve është institucioni shtetëror përgjegjës për mirëqeverisjen e pyjeve në nivel kombëtar, ruajtjen dhe zhvillimin e tyre, përdorimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të burimeve në fondin pyjor kombëtar, si pasuri natyrore me rëndësi kombëtare. Agjencia Kombëtare e Pyjeve, ushtron veprimtarinë në zbatim të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, të VKM nr. 570, datë 17.07.2019 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe funksionit të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, i ndryshuar dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 24, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”. Përgjegjësitë e saj përcaktohen në pikën 2, të nenit 15, të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për pyjet” dhe VKM nr. 570, datë 17.07.2019 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, i ndryshuar. Agjencia Kombëtare e Pyjeve drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili asistohet në punën e tij nga një punonjëse/sekretare dhe ka në total 32 nëpunës e specialistë, të cilët janë të angazhuar në 3 drejtori, ku secila ka në përbërje 3 sektorë, si në vijim;

#### 1. **Drejtoria e Performancës në Pyje**, aktualisht ka në përbërje 10 nëpunës

1.1 Sektori i Vlerësimit të Gjendjes së Pyjeve, Ndërgjegjësimit dhe Promovimit të tyre (përgjegjës + 2 specialistë)

1.2 Sektori i Përcaktimit të Standarteve, Metodologjive dhe Performancës (përgjegjës + 2 specialistë)

1.3 Sektori i Informacionit, Kërkimit dhe Bashkëpunimit Shkencor (përgjegjës + 2 specialistë)

#### 2. **Drejtoria e Menaxhimit të Pyjeve**, aktualisht ka në përbërje 10 nëpunës

2.1 Sektori i Inventarizimit dhe Kadastrës Pyjore (përgjegjës + 2 specialistë)

2.2 Sektori i Planeve të Menaxhimit të Pyjeve (përgjegjës + 2 specialistë)

2.3 Sektori i Monitorimit, Kontrollit dhe Koordinimit me NJQV dhe AKZM (përgjegjës + 2 specialistë)



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

3. **Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse**, aktualisht ka në përbërje 10 nëpunës e punonjës.

3.1 Sektori i Financës dhe Buxhetit (2 *specialistë*)

3.2 Sektori Juridik dhe i Rregullimit të Marrëdhënieve Ligjore (*përgjegjës + 2 specialistë*)

3.3 Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse (*përgjegjës + 2 specialistë + punonjës/shofer*)

Nga auditimi u konstatua se në strukturën e AKP-së, sipas Urdhrit nr. 24 të Kryeministrit “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së AKP-së” ka një total **Plan** prej 32 punonjës por kemi një total **Fakt** prej 27 punonjës. Pra rezultojnë 5 vende vakante që përbën gati 16% të totalit të punonjësve në administratën e AKP-së.

**Pra sa më sipër, ndonëse sipas Urdhrit nr. 24 të Kryeministrit “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së AKP-së” ka një total Plan prej 32 punonjës në strukturën e AKP-së, rezulton një total prej gati 16% vakanca (ekzaktësisht 5 vende vakante) në këtë institucion.**

**Ky është një tregues jo pozitiv për funksionimin me kapacitet të plotë të AKP-së, për pasojë mund të sjellë performancë të dobët të institucionit në realizimin e objektivave.**

### **Planifikimi Rekrutimeve në AKP**

Në zbatim të nenit 18, Kreu II, të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, përgatitet plani vjetor i pranimit në shërbimin civil për pozicionet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, si dhe për pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues.

Nga auditimi u konstatua se raportimet janë bërë mujore dhe janë hedhur në sistemin *administrata.al*

Gjithashtu u konstatua se në lidhje me sistemin HRMIS të gjitha dosjet e punonjësve janë të hedhur në sistem dhe është bërë azhurnimi i tyre. Momentalisht, për shkak të sulmit kibernetik sistemi i HRMIS nuk punon.

#### **1. Planifikimi i nevojave dhe Rekrutime 2020**

Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020

- a. Znj. E. Xh., Specialist Arkiv Protokoll, në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me urdhrin nr. Prot. 188, datë më 11.12.2020.

#### **2. Planifikimi i nevojave dhe Rekrutime 2021**

Në lidhje me planifikimin e nevojave për pranim në shërbimin civil, u konstatua se është bërë planifikimi për nevoja për rekrutim dhe i është dërguar DAP me shkresën nr. Prot.175 datë më 7.12.2020, për vitin 2021

#### **3. Planifikimi i nevojave dhe Rekrutime 2022**

Në lidhje me planifikimin e nevojave për pranim në shërbimin civil për vitin 2022, është dërguar me email, por për shkak të sulmit kibernetik nuk gjenden më.

Gjatë vitit 2022 janë bërë lëvizjet/rekrutimet

Por nga auditimi u konstatua se edhe pse ka patur rekrutime për periudhën objekt auditim, në strukturën fakt të AKP-së rezultojnë pozicione vakante në një masë prej gati 16% të strukturës plan.

### **Dosjet e Personelit**

-Gjatë auditimit u konstatua se, për nëpunësit e AKP-së zbatohen procedurat e legjislacionit për nëpunësin civil parashikuar për institucionet e administratës shtetërore. Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të personelit rezultoi se, ato administrohen të inventarizuara në zbatim VKM nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.





## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

Për periudhën objekt auditimi, grupi i auditimit ka konstatuar se është kryer vlerësimi periodik i rezultateve individuale në punë por nuk janë të bashkëlidhura në dosjet përkatëse të punonjësve. Kjo në kundërshtim me VKM nr. 117, datë 5.3.2014, pika nr 3. *“Dosja e personelit është individuale dhe përmban të dhëna të karakterit teknik, profesional, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë”*.

U audituan gjithsej 15 dosje personale të punonjësve të AKP-së të punësuar gjatë periudhës 2020-2022, nga të cilët:

- 8 dosje personale të nëpunësve të rekrutuar sipas Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- 1 dosje personale të studentëve të ekselencës, të punësuar sipas VKM nr. 766, datë 26.12.2018 “Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, për vitin 2019” dhe VKM Nr. 586, datë 30.8.2019 “Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”;
- 2 dosje personale të punonjësve mbështetës, të punësuar sipas Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- 2 dosje personale të punonjësve me kontratë të përkohshme (6 orë/ditë), të punësuar sipas VKM Nr. 47, datë 22.1.2020, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2020, në njësitë e qeverisjes qendrore” dhe VKM Nr. 1151, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021, në njësitë e qeverisjes qendrore”.
- 2 dosje personale Drejtor Drejtorie

Nga auditimi i këtyre dosjeve të personelit u konstatua se, janë plotësuar në zbatim të VKM nr. 117, datë 05.03.2014, *“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit. Në dosjen teknike të nëpunësit janë përfshirë : LIDHJA NR 1. “Fletëinventari me listën e gjithë dokumentacionit që ndodhet në dosje dhe LIDHJA NR 2. “Të dhënat që duhet të përmbajë fleta prezantuese e dosjes teknike të nëpunësit 1. Numri i identifikimit të nëpunësit civil; 2. Emri, atësia, mbiemri; 3. Numri kombëtar i identifikimit; 4. Shtetësia; 5. Gjinia; 6. Datëlindja; 7. Gjendja civile; 8. Përbërja familjare; 9. Adresa e vendbanimit të përhershëm; 10. Adresa e vendbanimit të përkohshëm; 11. Arsimimi; 12. Diploma; 13. Kualifikimi (llojet); 14. Gradë shkencore (titulli); 15. Njohuri gjuhe të huaj; 16. Data e fillimit të punës në pozicionin përkatës;” 17. Trajnimet e ndryshme pranë DAP, nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA)*

### b) Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.

Nga auditimi në lidhje mbi pagat e punonjësve të aparatit të AKP-së, u konstatua se:

Në bazë të të dhënave në tabelat e mëposhtëme pasqyrohen treguesit e realizimit të fondit të pagave për periudhat raportuese 2020-2022.

Llogaria 6009999, Shpenzime Personeli për vitin 2020

Llogaria ekonomike	Emertimi	Buxheti Vjetor Plani Fillestar Viti 2020	Buxheti Vjetor Plani i Rishikuar Viti 2020	Buxheti Vjetor Faktik deri 31.12.2020
600	Paga	7,100,000	7,100,000	4,765,496
601	Sigurime Shoqërore	1,210,000	1,210,000	795,834
<b>TOTAL</b>		<b>8,310,000</b>	<b>8,310,000</b>	<b>5,561,330</b>

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Sektori i Financës në AKP



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

### Llogaria 6009999, Shpenzime Personeli për vitin 2021

Llogaria ekonomike	Emertimi	Buxheti Vjetor Plani Fillestar Viti 2020	Buxheti Vjetor Plani i Rishikuar Viti 2020	Buxheti Vjetor Faktik deri 31.12.2020
600	Paga	17,000,000	23,748,725	23,292,778
601	Sigurime Shoqërore	4,700,000	4,700,000	3,976,695
<b>TOTAL</b>		<b>21,700,000</b>	<b>28,448,725</b>	<b>27,269,473</b>

*Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Sektori i Financës në AKP*

### Llogaria 6009999, Shpenzime Personeli për vitin 2022

Llogaria ekonomike	Emertimi	Buxheti Vjetor Plani Fillestar Viti 2020	Buxheti Vjetor Plani i Rishikuar Viti 2020	Buxheti Vjetor Faktik deri 31.12.2020
600	Paga	29,000,000	26,000,000	22,781,723
601	Sigurime Shoqërore	5,700,000	5,149,750	3,832,797
<b>TOTAL</b>		<b>34,700,000</b>	<b>31,149,750</b>	<b>26,614,520</b>

*Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Sektori i Financës në AKP*

-Krahasimi përmbledhës i listë pagesave me shumat e urdhër shpenzimit e pagesa e kryer. U bë krahasimi përmbledhës së listë pagesave me likuidimet, ndërsa nuk u konstatuan pasaktësi në shpenzimet për paga e sigurime. Pagesat janë shoqëruar me dokumentacionin mbështetës listë-prezencat, urdhër shpenzimet për paga dhe urdhra të veçantë të titullarit të nënshkruara nga nëpunësi urdhërues, zbatues (Përgjegjësi i financës dhe buxhetit) të nënshkruara edhe nga Dega e Thesarit .

-Respektimi i dispozitave ligjore për përcaktimin e nivelit të pagave, hapja dhe azhurnimi periodik i regjistrit të punëmarrësve (libri i pagave). Niveli i pagave është përcaktuar në zbatim të VKM nr. 187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendës ministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit , kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura , institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit , lidhja 1 “Struktura e pagave për nëpunësit civilë/nëpunësit në të gjitha institucionet pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi”

Nga auditimi me përzgjedhje i listëpagesave për periudhën objekt auditimi u verifikua niveli pagave për çdo punonjës, arsimimi sipas diplomës, vjetërsia në punë me librezën e secilit, ndërsa nuk u konstatuan mospërputhje të nivelit të diplomës me kategorinë e vendit të punës dhe funksionit sipas emërimit. Për rrjedhojë rezultoi se ato janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM nr. 545, datë 11.08.2011 i ndryshuar. Përlllogaritjet e kontributit sigurime shoqërore e shëndetësore përballuar nga punëmarrësi dhe ato nga punëdhënësi, deklarimet, ndalesat si dhe derdhjet e tyre janë bërë në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 7770, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar. Listë pagesat janë përpiluar me gjithë elementet përbërës, sipas listë prezencave dhe shumat e tyre janë të rakorduara. Vendosija e pagave e shtesave mbi pagë janë bërë me klasën përkatëse për çdo kategori dhe ndalesat janë përlllogaritur në përputhje me dispozitat ligjore për kontributet e sigurimeve dhe tatimi mbi të ardhurat, sipas pasqyrës së realizimit të buxhetit.



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

Për përdorimin e fondit të pagave, sigurime shoqërore e shëndetësore është respektuar legjislacionin përkatës ligji nr. 9136, datë 11.09.2013 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, UMF nr. 26, datë 16.04.2009 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” i ndryshuar dhe ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar janë bërë llogaritjet dhe ndalesat për tatimin mbi të ardhurat si dhe derdhjet e tyre në favor të tatimeve.

Nuk është kryer asnjë pagesë për ndihmë ekonomike dhe nuk ka tejkallim të numrit të punonjësve në strukturën organizative. Është mbajtur libër për pagat e punonjësve, dhe janë hedhur pagesat e kryera për secilin punonjës për periudhën të përcaktuara nga emërimi, fillimi marrëdhënies të punës dhe të rakorduar me listë pagesat.

### **Fondi Veçantë**

Për periudhën objekt auditimi, grupi auditimit ka konstatuar se;

- Fondi i veçantë (Ilogaria ek. 606) i miratuar për vitin 2021 për Agjencinë Kombëtare të Pyjeve = 100,000 (njëqind mijë) lekë, fond i cili nuk u shpenzuar deri në fund të vitit 2021.
- Fondi i veçantë (Ilogaria ek. 606) i miratuar për vitin 2022 për Agjencinë Kombëtare të Pyjeve = 160,000 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, fond i cili nuk është shpenzuar deri më tani.

**-Në zbatim të pikës 3. Auditimi I pasqyrave financiare dhe plotësimi I formularëve të bilancit dhe anekseve përkatëse sipas udhëzimeve , të nxjerra nga Ministria e Financave.**

### **Mbi auditimin rregullshmërisë së pasqyrave financiare**

**Objekti i këtij konstatimi është: “Rregullshmëria e pasqyrave financiare dhe niveli e performanca e mbajtjes së kontabilitetit”.**

Për auditimin e kësaj pike sipas drejtimeve të përcaktuara në programin **nr. 891/1, datë 13.10.2022, pika 3**, u mbështetëm në kriteret ligjore si më poshtë:

**Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”**

**-Ligji nr. 40/2020 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”), të përcaktuara në Ligjin nr. 25/, datë 03.2019 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”**

**Ligji nr. 10296, datë 8.7 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.**

**Udhëzimi MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.**

**Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”**

**-UMF nr. 8, datë 09.03.2019 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.**

**-Vendimi i KM nr. 570, datë 17.07.2020 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”.**

### **1.Mbi auditimin e rregullshmërisë së pasqyrave financiare.**

**Lidhur me këtë çështje të programit, u ushtrua auditim mbi ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe vlerësimin e aktivitetit financiar, organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, nxjerrjen e llogarisë vjetore, kuadri ligjor i përdorur mbi sistemin dhe procesin kontabël, kompjuterizimin, raportimin e pasqyrave financiare, në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit të miratuar nga kryetari i KLSH, nr. 891/1, datë 13.10.2022, për periudhën 01.09.2020 deri me datë 30.11.2022, mbajtur me datë 09.12.2022.**



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

Në bazë të programit të auditimit *nr.891/1, datë 13.10.2022, pika 3 "Auditim mbi rregullshmërisë së pasqyrave financiare", për periudhën 01.09.2020 deri me datë 30.11.2022* u shqyrtua dhe u verifikua dokumentacioni i vënë në dispozicion, i Pasqyrave Financiare, ditarët e magazinës, të arkës e të bankës, ditarët e shpenzimeve korente progresive vjetore, zbatimi i buxhetit për vitet në auditim *2020, 2021 deri me datë 30.11.2022* të plotësuar nga *Agjencia Kombëtare e Pyjeve*, në zbatim të ligjit për Kontabilitetin e Pasqyrat Financiare nr. *nr. 25/2019, datë 10.05.2019 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"* Udhëzimit nr. 37, datë 19.12.2006, Udhëzimit nr. 26, datë 27.12.2007, dhe Udhëzimit nr. 10, datë 27.02.2008, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, vendore dhe njësitë që varen prej tyre dhe Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe udhëzimit MF nr. 30, datë 27.12.2011" Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

**Mbas shqyrtimit të dokumentacionit të sipër cituar konstatohet se :**

*Agjencia Kombëtare e Pyjeve* e ka kryer veprimtarinë e saj për vitet 2020 deri me datë 30.11.2022 dhe Pasqyrat Financiare rezultojnë të përgatitura nga Specialiste e Financës *znj. R R. dhe është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i komanduar në detyrë z. K. S,* të nisura me shkresë nr. 242, datë 31.03.2021, Degës së Thesarit Tiranë dhe e vulosur prej saj.

*Nuk rezultojnë pasqyrat financiare të konfirmuara nga Dega e Thesarit Tiranë.*

**Pika 1/a- Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit sipas planit unik kontabël për institucionet publike.**

Për të arritur në opinionin, në se pasqyrat financiare për vitet *2020, 2021* japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktiveve neto dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" (i shfuqizuar), ligjin nr. 25/2019, datë 10.05.2019 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2019 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme", u analizuan pasqyrat financiare të viteve *2020, 2021* dhe pasqyra e shpenzimeve deri me datë *30.11.2022* nga ku rezultoi:

**Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020.**

**Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka filluar aktivitetin e saj në muajin Shtator 2020.**

Për auditimin e Pasqyrave Financiare vitit 2020 u shqyrtua dokumentacioni relevant, prej ku u konstatua **se nuk ishin hapur ditarët e analitikë dhe pasqyrat financiare të vitit 2020 ishin përgatitur nga jashtë (extra kontabël), në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 15, dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 28, ku përcaktohet se:**

**"Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme (si njësi shpenzuese me kontabilitet më vete), para evidentimit të të dhënave në pasqyrat financiare, duhet që te regjistrojë në ditarët e kontabilitetit të gjitha transaksionet financiare të ndodhura gjate periudhës ushtrimore"**

Nga verifikimi rezulton se ishin përgatitur inventarët dhe analizat bashkëlidhur pasqyrave financiare, sipas llogarive 214, 215, 218, 312, 327.

Mbasi u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion bazuar në Kriteret e vlerësimi në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Ligjin nr. 25/2019 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

Qeverisjes së Përgjithshme", UMF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", rezultoi:

AKP Tiranë, ka përgatitur dhe raportuar Pasqyrat Financiare të vitit 2020, nga jashtë (extra kontabël), në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 15, dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 28.

Pjesë përbërëse të PF/2020 janë: Pasqyra e pozicionit financiar (F1); Pasqyra e performancës financiare (F2); Pasqyra e flukseve monetare (F3); Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4); Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare (F5); Pasqyrat statistikore: Investimet dhe burimi i financimit (F6); Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a); Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b); Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8).

Gjithashtu, Pasqyrat Financiare për nga forma janë përgatitur dhe janë plotësuar sipas kërkesave të UMF nr. 8, datë 09.03.2019, ku është dhënë informacion mbi: Emrin e njësisë ekonomike raportuese, AKP Tiranë me **NIPT M02103452A**.

Pasqyrat financiare mbulojnë:

- Një njësi ekonomike raportuese individuale;
- Periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2020-31.12.2020.
- Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë.

Hartimi dhe dorëzimi i Pasqyrave Financiare në Degën e Thesarit është bërë me datë 31 Mars 2021 brenda afatit ligjor.

Përgatitur nga znj. R. R. Specialiste Finance dhe z. T. V. specialist.

Pasqyrat Financiare janë dorëzuar në Degën e Thesarit me shkresën përcjellëse nr. 242, datë 31.03.2021 dhe me vulën e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, të nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i komanduar në detyrë z. K. S. dhe miratuar nga Dega e Thesarit me vulën e Thesarit Tiranë, nr. Prot. 2202, datë 31.03.2021

*Nuk rezultojnë të konfirmuara nga Dega e Thesarit Tiranë, pasqyrat financiare, si dhe formatet bashkëlidhur.*

### **Nga auditimi i Pasqyrave financiare rezultoi:**

Pasqyrat Financiare të vitit 2020, rezultojnë të jenë dorëzuar në Degën e Thesarit me datë 31 Mars 2021, me të dhënat e mëposhtme:

<b>AKTIVI</b>	<b>Në lekë</b>	
	<b>Gjendje në fund të vitit 2020</b>	<b>Gjendja në fund të vitit 2019</b>
<i>Llogaritë</i>		
<b>A. Aktivet</b>	<b>20,102,041</b>	<b>-</b>
<b>I. Aktivet Afat shkurtra</b>	<b>3,365,620</b>	<b>-</b>
<b>1. Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre</b>	<b>0</b>	<b>-</b>
<b>2. Gjendje Inventari Qarkullues</b>	<b>1,088,767</b>	<b>-</b>
<i>Materiale</i>	<i>531,494</i>	<i>-</i>
<i>Inventar i Imët</i>	<i>557,273</i>	<i>-</i>
<b>3. Llogari të Arkëtueshme</b>	<b>2,276,853</b>	<b>-</b>
<i>Operacione me shtetin (Të drejta)</i>	<i>1,936,975</i>	<i>-</i>
<i>Marrëdhënie midis institucioneve apo njësisve ekonomike</i>	<i>339,878</i>	<i>-</i>
<b>II. Aktivet Afat gjata</b>	<b>16,736,421</b>	<b>-</b>
<b>1. Aktive Afatgjata jo materiale</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>2. Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>16,736,421</b>	<b>-</b>
<i>Pyje, Plantacione</i>	<i>-</i>	<i>-</i>
<i>Ndërtesa e Konstruksione</i>	<i>-</i>	<i>-</i>
<i>Instalime teknike, makineri e pajisje</i>	<i>10,653,172</i>	<i>-</i>
<i>Mjete Transporti</i>	<i>3,265,084</i>	<i>-</i>
<i>Inventar Ekonomik</i>	<i>2,818,165</i>	<i>-</i>

### **PASIVI**



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

Llogaritë	Gjendje në fund të vitit 2020	Gjendja në fund të vitit 2019
<b>B. PASIVET (DETYRIMET)</b>	<b>2,276,853</b>	<b>-</b>
<b>I.Pasivet Afat shkurtra</b>	<b>2,276,853</b>	<b>-</b>
<b>I.Llogari të Pagueshme</b>	<b>2,276,853</b>	<b>-</b>
Furnitorë e llogari të lidhura me to(401)	-	-
Detyrime ndaj personelit	1,505,502	-
Hua Afat shkurtra	339,878	-
Detyrime ndaj shtetit(Tatim taksa)	126,071	-
Sigurime Shoqërore	248,969	-
Sigurime Shëndetësore	56,433	-
Organizma të tjerë Shtetërorë	-	-
Kreditorë për mjete në ruajtje	-	-
Kreditorë të ndryshëm	-	-
<b>C. AKTIVET NETO/FONDET (A-B)</b>	<b>17,825,188</b>	<b>-</b>
<b>D. FONDI I KONSOLIDUAR</b>	<b>17,825,188</b>	<b>-</b>
Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	22,788,961	-
Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	-4,963,773	-
Teprica e Granteve kapitale të Brendshme	-	-
Teprica e Granteve kapitale të Huaja	-	-
<b>E. TOTALI I PASIVEVE(B+C)</b>	<b>20,102,041</b>	<b>-</b>
<b>KONTROLLE Shifra 0(zero)- Tregon Kuadraturën</b>	<b>Kuadratura</b>	<b>Kuadratura</b>
K1.Aktivitet Neto a janë të barabarta me Fondin e Konsoliduar	0	0
K2.Totali i Aktiveve a është i barabartë me=Totalin e Pasiveve	0	0

**Në anekset bashkëlidhur Projekt-Raportit evidentohen testet thelbësore** në lidhje me llogaritë të cilat janë vlerësuar si materiale, bazuar në materialitetin e përcaktuar dhe që përbëjnë një evidencë të mjaftueshme për dhënien e opinionit të auditimit mbi pasqyrat financiare të mbyllura për periudhën 01.09.2020-31.12.2020.

Nga të dhënat e evidentuara në pasqyrat financiare të vitit 2020 sipas aktivitetit, **Grupi I-Aktivitet Afat shkurtra** evidentohen në vlerën **3,365,620 lekë**, ndërsa në **Grupin II-Aktivitet Afat gjata** evidentohen me një vlerë prej **16,736,421 lekë**. Totali i aktivitetit evidentohet në vlerën **për 20,102,041 lekë** dhe është i barabartë me totalin e Pasivitetit.

Më hollësisht plotësimi i pasqyrave financiare analizohet në anekset tabela nr.2

**Llogaritë e Klasës 4**, sikurse evidentohen në pasqyrat financiare me datë 31.12.2020 paraqiten në vlerën **2,276,853 lekë** që përbëhet nga llogaria kontabël *Operacione me shtetin(Të drejta)* në vlerën **1,936,975 lekë** dhe *Marrëdhënie midis institucioneve apo njësisive ekonomike* në vlerën **339,878 lekë** (shih anekset tabela nr. 3)

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (Debitor) në vlerën **1,936,975 lekë** pasqyrojnë detyrimin e shtetit ndaj Institucioneve publike për shpenzimet e konstatuara të vitit 2020 por që do të përballohen nga buxheti i vitit 2021, si dhe detyrime ndaj punonjesve për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore, e rakorduar kjo me llogaritë në pasiv 421,431,435,436 në Postin B-të Bilancit.

**Llogaritë e klasës së 4**, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës së 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debiti të llogarive financiare të klasës së 5.

### **Grupi A- AKTIVE Afatgjata**

**II-Aktivitet Afatgjata** evidentohen në vlerën **16,736,421 lekë**.

Llogaritë e Klasës 21 “**Aktivitet Afatgjata materiale**” përfaqësojnë vlerën **16,736,421 lekë** sipas të dhënave pasqyruar për vitin ushtrimor 2020 (Tabela nr. 3).

Të dhënat për amortizimin janë nxjerrë nga pasqyra nr. 7.b, pasi në pasqyrat financiare nuk evidentohet shuma e akumuluar e amortizimit në llogarinë 219(Tabela nr. 4)

Në aktivin e pasqyrave vjetore nuk paraqiten shumat e amortizimit të akumuluar 219, për Aktivitet afatgjata materiale, por paraqitja e AAGJM është evidentuar me vlerën neto të tyre



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

(Kosto historike minus amortizimin e akumuluar), veprim ky moszbatim të me Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 31, ku citohet se:

“Aktivet afatgjata paraqiten në pasqyrat financiare vjetore me koston e tyre historike (vlerën fillestare), duke evidentuar veçmas amortizimin e tyre”

**Llogaria 214 “Instalime elektrike, makineri e paisje”,** për vitin 2020 paraqitet në vlerën **10,653,172 lekë**, vlerë cila rezulton e reflektuar në pasqyrën nr. 7/a dhe 7b në mbyllje të vitit ushtrimor.

**Llogaria 215 “Mjete transporti”** evidentohet në një vlerë prej **3,265,084 lekë** që paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të AKP më datë 31.12.2020, cila rezulton e reflektuar në pasqyrën nr. 7/a dhe 7b në mbyllje të vitit ushtrimor.

**Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”** është evidentuar në bilanc në një vlerë prej **2,818,165 lekë** që paraqet vlerën e inventarit ekonomik në pronësi të AKP më datë 31.12.2020, cila rezulton e reflektuar në pasqyrën nr. 7/a dhe 7b në mbyllje të vitit ushtrimor.

**Llogaria inventariale 31 “Materiale” në vlerën 531,494 lekë dhe 32 “Inventar i Imët”,** pasqyrojnë gjendjen e materialeve dhe inventarit të imët, sipas inventareve fizik e kontabël **me datë datë 31.12.2020.**

*Pasqyra e aseteve paraqitet në aneks tabela 5.*

**Llogaritë e Arkëtueshme (Kërkesa arkëtimi mbi debitorët)** për vitin 2020 paraqitet në **vlerën 2,276,853 lekë** dhe përbëhet nga **Llogaria 4342-Operacione me shtetin(Të drejta)** në vlerën **1,936,975 lekë**, që përfaqëson detyrimet e shtetit ndaj institucioneve publike për shpenzimet e konstatuara të vitit 2020 që përballohen me fondet buxhetore të vitit 2021 si dhe shpenzimet për paga, kontributet e sigurimeve shoqërore e tatimi mbi të ardhurat e punonjësve të muajit Dhjetor që likuidohen në Janar 2020.

**B.Pasivet (detyrimet) e Pasqyrave Financiare vjetore** evidentohet në **vlerën 20,102,041 lekë** e kuadruar me aktivin e Pasqyrave Financiare vjetore në të njëjtën vlerë dhe përfaqëson:

**I.Pasivet Afat shkurtër për vitin 2020** të cilat evidentohen në vlerën **2,276,853 lekë** dhe përfaqësohen nga llogaritë e **klasës 4 “Llogari të Pagueshme”** në të njëjtën vlerë.

**Llogaritë e klasës 4**, në pasiv të Pasqyrës, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e AKP më 31.12.2020, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2020, huatë afat shkurtër, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2020.( Aneksi tabela nr. 6).

**Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”** evidentohet në një **vlerë 1,505,502 lekë** që përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

**Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”** evidentohet në një **vlerë prej 126,071 lekë** që përfaqëson detyrime për tu paguar nga subjektit ndaj shtetit tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

**Llogaria 435, “Sigurime shoqërore”** evidentohet në **vlerën 248,969 lekë** dhe paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të cilat paguhen në vitin e ardhshëm në Janar.

**Llogaria 436, “Sigurime shëndetësore”** evidentohet në **vlerën 56,433 lekë** dhe paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shëndetësore për pagat e muajit dhjetor të cilat paguhen në vitin e ardhshëm në Janar.

**C. Aktivet neto/fondet (A-B)** në fund të **vitit 2020** evidentohet në **vlerën 17,825,188 lekë**, me një vlerë të barabartë me **klasën D “FONDI I KONSOLIDUAR”**.

**D. “fondi i konsoliduar”, në fund të vitit 2020** evidentohet në **vlerën 17,825,188 lekë.**

**Pasqyra e Performancës financiare (F2)**



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

Të ardhurat dhe shpenzimet, e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të AKP më datë 31.12.2020 janë të rakorduara me Degën e Thesarit.

Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, llogaria 85 "Rezultati i veprimtarisë vitit ushtrimor" evidentohet me deficit në vlerën **-4,963,773 lekë**, sikurse evidentohet edhe në Pasqyrën e Performancës Financiare.

Në Pasqyrën e Flukseve Monetare, evidenton likuiditetet dhe gjendjen më datë 31.12.2020.

### **Pasqyra e Flukseve Monetare (CASH FLOW), Formatit nr. 3**

Në këtë pasqyrë është dhënë informacion mbi akordimin e fondeve buxhetore për shpenzime korente, për detyrime e shpenzime korente, për shpenzimet kapitale (investimet), transfertat, rritja/rënia neto e mjeteve monetare, si dhe tepricat e likuiditeteve në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor, (Tabela 7 Anekse)

Nga verifikimi i kryer rezultoi se vlera totale e Aktiveve neto/Fonde neto të paraqitura në "Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto", është e barabartë me vlerën e tyre të paraqitur në pasqyrën e "Pozicionit financiar" **në vlerën 17,825,188 lekë**.

Pasqyra e Aktiveve neto/Fonde neto është plotësuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në UMF për "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në Aktivet neto/Fondet neto".

Edhe shënimet shpjeguese (Pasqyra F5) në përgjithësi janë plotësuar sipas udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 03.09.2019, pika 3.7 "Rregullat për dhënien e shpjegimeve për pasqyrat financiare individuale".

**Megjithatë u konstatua se nuk ishin plotësuar me të gjitha ekstremet rubrikat si më poshtë:**

**Rubrika 1: Nuk është plotësuar rubrika që shënon datën e e paraqitjes së Llogarisë vjetore në Degën e Thesarit Tiranë, lidhur me vendin e paraqitjes, numri dhe data e protokollit të AKP Tiranë.**

**Rubrika 2: Nuk është plotësuar rubrika që shënon datën e e paraqitjes së Llogarisë vjetore në Degën e Thesarit Tiranë, si dhe nr, e protokollit të institucionit marrës së pasqyrave financiare.**

### **Pasqyrat statistikore**

#### **Pasqyra statistikore nr. 8 "Numri i punonjësve dhe Fondi i pagave".**

Në këtë pasqyrë është dhënë informacion mbi numrin e punonjësve, fondin e pagave, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe tatimin mbi të ardhurat.

Plotësimi i Pasqyrës së Statistikore "Numri i punonjësve dhe fondi i pagave" është bërë në zbatim të kërkesave të përcaktuara në UMF nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 3.8.4 "Rregulla për plotësimin e pasqyrës statistikore mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave".

#### **Formati 3/1-Shpenzimet e vitit ushtrimor 2020.**

Shpenzimet e ushtrimit të vitit 2020, sipas formatit 3/1, evidentohen në vlerën **6,900,748 lekë** që përfaqësohen nga:

**I. Pagat dhe përfitimet e punonjësve me një vlerë 6,425,276 lekë**

**II. Kontribute të Sigurimeve në vlerën 1,073,019 lekë,**

**III Blerje Mallra e Shërbime** në vlerën **491,220 lekë** e cila përbëhet nga: llogaria 6020 "Materiale zyre e të përgjithshme" në vlerën **179,460 lekë**, llogaria 6021 "Materiale dhe shërbime speciale" në vlerën **5,000 lekë**, llog 6022 "Shërbime nga te trete" vlerën **6,260 lekë**, llog.6024 "Shpenzime udhëtimi" në vlerën **214,500 lekë**, llog. 6025 "Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme" në vlerën **36,000 lekë**, llogaria 6027 "Shpenzime për detyrime për kompensime legale" në vlerën **50,000 leke**.

**VIII. Ndryshim i gjendjeve te inventarit (+-) në vlerën -1,088,767 lekë**

**Formati 3/1-Të Ardhurat e vitit ushtrimor 2020.**





## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

**Të Ardhurat e vitit ushtrimore të vitit 2020 evidentohen në vlerën 1,936,975 lekë**, e cila perfaqësohet nga:

### **Klasa 7: A. Të Ardhurat**

**IV Grante Korente** në vlerën 1,936,975 lekë.

### **Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021.**

Për auditimin e Pasqyrave Financiare vitit 2021 u shqyrtua dokumentacioni relevant, prej ku u konstatua **se nuk ishin hapur ditarët e analitikë dhe pasqyrat financiare të vitit 2021 ishin përgatitur nga jashtë (extra kontabël)**, në kundërshtim me ligjin nr. 25/2019, datë 10.05.2019 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 15, dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2019 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 28, ku përcaktohet se:

**"Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme (si njësi shpenzuese me kontabilitet më vete), para evidentimit të të dhënave në pasqyrat financiare, duhet që të regjistrojë në ditarët e kontabilitetit të gjitha transaksionet financiare të ndodhura gjatë periudhës ushtrimore"**

Nga verifikimi rezulton se ishin përgatitur inventarët dhe analizat bashkëlidhur pasqyrave financiare, sipas llogarive 214, 215, 218.

Nuk ishin përgatitur inventarët, analizat, sipas llogarive 31 "Materiale" për vlerën 1,583,417 lekë dhe 32 "Inventar i Imët" për vlerën 557,273 lekë, në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2019.

Mbasi u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion bazuar në Kriteret e vlerësimit në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Ligjin nr. 25/2019 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, UMF nr. 8, datë 09.03.2019 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", UMF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", rezultoi:

**AKP Tiranë, ka përgatitur dhe raportuar Pasqyrat Financiare të vitit 2021, nga jashtë (extra kontabël)**, në kundërshtim me ligjin nr. 25/2019, datë 10.05.2019 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 15, dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 28.

Pjesë përbërëse të PF/2021 janë: Pasqyra e pozicionit financiar (F1); Pasqyra e performancës financiare (F2); Pasqyra e flukseve monetare (F3); Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4); Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare (F5); Pasqyrat statistikore: Investimet dhe burimi i financimit (F6); Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a); Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b); Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8).

**AKP Tiranë, ka përgatitur dhe raportuar Pasqyrat Financiare të vitit 2021, nga jashtë (extra-kontabël).**

Gjithashtu, Pasqyrat Financiare për nga forma janë përgatitur dhe janë plotësuar sipas kërkesave të UMF nr. 8, datë 09.03.2019, ku është dhënë informacion mbi: Emrin e njësisë ekonomike raportuese, AKP Tiranë me **NIPT M02103452A**.

Pasqyrat financiare mbulojnë:

- Një njësi ekonomike raportuese individuale;
- Periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2020-31.12.2020.
- Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë.



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

Hartimi dhe dorëzimi i Pasqyrave Financiare në Degën e Thesarit është bërë me datë 15 Mars 2022 brenda afatit ligjor.

### **Nga auditimi i Pasqyrave financiare rezultoi:**

Pasqyrat financiare vjetore 2021 janë dorëzuar në Degën e Thesarit me datë 15 Mars 2022, me të dhënat e mëposhtme:

#### **AKTIVI**

Llogaritë	Në lekë	
	Gjendje në fund të vitit 2021	Gjendja në fund të vitit 2020
<b>A. Aktivet</b>	<b>33,835,127</b>	<b>20,102,041</b>
<b>III. Aktivet Afat shkurtra</b>	<b>4,870,432</b>	<b>3,365,620</b>
<b>1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>2. Gjendje Inventari Qarkullues</b>	<b>2,140,690</b>	<b>1,088,767</b>
Materiale	1,583,417	531,494
Inventar i Imët	557,273	557,273
<b>3. Llogari të Arkëtueshme</b>	<b>2,729,742</b>	<b>2,276,853</b>
Operacione me shtetin(Të drejta)	2,389,864	1,936,975
Marrëdhënie midis institucioneve apo njësisve ekonomike	339,878	339,878
<b>IV. Aktivet Afat gjata</b>	<b>28,964,695</b>	<b>16,736,421</b>
<b>1.Aktive Afatgjata jo materiale</b>		-
<b>2. Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>28,964,695</b>	<b>16,736,421</b>
Pyje, Plantacione		-
Ndërtesa e Konstruksione		-
Instalime teknike, makineri e paisje	7,989,879	10,653,172
Mjete Transporti	9,750,526	3,265,084
Inventar Ekonomik	11,224,289	2,818,165

Por nga auditimi u konstatua se, llogaria sintetike 215 "Mjete Transporti" për shumën me vlerë të mbetur 9,750,526 lekë nuk përputhet me vlerën e automjeteve deri më datë 31.12.2021, të cilat janë bërë hyrje me veltë fillestare dhe të mbetur, si më poshtë:

Automjet TIP Mitsubishi Pajero TR 8785, copë 1 x 3,679,568 = 3,679,568 lekë

Autoveturë TIP Toyota Yaris AA 542PK, copë 1 x 5,006,418 = 5,006,418 lekë

Automjet TIP Mitsubishi Pajero TR 87331, copë 1 x 3,679,568 = 3,679,568 lekë

Automjet TIP Hyundai AA 190 JM, copë 1 x 2,705,667 = 2,705,667 lekë

Automjet TIP Mitsubishi Eclipse AB 402 DK, copë 1 x 4,458,350 = 4,458,350 lekë

Gjithsej "Mjete Transporti" vlera fillestare: 19,529,571 lekë dhe në vlerë neto: 6,550,526.

**Vlera e mësipërme nuk rakordon me vlerën e bilancit për mjetet e transportit prej 9,750,526 lekë me një diferencë më pak prej 3,200,250 lekë.**

Nga auditimi i fletë-hyrjeve të vitit 2022 rezulton se me FH nr. 1, datë 02.02.2022 është bërë hyrje nga ish-ISHMPUT Durrës automjeti Chevrolet fuori stradë Targë SH 5675 E, copë 1 x 3,250,250 lekë, aq sa është vlera e diferencës së llogarisë sintetike me inventarin analitik.

Theksojmë se inventari bashkëlidhur pasqyrave financiare është paraqitur kontabël por edhe fizik, në një kohë që në inventarin fizik të komisionit të inventarizimit nuk është paraqitur automjeti Chevrolet fuori stradë Targë SH 5675 E, copë 1 x 3,250,250.

Diferenca në vlerë prej 3,200,250 lekë ka ardhur për shkak se në inventarin bashkëlidhur pasqyrave financiare, inventar kontabël dhe fizik, është përfshirë edhe vlera e automjetit Chevrolet fuori stradë Targë SH 5675 E, copë 1 x 3,250,250.

Në mungesë të ditarit analitik edhe për vitin 2022, nuk mund të verifikohet kontabilizimi i kryer nga financa.

Sa sipër mbajnë përgjegjësi hartuesit e pasqyrave financiarë z. T. V dhe znj. R. R.

#### **PASIVI**

Llogaritë	Gjendje në fund të vitit 2021	Gjendja në fund të vitit 2020
<b>B. PASIVET (DETYRIMET)</b>	<b>2,729,742</b>	<b>2,276,853</b>
<b>1.Pasivet Afat shkurtra</b>	<b>2,729,742</b>	<b>2,276,853</b>
<b>1.Llogari të Pagueshme</b>	<b>2,729,742</b>	<b>2,276,853</b>
Furnitorë e llogari të lidhura me to(401)		-
Detyrime ndaj personelit	1,870,426	1,505,502



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

Hua Afat shkurtra	339,878	339,878
Detyrime ndaj shtetit(Tatim taksa)	136,997	126,071
Sigurime Shoqërore	311,771	248,969
Sigurime Shëndetësore	70,670	56,433
Organizma të tjerë Shtetërorë		-
Kreditorë për mjete në ruajtje		-
Kreditorë të ndryshëm		-
<b>C. AKTIVET NETO/FONDET (A-B)</b>	<b>31,105,385</b>	<b>17,825,188</b>
<b>D. FONDI I KONSOLIDUAR</b>	<b>31,105,385</b>	<b>17,825,188</b>
Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	28,116,487	22,788,961
Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	2,988,898	-4,963,773
Teprica e Granteve kapitale të Brendshme		-
Teprica e Granteve kapitale të Huaja		-
<b>E. TOTALI I PASIVEVE(B+C)</b>	<b>33,835,127</b>	<b>20,102,041</b>
<b>KONTROLLE Shifra 0(zero)- Tregon Kuadraturën</b>	<b>Kuadratura</b>	<b>Kuadratura</b>
K1.Aktivët Neto a janë të barabarta me Fondin e Konsoliduar	0	0
K2.Totali i Aktiveve a është i barabartë me=Totalin e Pasiveve	0	0

**Në tabelat e anekseve evidentohen testet thelbësore** në lidhje me llogaritë të cilat janë vlerësuar si materiale, bazuar në materialitetin e përcaktuar dhe që përbëjnë një evidencë të mjaftueshme për dhënien e opinionit të auditimit mbi pasqyrat financiare të mbyllura për periudhën 01.09.2021-31.12.2021.

Nga të dhënat e evidentuara në pasqyrat financiare të vitit 2021 sipas aktivitetit, **Grupi I-Aktivët Afat shkurtra** evidentohen në vlerën **4,870,432 lekë, nga 3,365,620 lekë** në vitin 2020, ndërsa në **Grupin II-Aktivët Afat gjata** evidentohen me një vlerë prej **28,964**. (Tabela nr. 8 aneksi).

**Llogaritë e Klasës 4**, sikurse evidentohen në pasqyrat financiare me datë 31.12.2021 paraqiten në vlerën **2,729,742 lekë** që përbëhet nga llogaria kontabël *Operacione me shtetin(Të drejta)* në vlerën 2,389,864 lekë dhe *Marrëdhënie midis institucioneve apo njësisve ekonomike* në vlerën 339,878 lekë (Tabela nr. 9, Aneks)

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (Debitor) në vlerën **2,389,864 lekë** pasqyron detyrimin e shtetit ndaj Institucioneve publike për shpenzimet e konstatuara të vitit 2020 por që do të përballohen nga buxheti i vitit 2021, si dhe detyrime ndaj punonjësve për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore, e rakorduar kjo me llogaritë në pasiv 421,431,435,436 në Postin B-të Bilancit.

**Llogaritë e klasës së 4**, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës së 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës së 5.

### **Grupi A- AKTIVE Afatgjata**

**II-Aktivët Afatgjata** evidentohen në vlerën **16,736,421 lekë**.

Llogaritë e Klasës 21 “**Aktivët Afatgjata materiale**” përfaqësojnë vlerën **16,736,421 lekë** sipas të dhënave pasqyruar për vitin ushtrimor 2020 (Tabela nr. 10, Aneks).

Të dhënat për amortizimin janë nxjerrë nga pasqyra nr. 7.b, pasi në pasqyrat financiare nuk evidentohet shuma e akumuluar e amortizimit në llogarinë 219 si dhe llogaria 681 “Kuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytëzimit” nuk është plotësuar me amortizimin vjetor të vitit 2021 prej 5,114,293.

Llogaria nr. 681 nuk evidenton shumën vjetore të amortizimit për 20,792,061 lekë.

Në aktivin e pasqyrave vjetore nuk paraqiten shumat e amortizimit të akumuluar 219, për Aktivët afatgjata materiale, por paraqitja e AAGJM është evidentuar me vlerën neto të tyre (Kosto historike minus amortizimin e akumuluar), veprim ky moszbatim të me Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 31, ku citohet se:

“Aktivët afatgjata paraqiten në pasqyrat financiare vjetore me koston e tyre historike (vlerën fillestare), duke evidentuar veçmas amortizimin e tyre”



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

**Llogaria 214 “Instalime elektrike, makineri e pajisje”,** për vitin 2021 paraqitet në **vlerën 7,989,879 lekë**, me një pakësim nga viti 2020 prej **2,663,293 lekë**, vlerë cila rezulton e reflektuar në pasqyrën nr. 7/a dhe 7b në mbyllje të vitit ushtrimor.

**Llogaria 215 “Mjete transporti”** evidentohet në një vlerë prej **9,750,526 lekë**, me një shtesë nga viti 2020 prej **6,485,442 lekë**, lekë që paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të AKP më datë 31.12.2020, cila rezulton e reflektuar në pasqyrën nr. 7/a dhe 7b në mbyllje të vitit ushtrimor.

**Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”** është evidentuar në bilanc në një vlerë prej **11,224,289 lekë**, me një shtesë nga viti 2020 prej **8,406,124 lekë**, që paraqet vlerën e inventarit ekonomik në pronësi të AKP më datë 31.12.2020, cila rezulton e reflektuar në pasqyrën nr. 7/a dhe 7b në mbyllje të vitit ushtrimor.

**Llogaria inventariale 31 “Materiale” në vlerën 531,494 lekë dhe 32 “Inventar i Imët”,** pasqyrojnë gjendjen e materialeve dhe inventarit të imët, sipas inventarëve fizik e kontabël me datë datë 31.12.2021.

**Pasqyra e amortizimit vitit 2021, AAGJ/JO M dhe AAGJM, (Nxjerrë nga formati 7/b, tabela 11 Anekse.**

**Llogaritë e Arkëtueshme (Kërkesa arkëtimi mbi debitorët)** për vitin 2020 paraqitet në **vlerën 2,729,742 lekë** dhe përbëhet nga **llogaria 4342-Operacione me shtetin(Të drejta)** në vlerën **2,389,864 lekë**, me një shtesë nga viti 2020 prej **452,889 lekë** që përfaqëson detyrimet e shtetit ndaj institucioneve publike për shpenzimet e konstatuara të vitit 2021 që përballohen me fondet buxhetore të vitit 2022 si dhe shpenzimet për paga, kontributet e sigurimeve shoqërore e tatimi mbi të ardhurat e punonjësve të muajit Dhjetor që likuidohen në Janar 2022.

**B.PASIVET (DETYRIMET) e Pasqyrave Financiare vjetore** evidentohet në **vlerën 33,835,127 lekë** e kuadruar me aktivin e Pasqyrave Financiare vjetore në të njëjtën vlerë dhe përfaqëson:

**I.Pasivet Afat shkurtra për vitin 2021** të cilat evidentohen në vlerën **2,729,742 lekë** dhe përfaqësohen nga llogaritë e **klasës 4 “Llogari të Pagueshme”** në të njëjtën vlerë.

**Llogaritë e klasës 4**, në pasiv të Pasqyrës, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e AKP më 31.12.2021, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2021, huatë afat shkurtra, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2021, (Tabela 12, Anekse).

**Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”** evidentohet në një **vlerë 1,870,426 lekë** që përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

**Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”** evidentohet në një **vlerë prej 136,997 lekë** që përfaqëson detyrime për tu paguar nga subjektit ndaj shtetit tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

**Llogaria 435, “Sigurime shoqërore”** evidentohet në **vlerën 311,771 lekë** dhe paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të cilat paguhën në vitin e ardhshëm në Janar.

**Llogaria 436, “Sigurime shëndetësore”** evidentohet në **vlerën 70,670 lekë** dhe paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shëndetësore për pagat e muajit dhjetor të cilat paguhën në vitin e ardhshëm në Janar.

**C. Aktivët neto/fondet (A-B)** në fund të **vitit 2021** evidentohet në **vlerën 31,105,385 lekë**, me një vlerë të barabartë me klasën **D “FONDI I KONSOLIDUAR”**.

**D. “FONDI I KONSOLIDUAR”,** në fund të **vitit 2021** evidentohet në **vlerën 31,105,385 lekë** dhe paraqitet në tabelën 13 Anekse.

**Pasqyra e Performancës financiare (F2)**



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

Të ardhurat dhe shpenzimet, e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të AKP më datë 31.12.2021 janë të rakorduara me Degën e Thesarit, (Tabela 14 Anekse).

Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, llogaria 85 "Rezultati i veprimtarisë vitit ushtrimor" evidentohet me deficit në vlerën **2,988,898 lekë**, sikurse evidentohet edhe në Pasqyrën e Performancës Financiare.

Në Pasqyrën e Flukseve Monetare, evidenton likuiditetet dhe gjendjen më datë 31.12.2021.

### **Pasqyra e Fluxeve Monetare (CASH FLOË), Formati nr. 3**

Në këtë pasqyrë është dhënë informacion mbi akordimin e fondeve buxhetore për shpenzime korente, për detyrime e shpenzime korente, për shpenzimet kapitale (investimet), transfertat, rritja/rënia neto e mjeteve monetare, si dhe tepricat e likuiditeteve në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor, përmbledhtazi tabela 15 Anekse.

Nga verifikimi i kryer rezultoi se vlera totale e Aktiveve neto/Fonde neto të paraqitura në "Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto", është e barabartë me vlerën e tyre të paraqitur në pasqyrën e "Pozicionit financiar" në vlerën **31,105,385 lekë** (Tabela 16 Anekse) Pasqyra e Aktiveve neto/Fonde neto është plotësuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në UMF për "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në Aktivet neto/Fondet neto".

Edhe shënimet shpjeguese (Pasqyra F5) në përgjithësi janë plotësuar sipas udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. nr. 8, datë 03.09.2019, pika 3.7 "Rregullat për dhënien e shpjegimeve për pasqyrat financiare individuale".

Megjithatë u konstatua se nuk ishin plotësuar me të gjitha ekstremet rubrikat si më poshtë:

Rubrika 1: Nuk është plotësuar rubrika që shënon datën e e paraqitjes së Llogarisë vjetore në Degën e Thesarit Tiranë, lidhur me vendin e paraqitjes, numri dhe data e protokollit të AKP Tiranë.

Rubrika 2: Nuk është plotësuar rubrika që shënon datën e e paraqitjes së Llogarisë vjetore në Degën e Thesarit Tiranë, si dhe nr. e protokollit të institucionit marrës së pasqyrave financiare.

### **Pasqyrat statistikore**

#### **Pasqyra statistikore nr. 8 "Numri i punonjësve dhe Fondi i pagave".**

Në këtë pasqyrë është dhënë informacion mbi numrin e punonjësve, fondin e pagave, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe tatimin mbi të ardhurat.

Plotësimi i Pasqyrës së Statistikore "Numri i punonjësve dhe fondi i pagave" është bërë në zbatim të kërkesave të përcaktuara në UMF nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 3.8.4 "Rregulla për plotësimin e pasqyrës statistikore mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave".

#### **Formati 3/1-Shpenzimet e vitit ushtrimor 2021.**

Shpenzimet e ushtrimit të vitit 2020, sipas formatit 3/1, evidentohen në vlerën **44,770,741 lekë** që përfaqësohen nga:

**I. Pagat dhe përfitimet e punonjësve me një vlerë 23,675,756 lekë**

**II. Kontribute të Sigurimeve në vlerën 4,046,606 lekë,**

**III Blerje Mallra e Shërbime** në vlerën **18,100,302 lekë** e cila përbëhet nga: llogaria 6020 "Materiale zyre e të përgjithshme" në vlerën **614,856 lekë**, llog 6022 "Shërbime nga te trete" vlerën **335,080 lekë**, llog. 6023 "Shpenzime Transporti" në vlerën **1,230,575 lekë**, llog. 6024 "Shpenzime udhëtimi" në vlerën **2,612,000 lekë**, llog. 6025 "Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme" në vlerën **802,680 lekë**, llogaria 6027 "Shpenzime për detyrime për kompensime legale" në vlerën **11,680,247 leke**, llog 6029 "Shpenzime të tjera operative" në vlerën **824,864 lekë**.

**VIII. Ndryshim i gjendjeve te invenarit (+-) në vlerën -1,051,923 lekë**

**Z. T.V.hartues i pasqyrave vjetore**

**Znj. R. R, specialiste finance, hartuese e pasqyrave vjetore**



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

**Z. K.**

**S, Drejtor i Përgjithshëm**

*(Sa më sipër është mbajtur Akt-Konstatimi nr. 01, datë 09.12.2022)*

**Titulli: Pasqyrat financiare të viteve 2020, 2021.**

**Situata:**

-Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për të 3 vitet 2020, 2021, 2022, **nuk ishin hapur ditarët e analitikë dhe pasqyrat financiare të viteve 2020 dhe 2021 ishin përgatitur nga jashtë (extra kontabël).**

Keshtu nuk ishin hapur, mungonin dhe nuk kryheshin veprime kontabël në ditarët e bankës, magazinës, të ardhurave dhe shpenzimeve, ditarin e veprimeve të ndryshme, ditari i pagave, dhe të gjithë ditarët e tjerë, analizat, centralizatori / libri i madh.

-Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për vitet 2020-2021, lidhur me paraqitjen e llogarive të amortizimit, në pasqyrat financiare, **nuk paraqiten shumat e amortizimit të akumuluar 219, për Aktivet afatgjata materiale, por paraqitja e AAGJM është evidentuar me vlerën neto të tyre si dhe llogaria 681 “Kuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytëzimit” nuk është plotësuar me amortizimin vjetor (Kosto historike minus amortizimin e akumuluar).**

-Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), lidhur me shënimet shpjeguese (Pasqyra F5) **nuk ishin plotësuar me të gjitha ekstremet rubrikat si më poshtë:**

*Rubrika 1: Nuk është plotësuar rubrika që shënon datën e e paraqitjes së Llogarisë vjetore në Degën e Thesarit Tiranë, lidhur me vendin e paraqitjes, numri dhe data e protokollit të AKP Tiranë.*

*Rubrika 2: Nuk është plotësuar rubrika që shënon datën e e paraqitjes së Llogarisë vjetore në Degën e Thesarit Tiranë, si dhe nr, e protokollit të institucionit marrës së pasqyrave financiare.*

-Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), lidhur me plotësimin e llogarive të aktiveve afatgjatë dhe rakordimin me inventarët kontabël dhe fizikë, kishte plotësuar llogarinë sintetike 215 “Mjete Transporti” për shumën me vlerë të mbetur 9,750,526 lekë e cila nuk përputhet me vlerën e 5 automjeteve deri më datë 31.12.2021, të cilat janë bërë hyrje me vlerë fillestare 19,529,571 lekë dhe **në vlerë neto 6,550,526.**

Vlera e mësipërme nuk rakordon me vlerën e bilancit për mjetet e transportit prej 9,750,526 lekë me një diferencë më pak prej 3,200,250 lekë.

Nga auditimi i fletë-hyrjeve të vitit 2022 rezulton se me FH nr. 1, datë 02.02.2022 është bërë hyrje nga ish-ISHMPUT Durrës automjeti Chevrolet fuori stradë Targë SH 5675 E, copë 1 x 3,250,250 lekë , aq sa është vlera e diferencës së llogarisë sintetike me inventarin analitik.

Theksojmë se inventari bashkëlidhur pasqyrave financiare është paraqitur kontabël por edhe fizik, në një kohë që në inventarin fizik të komisionit të inventarizimit nuk është paraqitur automjeti Chevrolet fuori stradë Targë SH 5675 E, copë 1 x 3,250,250.

Diferenca në vlerë prej 3,200,250 lekë ka ardhur për shkak se në inventarin bashkëlidhur pasqyrave financiare, inventar kontabël dhe fizik, është përfshirë edhe vlera e automjetit Chevrolet fuori stradë Targë SH 5675 E, copë 1 x 3,200,250.

Në mungesë të ditarit analitik edhe për vitin 2022, nuk mund të verifikohet kontabilizimi i kryer nga financa.

**Kriteri:**

-Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15.

UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pikat 28, 31.

**Efekti:** Mungesë performance lidhur me nivelin e informacionit financiar.



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

**Shkaku:** Dobësi e Sektorit të Financës

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandim:**

-Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa, dhe të hapë ditarët analitikë, si dhe teknikat e tjera të nxjerrjes së pasqyrave, centralizatori / libri i madh/mastro dhe mbi bazën e këtyre të përgatisë pasqyrat financiare të vitit 2022. Për pasqyrat financiare, të përgatiten inventarët dhe analizat sipas posteve të bilancit.

-Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen lidhur me paraqitjen e llogarive të amortizimit dhe në pasqyrat financiare të evidentojë shumat e akumuluar të amortizimit, në llogaritë 209 dhe 219, dhe të evidentohet llogaria 1013. Llogaria nr. 681, të evidentojë saktësisht shumat vjetore të amortizimit të AAGJ.

-Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen lidhur me pasqyrat financiare (Pasqyra F5) duke *plotësuar me të gjitha ekstremet rubrikat 1 dhe 2.*

-Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa dhe të bëjë korrigjimin në pasqyrat financiare të vitit 2022, lidhur me llogarinë sintetike 215 “Mjete Transporti”, duke shtuar në këto pasqyra vlerën e e automjetit Chevrolet fuori stradë Targë SH 5675 E, copë 1 x 3,250,250= **3,200,250 lekë.**

Në të ardhmen të mos lejohen veprime të tilla deformuese të pasqyrave financiare

**Mbi inventarizimin**

Në zbatim të pikës 3 të Programit të Auditimit me Nr.891/1 prot., datë 13.10.2022, nëpërmjet auditimit në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, i mbajtur nga audituesit e KLSH-së, znj. V. B. audituese, z. A. P. auditues, z. A. V. auditues, z. R. A. auditues, znj.Sh. H. audituese, si dhe përfaqësuesve të subjektit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. *Pasqyrat e inventarit;*

2. *Urdhërat e titullarit për inventarizimin:*

Auditimi u krye duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm;

-*Ligji Nr. 10296 , datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin “ i ndryshuar;*

-*Udhëzim i Ministrit të Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik “ i ndryshuar;*

-*Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 570, datë 17.07.2019 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”.*

**Viti 2020**

Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP) nga auditimi u konstatua se: Titullari i Agjencisë Kombëtare të Pyjeve nuk ka nxjerrë urdhër “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të përgjithshëm të mjeteve kryesore dhe vlerësimit të aktiveve të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve “, kjo në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik“, neni 74 përcakton se “Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”.

**Viti 2021**

Nga auditimi u konstatua se Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 26 ku citohet:

Për periudhën raportuese viti 2021 ( Janar -Dhjetor 2021) është nxjerrë urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve ( Urdhër Nr.64, datë 03.09.2021) “ Për ngritjen



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

e komisionit të inventarizimit të përgjithshëm të mjeteve kryesore për vitin 2021”, komisioni i përbërë nga B. H. kryetare, Sh. Sh, J. H. anëtarë.

### **Nga auditimi u konstatua se;**

1.Komisionit të inventarizimit i ngritur me urdhërin e Titullarit të institucionit, në fillim të procesit të inventarizimit i është vënë në dispozicion, lista e aktiveve për inventarizimin e hartuar nga Nëpunësi zbatues mbi bazën e të dhënave të pasqyruara në rregjistrat kontabël të njësisë , duke zbatuar Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

2-Në momentin e fillimit në objekt të procesit të inventarizimit, anëtarët e komisionit nuk kanë përpiluar deklarata, nëse kanë konflikt interesi, veprim në mospërputhje me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 82, ku përcaktohet se: “Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi...”;

3-Komisioni në fillim të veprimtarisë së procesit të inventarizimit, nuk ka hartuar akt-rakordim për të përcaktuar dhe fiksuar në çdo objekt që inventarizohet, numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes të fundit, veprim në mospërputhje me pika 83 e UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” e cila përcakton qartësisht se: “Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletëhyrjes dhe fletëdaljeve nëpërmjet një procesverballi të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja e mbyllja bëhet në prani të komisionit e përgjegjësit material”, për këtë ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i inventarizimit.

4-Komisioni i inventarizimit fizik në përfundim të procesit ka përgatitur raportin informues ( shkresa me Nr.prot.798/2, datë 10.12.2021) për të paraqitur te Titullari i njësisë shpenzuese, informacionin mbi gjendjen fizike të vlerave të aktiveve dhe materialeve të institucionit, përfshirë në mënyre analitike dhe përmbledhëse inventarizimin e kryer sipas llogarive në objektet përkatëse; sipas inventarizimit të kryer në fakt, për gjendjen fizike të vlerave materiale në përfundim të periudhës raportuese data 31.12.2021, e UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

5-Komisioni i inventarizimit, në fletët e inventarizimit fizik ka pasqyruar në lidhje me gjendjen cilësore me evidentim (jashtë përdorimi) të aktiveve, asetëve e vlerave materiale mbi të cilën njësi shpenzuese të bëjë vlerësimin e gjendjes cilësore të tyre, veprim në përputhje me pika 85, germa (a); 86 dhe 95 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Nga auditimi i dokumentacionit të inventarizimit, u konstatua se titullari i institucionit nuk ka ngritur urdhër ( me propozim të nëpunësit zbatues ) për vlerësimin e aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, kjo në kundërshtim me pikën 5 e UMF Nr. 30, datë 27.11.2011 ku përcakton se; “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” e cila përcakton se “Titullari i njësisë publike është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.”

6-Formati i rregjistratit të aktiveve nuk përmban kërkesat minimale si: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, kohën e shpenzimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes , datën e daljes nga pronësia, kjo në kundërshtim me pikën 30 e UMF Nr. 30, datë 27.11.2011 ku përcakton se; “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” e cila përcakton se “Kërkesat minimale që duhet të përmbajë rregjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që





## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

*sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.”*

**7-Rregjistri kontabël nuk rakordon me regjistrin fizik për llogarinë Nr. 215 "Mjete transporti" ( në rregjistrin kontabël të vitit 2021 është pasqyruar mjete tip Chevrolet Fuoristradë gri, me targa Sh 5675 E, me vlerë 3.200.250 lekë). Theksojmë se automjeti tip Chevrolet është bërë hyrje në datë 02.02.2022, dhe nuk duhej të pasqyrohej në inventar kontabël të vitit 2021.**

**8-Inventarizimi i mjeteve:** Aktualisht Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka gjithsej 6 makina, nga këto 6 makina janë në përdorim. Nga auditimi rezultoi se Drejtoria e shërbimeve disponon kartela inventarizimi për 5 mjete të transportit që i përkasin llogarisë 215 "Mjete transporti" (për mjetin e 6 nuk disponohet kartelë inventarizimi). Gjithashtu, u konstatua se për këtë llogari është kryer inventarizimi dhe jo vetëm procesverbale marrje dorëzimi, por kanë hapur kartela përkatëse për çdo mjet ku të jenë firmosur nga personat që i kanë në përdorim si dhe nga komisioni.

Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi; punonjësit e trajtuar në material

**1.Titulli i gjetjes:** Mos përmbushja e detyrave për krijimin e komisioneve

**Situata:** Nga auditimi rezultoi se titullari i institucionit nuk ka nxjerrë urdhër për vlerësimin e aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve

**Kriteri:** Udhëzim i Ministrisë së Financave Nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" , pika 5

**Shkaku:** Moszbatim i akteve ligjore të inventarizimit

**Ndikimi:** Zhvlerësim i aktiveve

**Rëndësia:** E mesme

**1.1Rekomandimi:** Drejtuesi i Agjencisë Kombëtare të Pyjeve ( me propozim të nëpunësit zbatues ) të marrë masa për nxjerrjen e urdhërave për krijimin e komisioneve të vlerësimit të aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve.

**1.2 Rekomandimi:** Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e Urdhërit për krijimin e komisionit për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërin: 215 "Mjete transporti"(mjete tip Chevrolet nuk është pasqyruar në inventarin fizik).

**-1.3 Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Financës në bashkëpunim me komisionet e inventarizimit të aktiveve të merren masat e duhura në të ardhmen që, përpara procesit të inventarizimit të aktiveve të fiksohet numri rendor i fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe të bëhet mbyllja dhe dylllosja e magazinës, hapja dhe mbyllja të bëhet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material.

**2.Titulli i gjetjes:** Format i rregjistër të aktiveve për llogaritë 214, 215, 218

**Situata:** Për llogaritë e mësipërme në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve nuk ekziston një regjistër të aktiveve, ku të specifikohet data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj.

**Kriteri:** Udhëzim i Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.11.2011, pika 30.

**Shkaku:** Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

**Ndikimi:** Mos plotësimi i dokumentacionit shoqërues sipas përcaktimeve ligjore

**Rëndësia:** I Lartë

**2.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës , të marrë masat e nevojshme, që të krijohet e mbahet regjistri i aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit,



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

### **Për kryerjen e auditimit mbi pikën e programit “Mbi ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare”.**

***Mbi auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve (AKP), në bazë të Programit të Auditimit nr. 891/1, datë 13/10/2022, mbajtur në datë 09/12/2022.***

Në zbatim të pikës 3 të Programit të. **“Ruajtja, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare”.**

Për auditimin e kësaj pike sipas drejtimeve të përcaktuara në programin **nr. 891/1, datë 13.10.2022, pika 3**, u mbështetëm në kriteret ligjore si më poshtë:

***Ligj inr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.***

***Udhëzimi MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.***

***Ligji nr. 9936 date 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”.***

***Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar (legjislacioni për blerjet e vogla)***

***Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”***

***-UMF nr. 8, datë 09.03.2019 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".***

***-Vendimi i KM nr. 570, datë 17.07.2020 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”.***

***Lidhur me këtë çështje të programit, u ushtrua auditim në Agjencinë Kombëtare Pyjeve, në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit të miratuar nga kryetari i KLSH, nr. 891/1, datë 13.10. 2022, për periudhën 01.09.2020 deri me datë 30.11.2022, mbajtur me datë 09.12.2022. Në bazë të programit të auditimit nr. 891/1, datë 13.10.2022, pika 3, “ Auditim mbi ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave material dhe monetare”, për periudhën 01.09.2020 deri me datë 30.11.2022 u shqyrtua dhe u verifikua dokumentacioni i vënë në dispozicion, dokumentacioni i bankës për vitet në auditim 2020,2021 deri me datë 09.12.2022 të plotësuara nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve.***

Mga ana e Agjencisë Kombëtare të pyjeve **nuk ishin hapur ditarët e analitikë për vitet 2020, 2021, deri datë 09.12.2022, dhe regjistrimi i shte kryer nga jashtë (extra kontabël)**, në kundërshtim me ligjin nr. 25/2019, datë 10.05.2019 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15, dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 28, ku përcaktohet se:

***“Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme (si njësi shpenzuese me kontabilitet më vete), para evidentimit të të dhënave në pasqyrat financiare, duhet që të regjistrojë në ditarët e kontabilitetit të gjitha transaksionet financiare të ndodhura gjatë periudhës ushtrimore”***

### **3.Rregullariteti i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë dhe valutë në përputhje me disiplinën financiare dhe magazinën për vitet 2019, 2020 deri në datë 30.03.2021.**

Mbasi u shqyrtua dokumentacioni në lidhje me kryerjen e veprimeve me bankë, bazuar në Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; Ligjin nr.10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me ndryshime, UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", UMF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" u konstatua se:

Nga auditimi i dhënies së llogarisë(bilanceve) rezulton se për të 2 periudhat ushtrimore vitin 2020, 2021, nuk rezulton të ketë kryerje të veprimeve me arkë në asnjërin prej monedhave në lekë apo në valutë, për pasojë nuk është mbajtur ditar arke si dhe nuk ka veprime të kryera arkëtime apo pagesa me subjekte dhe operatorë si për arkëtime ashtu dhe për shpenzime. Të gjitha veprimet janë kryer nëpërmjet Bankës.

Nga auditimi i transaksioneve financiare te viteve 2020, 2021, deri më datë 30.11.2022,rezultoi se çdo urdhër shpenzimi ishte nënshkruar nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuara nga nëpunësi i degës Thesarit Tiranë dhe të firmosura e vulosura nga dy palët.

Urdhër shpenzimet në përgjithësi kanë bashkëlidhur dokumente autorizuese, vërtetues, kontabël, sipas natyrës së shpenzimit, përfshirë; (autorizim, urdhër prokurimi, procesverbal, oferta ekonomike, kontrata, fatura furnitori, preventiva e situacione, etj, etj), ndërsa për blerjet e materialeve është bashkëlidhur fletëhyrja e artikullit të blerë. Vlerat e shënuara në urdhër shpenzim përputhen me vlerat e dokumenteve financiare që mbështesin shpenzimin.

Por, nga auditimi i kryer u konstatua se, gjatë gjithë periudhës së audituar, ana e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve **nuk ishin hapur ditarët e analitikë për vitet 2020, 2021, deri datë 09.12.2022, dhe regjistrimi i shte kryer nga jashtë (extra kontabël)**, në kundërshtim me ligjin nr. 25/2019, datë 10.05.2019 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 15, dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 28, ku përcaktohet se:

*"Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme (si njësi shpenzuese me kontabilitet më vete), para evidentimit të të dhënave në pasqyrat financiare, duhet që të regjistrojë në ditarët e kontabilitetit të gjitha transaksionet financiare të ndodhura gjatë periudhës ushtrimore"*

**Sa sipër nga ana e Sektorit të Financës nuk kryhej kontabilizimi veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës.**

**Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se:**

Shpenzimet e kryera nëpërmjet bankës për vitin 2020, 2021 deri me date 30.11.2022, paraqiten si më poshtë:

në 000/lekë

Art.	Viti 2020		Viti 2021		Viti 2022	
	Plani	Fakti	Plani	Fakti	Plani	Fakti 8/mujor
600	7,100	4,765	23,749	23,293	26,000	18,289
601	1,210	796	4,700	3,977	5,150	3,078
602	500	491	20,001	18,100	12,025	4,892
606	-	-	-	-	160	-
<b>Tot.</b>	<b>8,810</b>	<b>6,052</b>	<b>48,450</b>	<b>45,370</b>	<b>43,335</b>	<b>26,259</b>

Burimi i të dhënave –AKP Tiranë

**Mbi zonën e llogarisë 602 "Blerje mallra dhe shërbime"**

Nga auditimi ka rezultuar se, shpenzimet për blerje mallra e shërbime gjatë viteve 2020, 2021 deri me date 31.08.2022 evidentohen sipas pasqyrës së Performancës financiare dhe Situacionit të rakordur me Degën e Thesarit.

Për vitet 2020, 2021 deri me datë 30.11. 2022 për vlerësimin e rregullshmërisë së veprimeve të kryera, për zonën e llogarisë 602 u kryen testet në lidhje me shpenzimet e likuidimit të kontratave të riparimit të automjeteve, kontrata të tjera si për mirëmbajtje, dieta, etj., të cilat janë shpenzime me vlerë të vogël.

**Por u audituan edhe shpenzime të tjera si pagesat për vendimet gjyqësore, gjobat, etj., ku u konstatuan veprime me efekte ekonomike.**



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

Shpenzimet e kryera në llogarinë 602, ishin mbështetur në: urdhrat e prokurimit, kontratat, urdhër shërbimet, vendime gjyqate, situacionet e nënshkruara nga inspektorët e kontratave, urdhrat e titullarit etj, të cilat janë evidentuar për çdo transaksion të audituar, fatura tatimore, fletëdalje, fletëhyrje, procesverbale, akte të marrjes në dorëzim të mallrave e shërbimeve, situacione, ftesa për ofertë, raporte përmbledhëse, të cilat janë evidentuar për çdo transaksion të testuar, dietat ishin dokumentuar sipas ligjit.

**Nga auditimi i veprimeve me bankë, për vitet 2020, 2021 deri datë 30.11.2022, u konstatua se:**

### **Viti 2020**

Por nga auditimi i kryer u konstatua se:

-Urdhër-Shpenzimi nr. 27, datë 16.12.2020, Blerje tonerë për printer dhe fotokopje, 119,500 lekë, likudiuar OE "C. C. C."shpk.

Nga ana e Sektorit të Financës nuk është aplikuar administrimi i pjesëve të vjetra (tonerave), të cilat duheshin bërë hyrje në magazinë të veçantë (rikupero) dhe më pas të krijohet mundësia e përfitimit të tyre duke u shitur ose për skrap.

*Përgjegjësia: R. R, N. Sh. dhe I. S. të cilët kanë nënshkruar faturën tatimore, si dhe kontabilisti T. V. dhe Drejtori z. K. S.*

-Urdhër-Shpenzimi nr. 26, datë 14.12.2020, Shërbim riparim automjeti 36,000 lekë, likudiuar OE G. K. PF.

Bashkëlidhur urdhër- shpenzimit nuk u gjet fletë- hyrja përkatëse.

Përveç kësaj, nga ana e Sektorit të Financës nuk është aplikuar administrimi i pjesëve të vjetra (tonerave), të cilat duheshin bërë hyrje në magazinë të veçantë (rikupero) dhe më pas të krijohet mundësia e përfitimit prej tyre duke u shitur ose për skrap.

Nga ana tjetër rezultoi se nga OE janë blerë pjesë ndërrimi të cilat nuk janë bërë hyrje në magazinë në vlerën 119,500 lekë dhe nuk kemi të bëjmë me shpenzime por me blerje pjesë këmbimi

*Përgjegjësia: R. R, N. Sh. dhe I. S. të cilët kanë nënshkruar faturën tatimore, si dhe kontabilisti T. V. dhe Drejtori z. K. S.*

### **Viti 2021**

-Urdhër-Shpenzimi nr. 145, datë 19.10.2021, Blerje tonera për printer dhe fotokopje, 257,760 lekë, likudiuar OE A. K. PF, është mbajtur proces-verbali nr. 825/1, datë 13.09.2021, Për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike, ku është përlllogaritur fondi limit nga 3 oferta prej 3 operatorësh ekonomikë, konkretisht:

-OE "I. O. shpk", oferta 289,891 lekë, pa TVSH

-OE "R. shpk", oferta 246,033 lekë, pa TVSH

-OE "Add P. shpk", oferta 300,500 lekë, pa TVSH

Dokumentacioni nuk ishte i gjithi bashkëlidhur Urdhër-Shpenzimit, por mbaheshin në dosje më vehte, ku u gjet edhe dokumentacioni online në APP, në "screen shot", i konfirmuar nga anëtarët e komisionit.

Nga ana tjetër rezultoi se nga ana e Komisionit janë refuzuar si oferta anomalisht të ulëta ofertat e operatorëve, të klasifikuara në vendin e parë dhe të dytë, si më poshtë:

-B. I. S. S., prej 157,860 lekë

-A, prej 194,000 lekë

Por, konstatohet se ofertat e këtyre operatorëve janë mbi 50% të vlerës së fondit limit prej 278,808 lekë dhe pra nuk duhet të refuzoheshin paraprakisht si oferta anomalisht të ulëta, pavarësisht tërheqjes apo mosparaqitjes së tyre, veprim ky në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr. 05, datë 25.06.2021, "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", pika 15, germa c.



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

*Nga ana e Sektorit të Financës nuk është aplikuar administrimi i pjesëve të vjetra (tonerave), të cilat duheshin bërë hyrje në magazinë të veçantë (rikupero) dhe më pas të krijohej mundësia e përfitimit të tyre duke u shitur ose për skrap.*

*Përgjegjësia: Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël: R. R. Kryetar (sipas urdhrit nr.6, datë 28.01.2021 ku znj. R.R. caktohet person përgjegjës për prokurimet) dhe E. Xh. dhe I. S. anëtarë, si dhe kontabilisti T. V. dhe Drejtori z. K. S.*

-Urdhër-Shpenzimi nr. 55, datë 20.05.2021 Riparim automjesh, 766,680 lekë, likuduar OE Besnik Meçi, është mbajtur process-verbali nr. 211/1, datë 23.03.2021, Për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike, ku është përlllogaritur fondi limit nga 4 oferta prej 4 operatorësh ekonomikë, konkretisht:

*Fondi limit është përlllogaritur në vlerën 798,635 lekë, duke aplikuar metodën e mesatares së 4 ofertave të marra, në një kohë që oferta më e ulët është 707,180 lekë, e cila edhe duhej marrë për llogaritjen e fondit limit edhe pse kjo nuk ka sjellë pasoja ekonomike për institucionin, sepse OE fituese ka paraqitur ofertë me të ulët se 707,180 lekë (duke zbritur TVSH).*

*Dokumentacioni nuk ishte i gjithi bashkëlidhur Urdhër-Shpenzimit, por mbaheshin në dosje më vehte, ku u gjet edhe dokumentacioni online në APP, në “screen shot”, i konfirmuar nga anëtarët e komisionit*

Në këtë rast, janë kryer shpenzime në shumën 766,680 lekë, me objekt “Shpenz. Mirëmb,Makinave por në këtë dokumentacionin e mbajtur nuk janë argumentuar nga grupi i punës mbi gjëndjen fillestare të automjeteve, amortizimin, të dhënat për kilometrat e përshkruara nga automjetet, shërbimet e kryera, investimet kapitale dhe të përcaktohej nevoja për shërbime mirëmbajtje, mbështetur në dokumentacionin argumentues për kërkesën e bërë.

*Këto veprime janë në kundërshtim me 42-50, të udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.*

Nga ana tjetër rezulton se nga OE janë blerë pjesë ndërrimi të cilat janë bërë hyrje në magazinë me FH 5, datë 17.05.2021, në vlerën 766,680 lekë dhe nuk kemi të bëjmë me shpenzime por me blerje. Është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. 257, datë 01.04.2021, midis AKP dhe B. M, person fizik, në një kohë që kemi të bëjmë me blerje.

*Nga ana e Sektorit të Financës nuk është aplikuar administrimi i pjesëve të vjetra (tonerave), të cilat duheshin bërë hyrje në magazinë të veçantë (pjesë këmbimi) dhe më pas të krijohej mundësia e përfitimit të tyre duke u shitur ose për skrap.*

*Përgjegjësia: Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël: R. R. Kryetar, E. Xh. dhe I. S. anëtarë, si dhe kontabilisti T. V. dhe Drejtori z. K. S.*

-Urdhër-Shpenzimi nr. 52, datë 05.05.2021, Blerje bateri dhe goma për automjete, 197,040 lekë, likuduar OE B. M. PF, është mbajtur proces-verbali nr. 215/1, datë 24.03.2021, Për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike, ku është përlllogaritur fondi limit nga 3 oferta prej 3 operatorësh ekonomikë, konkretisht:

-OE “T. G. A.” oferta 200,000 lekë, pa TVSH

-OE “I. R.” (Gomisteri) oferta 190,000 lekë, pa TVSH

-OE “G. RR.”, oferta 210,000 lekë, pa TVSH

*Fondi limit është përlllogaritur në vlerën 200,000 lekë, duke aplikuar metodën e mesatares së 3 ofertave të marra, në një kohë që oferta më e ulët është 190,000 lekë, e cila edhe duhej marrë për llogaritjen e fondit limit edhe pse kjo nuk ka sjellë pasoja ekonomike për institucionin, sepse OE fituese ka paraqitur ofertë me të ulët se 190,000 lekë (duke zbritur TVSH).*

*Nga ana e Sektorit të Financës nuk është aplikuar administrimi i pjesëve të vjetra (tonerave), të cilat duheshin bërë hyrje në magazinë të veçantë (rikupero) dhe më pas të krijohej mundësia e përfitimit të tyre duke u shitur ose për skrap.*



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

*Përgjegjësia: Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël: R. R. Kryetar dhe E. Xh. dhe I.S.anëtarë, si dhe kontabilisti T. V. dhe Drejtori z. K. S.*

-Urdhër-Shpenzimi nr. 42, datë 20.04.2021, Blerje karburanti, 958,800 lekë, likudiuar OE G.C. shpk, është mbajtur proces-verbali nr. 213/1, datë 23.03.2021, Për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike, ku është përlllogaritur fondi limit nga 3 oferta prej 3 operatorësh ekonomikë, konkretisht:

-OE “K.” shpk oferta 793,000 lekë, pa TVSH

-OE “L.” shpk oferta 799,100 lekë, pa TVSH

-OE “E. D. A.” sha, oferta 210,000 lekë, pa TVSH

*Fondi limit është përlllogaritur në vlerën 799,100 lekë, duke aplikuar metodën e mesatares së 3 ofertave të marra, në një kohë që oferta më e ulët është 793,000 lekë, e cila edhe duhej marrë për llogaritjen e fondit limit edhe pse kjo nuk ka sjellë pasoja ekonomike për institucionin, sepse OE fituese ka paraqitur ofertë me të ulët se 793,000 lekë (duke zbritur TVSH).*

*Përgjegjësia: Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël: R. R. Kryetar, E. Xh. dhe I. S. anëtarë, si dhe kontabilisti T. V. dhe Drejtori z. K. S.*

-Urdhër-Shpenzimi nr. 26, datë 20.04.2021, Mjete kancelarike dhe letër A4, 238,800 lekë, likudiuar OE I. O. shpk, është mbajtur proces-verbali nr. 136/1, datë 22.02.2021, Për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike, ku është përlllogaritur fondi limit nga 3 oferta prej 3 operatorësh ekonomikë, konkretisht:

-OE “C. C. C.” shpk oferta 338,104 lekë, pa TVSH

-OE “O. S.” shpk oferta 309,796 lekë, pa TVSH

-OE “I.” shpk, oferta 252,099 lekë, pa TVSH

*Fondi limit është përlllogaritur në vlerën 300,000 lekë, duke aplikuar metodën e mesatares së 3 ofertave të marra, në një kohë që oferta më e ulët është 252,099 lekë, e cila edhe duhej marrë për llogaritjen e fondit limit edhe pse kjo nuk ka sjellë pasoja ekonomike për institucionin, sepse OE fituese ka paraqitur ofertë me të ulët se 252,099 lekë, (duke zbritur TVSH).*

-Urdhër-shpenzimi nr. 19, datë 04.03.2021, Taksa vjetore TVMP, Gjoha TVMP, të prapambetura, 58,575 lekë, likudiuar OE DPSHTRR Tiranë (subjekt shtetëror), Taksa vjetore për 4 makina, ku brenda vlerës së mësipërme janë llogaritur edhe gjohat për vonesë gjithsej 1,090 lekë, sipas dokumenteve të DRSHTRR datë 01.03.2021, gjoha për te cilat duhej të nxirrej përgjegjësia dhe të paguheshin prej personave përgjegjës, për rrjedhojë nuk duhej të paguhej shuma prej 1,090 lekë nga AKP.

-Urdhër-shpenzimi nr. 17, datë 25.02.2021, Gjoha KTV për automjetet me targa, AA190JM Hyundai, AA542PK Yoyota, TR8733L-Mitsubishi, 3,000 lekë, likudiuar OE DPSHTRR Tiranë (subjekt shtetëror), janë llogaritur edhe gjohat për vonesë gjithsej 3,000 lekë, sipas dokumenteve të DRSHTRR datë 23.02.2021, gjoha për te cilat duhej të nxirrej përgjegjësia dhe të paguheshin prej personave përgjegjës, për rrjedhojë nuk duhej të paguhej shuma prej 3,000 lekë nga AKP.

### Viti 2022

Nga auditimi i kryer u konstatua se:

-Urdhër-shpenzimi nr. 45, datë 15.04.2022, Gjoha ndryshim pronësie jashtë afatit të automjetit me targë AB978GB, 40,000 lekë, likudiuar OE DPSHTRR Tiranë (subjekt shtetëror), është llogaritur gjohat për vonesë ndryshim pronësie prej 40,000 lekë, sipas dokumentit të DRSHTRR datë 25.03.2022, sipas ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 93.

Likuidimi i shumës prej 40,000 lekë është bërë bazuar në urdhrin e Drejtorit të AKP nr. 27, datë 14.04.2022 “Për likuidimin e faturës nr. 2200121603”, për kalimin nga buxheti I institucionit të shumës prej 40,000 lekë gjohë për vonesa në kalim pronësie.



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

Sa më sipër për gjobën në fjalë duhej të nxirrej përgjegjësia për vonesën dhe kjo gjobë të likuidohej prej personit/ave përgjegjës. për rrjedhojë nuk duhej të paguhej shuma prej 40,000 lekë nga AKP.

Përgjegjësia: Drejtori z. A. K. kontabilisti z. T. V

( i cili nuk duhej të pranonte kryerjen e likuidimit).

-Urdhër-shpenzimi nr. 27, datë 02.03.2022, Taksa vjetore TVMP, Gjoba TVMP, të prapambetura, likuiduar OE DPSHTRR Tiranë (subjekt shtetëror), është llogaritur edhe gjoba për vonesë 329 lekë, sipas dokumenteve të DRSHTRR datë 24.02.2022, gjobë për te cilën duhej të nxirrej përgjegjësia dhe të paguhej prej personit/ave përgjegjës, për rrjedhojë nuk duhej të paguhej shuma prej 329 lekë nga AKP. Likuidimi është kryer bazuar në urdhrin e Drejtorit nr. 16, datë 28.02.2022.

### **Lidhur me shpenzimet e kryera për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore**

Në fillimin e krijimit të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, Sektori Juridik dhe i Rregullimit të Marrëdhënieve Ligjore ka vijuar dhe po vijon me ndjekjen e disa prej proceseve gjyqësore të mbartura dhe të krijuara me shkrirjen e ISHMPUT, të cilat kryesisht kanë si objekt “*zgjidhje kontrate e punës*” si dhe “*shpërblim dëmi i shkaktuar nga vendimi administrativ (ISHMPUT)/pavlefshmëri titulli ekzekutiv/ekzekutim titullit ekzekutiv (gjobë)*”.

Në total janë ndjekur 41 procese gjyqësore, ku 16 janë çështje civile dhe 24 janë çështje administrative, si dhe 1 proces penal, i cili konsiston në një proces gjyqësor i përcjellë për kompetencë nga AKM me objekt “*falsifikim dokumentesh*”.

Për rastin e procesit penal, Agjencia Kombëtare e Pyjeve vijoi procedurën për shkak të thirrjes nga gjykata sepse pretendimet ndaj të pandehurve binin mbi një truall i cilësuar si fond pyjor.

Fazat në të cilat vijnë proceset gjyqësore janë si më poshtë:

- 12 procese gjyqësore janë në fazën e Ankimit;
- 3 procese gjyqësore janë në fazën e Rekursit;
- 1 çështje është në fazë likuidimi;
- 15 procese gjyqësore janë në gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor;
- 8 çështje janë të mbyllura;
- 2 janë përcjellë për kompetencë AKM.

*Sa më sipër*, të gjitha procedurat e lartpërmendura janë çështje ku Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka qenë palë e tretë, ose është kërkuar zëvendësim palësh. Gjithashtu, nga ana e agjencisë është kërkuar mos legjitimitimi i AKP si palë, (sidomos në çështjet civile objekt marrëdhënie pune) për shkak të procedurës së ndjekur nga institucioni tjetër.

Nga auditimi i kryer në Sektorin e Financës, u konstatua se gjatë viteve 2021, 2022, Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka kryer shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, shpenzime të cilat janë kryer në favor të punonjësve dhe specialistëve **të cilët janë larguar nga institucioni (ish-ISHMPU)** nga eprorët dhe strukturat drejtuese, pagesa të cilat janë kryer për të njëjtin vend pune 2 persona.

Gjatë viteve 2021 deri Shtator 2022, janë kryer gjithsej **13,176,275 lekë shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore**, shpenzime të kryera sipas urdhrave të strukturave të cilat kanë vendosur largimin e punonjësve dhe specialistëve nga institucioni. Në këto shpenzime përfshihet edhe përmbarimi gjyqësor sipas Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë të Financave dhe të Drejtësisë nr. 385/7, datë 28.6.2017 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor privat”.

Më poshtë po paraqesim në mënyrë sintetike, realizimin sipas viteve të shpenzimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore:



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

Viti	Art.	Emërtimi	Plani Vjetor	Fakti Progr.	Diferenca	%
2021	6027	Shpenzime per ekzekutimin vendimeve gjyqësore	11,876,275	11,680,247	196,028	98%
Janar-Shtator 2022	6027	Shpenzime per ekzekutimin vendimeve gjyqësore	1,300,000	1,279,210	20,790	98%
<b>GJITHSEJ</b>		<b>Shpenzime per ekzekutimin vendimeve gjyqësore</b>	<b>13,176,275</b>	<b>12,959,457</b>	<b>216,818</b>	<b>98%</b>

Po paraqesim analitikisht shpenzimet gjyqësore. Kështu për periudhën e audituar u konstatuan **22 raste** pagesa shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, për një vlerë të përgjithshme prej **13,625,229** lekë, nga të cilat **1,382,034** lekë janë shpenzime për tarifa përmbare, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Urdhër-Shpenzimi	Emërtimi i Shpenzimit	Vlera			Urdhri largimit
			Vendimi	Përmb	Gjithsej	
1.	Nr.53, dt. 05.05.21	Vendim gjyqësor L. S.	659,860	79,183	739,043	Nr.234, dt.09.09.16
2.	Nr.54, dt. 20.05.21	Vendim gjyqësor D. E.	946,000	94,600	1,040,600	Nr.142, dt.03.07.17
3.	Nr.73, dt. 10.06.21	Vendim gjyqësor A. A.	307,300	28,800	336,100	Nr.263, dt.01.08.17
4.	Nr.74, dt. 10.06.21	Vendim gjyqësor N. K.	815,000	81,500	896,500	Nr.253, dt.28.07.17
-	Nr.141, dt. 05.10.21	Vendim gjyqësor N. K.	40,000	-	40,000	“ “
5.	Nr.79, dt. 22.06.21	Vendim gjyqësor L. Ç.	1,145,720	-	1,145,720	Nr.1, dt.10.01.18
6.	Nr.80, dt. 05.07.21	Vendim gjyqësor I. C.	51,480	-	51,480	Nr.14, dt.18.01.18
-	Nr.81, dt. 08.07.21	Tarifa përmbare D. M.		15,000	15,000	-
7.	Nr.82, dt. 05.07.21	Vendim gjyqësor F. M.	1,305,363	144,643	1,350,006	Nr.403, dt. 31.10.18
8.	Nr.108, dt. 25.08.21	Vendim gjyqësor L. A.	902,170	90,217	992,387	Nr.332, dt. 09.08.18
9.	Nr.127, dt. 10.09.21	Vendim gjyqësor B. M.	834,800	83,480	918,280	Nr.218/1, dt. 07.05.18
10.	Nr.129, dt. 10.09.21	Vendim gjyqësor M. Sh.	779,230	77,923	857,153	Nr.11, dt. 12.01.17
11.	Nr.128, dt. 10.09.21	Vendim gjyqësor A. Xh.	63,000	120,000	183,000	Nr.000187-5,d. 10.04.19
12.	Nr.130, dt. 10.09.21	Vendim gjyqësor A. Sh.	63,000	15,000	78,000	Nr.000449,dt. 07.08.19
13.	Nr.140, dt. 05.10.21	Vendim gjyqësor E. B.	459,000	30,000	489,000	Nr.221,dt. 30.06.16
14.	Nr.142, dt. 05.10.21	Vendim gjyqësor A. V.	750,260	90,031	840,291	Nr.462,dt. 13.12.18
15.	Nr.29, dt. 22.12.20	Vendim (parapagim) D. S.	50,000	-	50,000	-
	Nr.146, dt. 26.10.21	Vendim gjyqësor D. S.	193,400	22,000	215,400	Nr.3,dt. 04.02.17
16.	Nr.147, dt. 26.10.21	Vendim gjyqësor O. H.	123,958	22,000	145,958	Nr.5, dt. 26.09.17
17.	Nr.86, dt. 13.07.22	Vendim gjyq. D. M.	35,000	-	35,000	Nr.51, dt. 29.04.16
18.	Nr.64, dt. 07.06.22	Vendim gjyq. F. N.	926,120	111,134	1,037,254	Nr.2, dt. 10.01.18
19.	Nr.179, dt. 28.12.21	Vendim gjyq. B. K.	440,484	129,007	569,491	Nr.60, dt. 15.12.14
20.	Nr.173, dt. 13.12.21	Vendim gjyq. G. G.	664,260	66,426	730,686	Nr.116, dt. 25.05.17
21.	Nr.172, dt. 13.12.21	Vendim gjyq. E. P.	660,900	66,090	726,990	Nr.115, dt. 25.05.17
22.	Nr.171, dt. 13.12.21	Vendim gjyq. F. P.	26,890	15,000	41,890	Nr.13, dt. 07.09.18
		<b>TOTALI</b>	<b>12,243,195</b>	<b>1,382,034</b>	<b>13,625,229</b>	

*Sa sipër pagesat janë kryer në bazë të urdhrit nr. 1944, datë 19.06.2020, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për likuidimin e të gjithë vendimeve gjyqësore për t'u likuiduar. Vendimet e marra për shumën e likuiduar prej 13,625,229 lekë pagesa vendime gjyqësore, të kryera nga strukturat e ish-ISHMPU të cilat ka nxjerrë vendimet për largimin e punonjësve, kanë sjellë efekte të konsiderueshme financiare, duke ulur ndjeshëm performancën financiare të institucionit.*

Z. T. V, hartues i pasqyrave vjetore,

Znj. R. R, specialiste finance, hartuese e pasqyrave vjetore,

Z. K.S, Drejtor i Përgjithshëm.

**Titulli: Mbi veprimet e bankës.**

**Situata:** -Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), lidhur me veprimet e kryera nëpërmjet bankës, në 3 raste të shërbimeve të kryera automjeteve, nga ana e Sektorit të Financës nuk është aplikuar administrimi i pjesëve të vjetra (pjesëve të këmbimit), të cilat duheshin bërë hyrje në magazinë të veçantë (rikupero).

-Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), në 1 rast, sipas urdhër-shpenzimit nr. 55, datë 20.05.2021 Riparim automjetesh, 766,680 lekë, likuiduar OE Besnik Meçi, nuk janë argumentuar nga grupi i punës mbi gjëndjen fillestare të automjeteve,





## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

amortizimin, të dhënat për kilometrat e përshkruara nga automjetet, shërbimet e kryera, investimet kapitale dhe të përcaktohej nevoja për shërbime mirëmbajtje, mbështetur në dokumentacionin argumentues për kërkesën e bërë. Kjo ka rrjedhur nga mungesa e kartelave të aktiveve afat-gjata ku duhej të ishte bërë përshkrimi i të dhënave të mësipërme.

Nga ana e Sektorit të Financës nuk është aplikuar administrimi i pjesëve të vjetra (pjesëve të këmbimit), të cilat duheshin bërë hyrje në magazinë të veçantë (pjesë këmbimi) dhe më pas të krijohej mundësia e përfitimit të tyre duke u shitur ose për skrap.

-Agjencia Kombëtare e Pyjeve (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), **në 4 raste, për shumën 44,419 lekë**, sipas urdhër shpenzimeve nr. 19, datë 04.03.2021, nr. 17, datë 25.02.2021, nr. 45, datë 15.04.2022, nr. 27, datë 02.03.2022, ka likuiduar DRSHTRR Tiranë për pagesa gjobash për vonesa, brenda vlerës së përgjithshme, sipas dokumenteve për taksa makine, *gjoba për te cilat duhej të nxirrej përgjegjësia dhe të paguheshin prej personave përgjegjës*, për rrjedhojë nuk duhej të paguhej **shuma prej 44,419 lekë** nga AKP.

-Agjencia Kombëtare e Pyjeve, **në 22 raste** për shumën e përgjithshme **13,625,229 lekë**, si rezultat i dhënies së masave ekstreme disiplinore “Largim nga Shërbimi Civil” si dhe zgjidhjes së kundërligjshme të kontratave të punonjësve të pabazuara në ligj dhe në Kodin e Punës, kanë sjellë kundërpërgjigje nga punonjësit e institucionit të cilët kanë bërë padi në gjykatë ku kanë fituar të drejtën e tyre në shkallën e parë ose edhe në shkallën e dytë të gjyqimit dhe për pasojë nga shteti janë shpenzuar **13,625,229 lekë**, ku përfshihet edhe pagesa e përmbaruesve gjyqësorë për kompensimin e punonjësve të larguar padrejtësisht, duke shkaktuar efekte ekonomike negative në administrimin e fondeve publike, me pagesën e 2 personave për të njëjtin vend pune

-Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), **në 1 rast**, sipas urdhër-shpenzimit nr. 26, datë 14.12.2020, Shërbim riparim automjeti 36,000 lekë, likuiduar OE G. K., PF.

### **Kriteri:**

udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji për Shërbimin Civil në RSH.

**Efakti:** Mungesë performance në administrimin e aktiveve materiale e monetare

**Shkaku:** Dobësi e Sektorit të Financës

**Rëndësia:** E mesme

### **Rekomandim:**

-Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa dhe të krijojë magazinë rikupero lidhur me administrimin e pjesëve të vjetra të automjeteve në rastet e shërbimeve të kryera dhe më pas të krijohej mundësia e përfitimit prej tyre duke u shitur ose për skrap.

-Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen lidhur me shërbimet që u kryhen automjeteve te argumentohet shpenzimi i kryer duke marrë të dhëna nga kartelat e aktiveve afat-gjata mbi gjëndjen fillestare të automjeteve, amortizimin, të dhënat për kilometrat e përshkruara nga automjetet, shërbimet e kryera, investimet kapitale dhe të përcaktohej nevoja për shërbime mirëmbajtje, mbështetur në dokumentacionin argumentues për kërkesën e bërë.

Përveç sa më sipër, të krijohej magazinë rikupero lidhur me administrimin e pjesëve të vjetra të automjeteve në rastet e shërbimeve të kryera dhe më pas të krijohej mundësia e përfitimit prej tyre duke u shitur ose për skrap.

-Agjencia Kombëtare e Pyjeve (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të përcaktojë përgjegjësitë lidhur me gjobat e paguara sipas urdhër shpenzimeve nr. 19, datë 04.03.2021, nr. 17, datë 25.02.2021, nr. 45, datë 15.04.2022, nr. 27, datë 02.03.2022 dhe më



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

pas të ndjekë gjithë rrugët ligjore për arkëtimin e shumës **44,419 lekë** sipas dokumenteve për taksa makine, prej përfituesit në të kundërt shuma të zhdëmtohet nga personat përgjegjës.

-Drejtori i Agjencisë Kombëtare e Pyjeve, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa në të ardhmen për eliminimin e rasteve, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me efekt negativ për likuidimin e vendimeve gjyqësore, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për shërbimin civil “krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike” si dhe Kodit të Punës.

-Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen lidhur me rastet e blerjeve duke bërë hyrje gjithë mallrat e blera.

### **Mbi veprimet e magazinës**

Auditimi u krye duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm;

*Ligji Nr.10296 , datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin “ i ndryshuar;*

*-Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik “ i ndryshuar;*

*-Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.570, datë 17.07.2019 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”.*

### **Mbi veprimet e magazinës**

Titullari i Agjencisë Kombëtare të Pyjeve ka miratuar urdhrin për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin. Për vitin 2020 janë realizuar gjithsej 16 fletëdalje, 3 fletëhyrje, për vitin 2021 janë realizuar 32 fletëdalje, 7 fletëhyrje, për vitin 2022 janë realizuar 29 fletëdalje dhe 3 fletëhyrje. Grupi i auditimit, në bazë të riskut, përzgjedhi fletëhyrjet dhe fletëdaljet si më poshtë;

**1.**Për sa më sipër, daljet nga magazina, në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, nuk janë bërë në bazë urdhërdorëzimeve, fletë kërkesave të firmosur nga titullari i institucionit , planit të shpërndarjes të kartelës limit, kjo në kundërshtim me nenin 38 të UMF Nr. 30, datë 27.11.2011“*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

-Blerjet e ndryshme nga njësia dokumentohen me fletëhyrjen dhe fletëdaljen, por nuk janë regjistruar sepse mungon ditari analitik i magazinës , në kundërshtim me ligjin nr. 25/2019, datë 10.05.2019 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15, dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 28, ku përcaktohet se: “*Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme (si njësi shpenzuese me kontabilitet më vete), para evidentimit të dhënave në pasqyrat financiare, duhet që të regjistrojë në ditarët e kontabilitetit të gjitha transaksionet financiare të ndodhura gjatë periudhës ushtrimore*”.

**2.**Hyrjet e mallrave që kanë qarkulluar pa pagesë, flete hyrjet e plotësuara nga magazina nuk kanë të bashkëlidhur dokumentacionin përkatës si: fletëdaljen e nënshkruar nga përfaqësueset njësisë shpenzuese që ka bërë daljen e mallit, shkresën e njësisë që ka bërë transferimin e aktiveve , autorizim për tërheqje malli të firmosur nga nëpunësit zbatues dhe nëpunësi autorizues, kjo në kundërshtim me nenin 55 e UMF Nr. 30, datë 27.11.2011“*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” .

-Theksojmë se, në fletë-hyrjen Nr.5, datë 29.12.2020, ku janë pasqyruar aktivet e transferuara nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, nuk është shënuar emërtesa “mall në ruajtje”, kjo në kundërshtim me nenin 49, e UMF Nr. 30, datë 27.11.2011“*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” e cila përcakton se “*Aktivitet e marra në ruajtje dokumentohen menjëherë me fletëhyrjen që përmban shënimin “vlëra në ruajtje*”;

**3.**Gjithashtu shkresat e njësisë për transferimin e aktiveve ( Shkresa e Inspektoratit të Mjedisit Qarku Durrës, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ) nuk janë firmosur nga titullarët e institucioneve përkatëse;

**4.**Agjencia Kombëtare e Pyjeve nuk ka përcjellë akt-konfirmimin për të gjitha hyrjet, dërguesit brenda datës 20 të muajit pasardhës, kjo në kundërshtim me nenin 56 e UMF Nr. 30, datë 27.11.2011“*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” ku përcakton se ;

*“Për të gjitha hyrjet që bëhen pa pagesë, njësia publike pritëse e aktivitetit i përcjell akt konfirmimin dërguesit brenda datës 20 të muajit pasardhës. Akt konfirmimi firmoset nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues i njësisë pritëse”.*



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e ditarit analitik

**Situata:** Nga auditimi rezultoi se blerjet e ndryshme janë dokumentuar me fletëdaljet dhe fletëhyrjet, por nuk janë reregjistruar në ditarin analitik të magazinës

**Kriteri:** Ligjin nr. 25/2019, datë 10.05.2019 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15

**Shkaku:** Neglizhenca e institucionit

**Ndikimi:** Mos plotësimi i dokumentacionit shoqërues sipas përcaktimeve ligjore

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa që të gjitha blerjet e kryera nga njësi të regjistroje në ditarin analitik të magazinës.

**Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, daljet nga magazina, ti kryejë në bazë të urdhërdorëzimeve, fletë kërkesave të firmosur nga titullari i institucionit, planit të shpërndarjes të kartelës limit.

**Titulli i gjetjes:** Marrja në dorëzim e aktiveve në ruajtje

**Situata:** Nga auditimi rezultoi se në fletëhyrjen Nr.5, datë 29.12.2020, ku janë pasqyruar aktivet e transferuara nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, nuk përmban shënimin “vlera në ruajtje”.

**Kriteri:** Udhëzim i Ministrisë së Financave Nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 49

**Shkaku:** Moszbatim i akteve ligjore të inventarizimit

**Ndikimi:** Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Hyrjet e mallrave në magazinë, Agjencia Kombëtare e Pyjeve ti dokumentojë në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Aktivet e marra në ruajtje të dokumentohen menjëherë me fletëhyrjen që përmban shënimin "vlera në ruajtje".

*(Sa më sipër është mbajtur Akt-Verifikimi nr. 01, datë 09.12.2022)*

*1.Me shkresë nr. 1148, datë 15.12.2022, të protokolluar në KLSH me nr. 891/3, prot., datë 04.01.2023, Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka paraqitur observacionet, ku ka paraqitur pretendimet, lidhur me konstatimet e grupit të auditimit, të cilat po i paraqesim më poshtë si dhe qëndrimin e grupit të auditimit lidhur me këto pretendime.*

### **Pretendimi i subjektit:**

*-Lidhur me sa është trajtuar në Projekt-Raportin e Auditimit, referuar Akt-Verifikimit nr. 1, "Mbi auditimin e hartimit dhe zbatimin e buxhetit të shtetit", Sektori i Financës dhe Buxhetit, ka paraqitur observacionin ku pretendon ka observuar se mosrealizimi 100% i fondeve buxhetore të miratuara nga AKP, nuk ka ardhur nga planifikimi i fryrë por për faktin se, për shpenzimet e personelit nuk janë plotësuar vendet në strukturën e AKP, për llog. 602, realizimi i dietave ka qenë më i ulët nga ana e drejtorive, për energjinë elektrike nuk ka ardhur asnjë faturë energjie ose uji, për disa prokurime me vlerë të vogël nuk ka qenë e nevojshme të kryhen për vitin 2021 për mos shpërdorimin e fondeve, për vitin 2022 disa prokurime me vlerë të vogël ende nuk kanë arritur në fazën e likuidimit të faturës, për një vendim gjyqësor të formës së prerë për t'u likuiduar në vitin 2022, nuk ka vënë në dijeni për numrin e llogarisë, llogaria 6029099 "Shpenzime të tjera materiale dhe shërbime" është lënë sipas rastit për nevojat që mund të dalin".*

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Theksojmë së megjithëse Sektori i Financës ka paraqitur argumentet e saj për mosrealizime, këto fakte duhej të ishin parashikuar në kohën e planifikimit.*

*Për sa i përket kontabilizimit të vendimit gjyqësor, ky vendim nuk duhej përfshirë në llogaritë e klasës 6, shpenzime të shfrytëzimit të vitit 2022, por duhej marrë në bilancin e vitit 2021 në llogarinë e provizioneve, meqenëse vendimi e gjykatës ka marrë formë të prerë, kjo sipas udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, pika 34.*

*Për sa sipër observacioni i Sektorit të Financës nuk qëndron.*

*(Sa më sipër është mbajtur Akt-Konstatimi nr. 01, datë 09.12.2022)*



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

*I.Me shkresë nr. 1148, datë 15.12.2022, të protokolluar në KLSH me nr. 891/3, prot., datë 04.01.2023, Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka paraqitur observacionet, ku ka paraqitur pretendimet, lidhur me konstatimet e grupit të auditimit, të cilat po i paraqesim më poshtë si dhe qëndrimin e grupit të auditimit lidhur me këto pretendime.*

### **Pretendimi i subjektit:**

*-Lidhur me sa është trajtuar në Projekt-Raportin e Auditimit, referuar Akt-Konstatimit nr. 1, "Mbi auditimin e rregullshmërisë së pasqyrave financiare", Sektori i Financës dhe Buxhetit, ka paraqitur observacionin ku pretendon sa më poshtë:*

*"Referuar pikës 1/a, lidhur me gjetjen se për vitet 2020 dhe 2021, nuk ishin hapur ditarët e analitikë dhe pasqyrat financiare të vitit 2020 ishin përgatitur nga jashtë (extra kontabël), ka sqaruar në thelb se për periudhen 04.09.2020 deri 05.08.2022 Sektori i Financës nuk ka qenë plotësuar me stafin e nevojshëm dhe pasqyrat financiare janë nënshkruar nga znj. R. R, z. T. V. Nëpunës Zbatues dhe z. K. S. Nëpunës Aurotrizues, nuk mund të konsiderohet përgatitje nga jashtë e pasqyrave financiare".*

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Theksojmë së megjithëse Sektori i Financës ka patur mungesa, firmosja e pasqyrave është e mirëqëne dhe fakti i mungesës së të gjithë dokumentacionit analitik, si ditarë, partitarë, libër i madh, etj., tregon përgatitje nga jashtë e pasqyrave financiare. Për sa sipër observacioni i Sektorit të Financës nuk qëndron.*

### **Pretendimi i subjektit:**

*-Lidhur me sa është trajtuar në Projekt-Raportin e Auditimit, referuar Akt-Konstatimit nr. 1, "Mbi auditimin e rregullshmërisë së pasqyrave financiare", Sektori i Financës dhe Buxhetit, ka paraqitur observacionin ku pretendon sa më poshtë:*

*"Referuar pikës 1/a, lidhur me gjetjen se automjeti tip Chevrolet me targë SH5675E me vlerë 3,200,000 lekë, është përfshirë në bilancin e vitit 2021, në një kohë që është bërë hyrje në vitin 2022, Sektori i Financës e ka pranuar këtë fakt, por ka bërë sqarime të mëtejshme, se:*

*-Nga ana e AKP tiranë nuk është zbatuar urdhri i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr. 54, datë 24.02.2020 për kalimin e automjetit në përgjegjësi administrimi të AKP Tiranë.*

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Theksojmë së megjithëse Sektori i Financës e ka pranuar faktin e përfshirjes së automjetit tip Chevrolet me targë SH5675E me vlerë 3,200,000 lekë, në bilancin e vitit 2021, pjesa tjetër e pretendimeve janë justifikim, pasi nuk duhej të veprohej në këtë mënyrë nga ky Sektor.*

*Për sa sipër observacioni i Sektorit të Financës nuk qëndron.*

*(Sa më sipër është mbajtur Akt-Konstatimi nr. 02, datë 09.12.2022)*

*I.Me shkresë nr. 1148, datë 15.12.2022, të protokolluar në KLSH me nr. 891/3, prot., datë 04.01.2023, Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka paraqitur observacionet, ku ka paraqitur pretendimet, lidhur me konstatimet e grupit të auditimit, të cilat po i paraqesim më poshtë si dhe qëndrimin e grupit të auditimit lidhur me këto pretendime.*

### **Pretendimi i subjektit:**

*-Lidhur me sa është trajtuar në Projekt-Raportin e Auditimit, referuar Akt-Konstatimit nr. 2/1, "Mbi ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare", Sektori i Financës dhe Buxhetit, ka paraqitur observacionin ku pretendon sa më poshtë:*

*"Referuar pikës për ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare, lidhur me gjetjet se për vitet 2020, 2021, 2022, nga ana e Sektorit të Financës nuk është aplikuar administrimi i pjesëve të vjetra (tonerave), të cilat duheshin bërë hyrje në magazinë të veçantë (rikupero) dhe më pas të krijoheshin mundësia e përfitimit të tyre duke u shitur ose për skrap, është observuar në thelb se nuk është parë e arsyeshme që të bëhen hyrje në magazinë të veçantë (rikupero) pjesët e vjetra të kumbimit, me pretendimin se nuk kanë vlerë.*



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Theksojmë së Sektori i Financës duhej të bënte hyrje dhe të bënte vlerësimin e pjesëve të këmbimit të vjetra dhe më pas të krijohej mundësia e përfitimit prej tyre duke u shitur ose për skrap.*

*Për sa sipër observacionet e Sektorit të Financës për këtë çështje nuk qëndrojnë.*

### **Pretendimi i subjektit:**

*-Lidhur me sa është trajtuar në Projekt-Raportin e Auditimit, referuar Akt-Konstatimit nr. 2/1, Sektori i Financës dhe Buxhetit, ka paraqitur observacionin ku pretendon, lidhur me faktin se dokumentacioni nuk ishte i gjithi i bashkëlidhur urdhër-shpenzimeve, se sipas udhëzimit nr. 17, datë 06.07.2021 të Ministrisë të Financave, nuk kërkohen nga thesari të gjithë dokumentacioni sipas ligjit.*

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Theksojmë së konstatimet e mësipërme lidhur me mos bashkëlidhjen nga Sektori i Financës i të gjithë dokumentacionit tek urdhër-shpenzimet, janë konstatime të karakterit teknik dhe rregullshmërisë, ku dokumentacioni bashkëlidhur është pjesë e rregullshmërisë dhe kujdesit të duhur në Sektorin e Financës.*

*Për sa sipër observacionet e Sektorit të Financës për këtë çështje nuk qëndrojnë.*

### **Pretendimi i subjektit:**

*-Lidhur me sa është trajtuar në Projekt-Raportin e Auditimit, referuar Akt-Konstatimit nr. 2/1, Sektori i Financës dhe Buxhetit, ka paraqitur observacionin për urdhër-shpenzimin nr. 145, datë 19.10.2021, ku pretendon, lidhur me faktin se se nga ana e Komisionit janë refuzuar si oferta anomalisht të ulëta ofertat e operatorëve, të klasifikuara në vendin e parë dhe të dytë, B. I. S. S, prej 157,860 lekë dhe ADASTRA, prej 194,000 lekë, duke pretenduar se i pari OE nuk është paraqitur brenda 24 orëve nga data e njoftimit në AKP, ndërsa i dyti ka dërguar mesazh për tërheqjen.*

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Theksojmë së konstatimet e mësipërme lidhur me tërheqjen nga gara ose mosparaqitjen qëndrojnë, por duhej të trajtoheshin si të tilla dhe jo si vlera anomalisht të ulëta.*

*Për sa sipër observacionet e Sektorit të Financës për këtë çështje qëndrojnë pjesërisht.*

### **Pretendimi i subjektit:**

*-Lidhur me sa është trajtuar në Projekt-Raportin e Auditimit, referuar Akt-Konstatimit nr. 2/1, Sektori i Financës dhe Buxhetit, ka paraqitur observacionin për 4 raste prokurime me vlerë të vogël, ku pretendon, lidhur me faktin e përcaktimit të fondit limit duke aplikuar me metodën e mesatares së ofertave të marra, në një kohë që oferta më e ulët ka qenë nën vlerën e mesatares, e cila edhe duhej marrë për llogaritjen e fondit limit edhe pse kjo nuk ka sjellë pasoja ekonomike për institucionin, sepse OE fituese ka paraqitur ofertë me të ulët (duke zbritur TVSH).*

*Sektori i Financës pretendon se në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, është bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021.*

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Theksojmë se urdhër-shpenzimet e mësipërme janë në datat 20.05.2021, 20.04.2021 dhe 29.03.2021, në një kohë që vendimi i qeverisë është i datës 19.05.2021 dhe hyn në fuqi pas botimit në gazetën zyrtare.*

*Për sa sipër observacioni i Sektorit të Financës nuk qëndron.*

### **Pretendimi i subjektit:**

*-Lidhur me sa është trajtuar në Projekt-Raportin e Auditimit, referuar Akt-Konstatimit nr. 2/1, Sektori i Financës dhe Buxhetit, ka paraqitur observacionin për 2 raste ku pretendojnë, lidhur me faktin e përcaktimit të përgjegjësisë për komisionin e prokurimit me vlerë të vogël. Sektori*



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

*i Financës pretendon se komisioni nuk mban përgjegjësi për faturat e likuiduara, sepse gjordat nuk janë pjesë e prokurimeve publike.*

*Për sa i takon urdhër-shpenzimit nr. 45, datë 15.04.2022, Gjorda ndryshim pronësie, 40,000 lekë, kemi urdhrin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr. 54, datë 24.02.2020 për kalimin e automjetit në përgjegjësi administrimi të AKP Tiranë. Për këtë transferim ka patur vonesa prej ISHMPUT duke u tejkaluar afati prej 30 ditëve nga nënshkrimi i aktit.*

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Theksojnë se urdhër-shpenzimet e mësipërme janë nënshkruar nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, ku përgjegjësia lind nga firma (nënshkrimi) i anëtarit të komisionit.*

*Përsa i përket urdhër-shpenzimit nr. 45, datë 15.04.2022, konstatimi i grupit të auditimit është përcaktimi i përgjegjësive dhe jo likuidimi i faturave.*

*Për sa sipër observacioni i Sektorit të Financës nuk qëndron.*

### **Pretendimi i subjektit:**

*-Lidhur me sa është trajtuar në Projekt-Raportin e Auditimit, referuar Akt-Konstatimit nr. 2/1, Sektori i Financës dhe Buxhetit, ka paraqitur observacionin për shpenzimet e kryera për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të cilat kanë sjellë efekte të konsiderueshme financiare, duke ulur ndjeshëm performancën financiare të institucionit.*

*Sektori i Financës sqaron se lista e kreditorëve të ish-ISHMPUT për shlyerje detyrimi për vendimet gjyqësore të formës së prerë, janë përcjellë pranë AKP-së me shkresat e MTM nr. 6050, datë 09.09.2020 dhe nr. 6190, datë 15.09.2020, pra AKP ka pasur detyrimin ligjor të likuidojë shumat që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë, të mbartura nga ish-ISHMPUT.*

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Theksojnë se urdhër-shpenzimet për likuidimin e vendimeve gjyqësore të cilat kanë sjellë efekte të konsiderueshme financiare, duke ulur ndjeshëm performancën financiare të institucionit, janë trajtuar në kuadrin e performancës financiare dhe fakti që vendimet e marra për shumën e likuiduar prej 13,625,229 lekë pagesa vendime gjyqësore, të kryera nga strukturat e ish-ISHMPU.*

*Për sa sipër observacioni i Sektorit të Financës qëndron pjesërisht.*

**-Në zbatim të pikës 4.Auditimi mbi masat e marra për mbrojtjen e pyjeve , inventarizimin dhe dixhitalizimin e fondit pyjor , përfshirë monitorimin dhe kontrollin e pyjeve.**

*Në zbatim të pikës nr.4 të programit të auditimit nr.891/1 datë 13.10.2022 mbi “masat e marra për mbrojtjen e pyjeve, inventarizimit dhe dixhitalizimin e fondit pyjor, përfshirë monitorimin dhe kontrollin e pyjeve, u vlerësuan çështjet sipas bazës ligjore si mëposhtëm.*

### **Baza Ligjore**

- Ligji nr.57/2020 “Për pyjet”
- VKM nr.570 datë 17.07.2019 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve
- VKM Nr.171, datë 18.03.2022, “Ngritjen e bazës së të dhënave për Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor dhe regjistrin e fondit kullor
- Çdo bazë tjetër ligjore

*Në sektorin e pyjeve është miratuar ligji i ri nr.57/2020 “Për pyjet”. Në thelb të këtij ligji, në mënyrë të përmblodhur, qëndron regjistri i fondit pyjor, përfshirë inventarizimin dhe mbrojtjen e fondit pyjor. Konkretisht:*



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor (RKFP) është regjistri zyrtar që ngrihet dhe mirëmbahet nga agjencia, në të cilin pasqyrohet tërësia e informacioneve kadastrale të nevojshme dhe e ndryshimeve periodike për çdo njësi të fondit pyjor kombëtar. Struktura e RKFP-së, kriteret teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyra e mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal dhe qendror, informacioni që duhet regjistruar, si dhe afatet e përgatitjes e të raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Inventarizimi kombëtar i pyjeve realizon grumbullimin dhe vlerësimin e të dhënave për shtrirjen dhe gjendjen e fondit pyjor kombëtar. Ai synon vlerësimin e ndryshimeve hapësinore dhe kohore të fondit pyjor kombëtar, sigurimin e të dhënave me karakter sasior e cilësor, nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm e ciklik, duke mundësuar përditësimin periodik të të dhënave. Cikli i plotë i riinventarizimit kombëtar të pyjeve është 8-vjeçar, duke inventarizuar 25% çdo 2 vjet të fondit pyjor.

Në nenin 5 përcaktohet se fondi pyjor kombëtar ndahet në ekonomi pyjore, ngastra dhe nënngastra. Kufijtë e fondit pyjor kombëtar janë të përhershëm, të përcaktuar qartë, të shënuar në terren dhe të hedhur në hartë, duke përcaktuar ndër të tjera edhe kufizime si:

Sipërfaqja e fondit pyjor kombëtar të ruhet dhe të mos zvogëlohet, edhe në rastet e lejuara nga ligji për heqjet nga fondi pyjor kombëtar të garantohet zëvendësimi i tij.

Ndryshime (heqje/shtesa) të sipërfaqeve nga/në fondin pyjor kombëtar bëhen me:

- a) miratimin e ministrit për sipërfaqe deri në 1 ha;
- b) vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 1 ha deri në 10 ha;
- c) ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 10 ha.

Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit Ligji shkon më tej, duke i konsideruar pyjet si pasuri kombëtare dhe e mirë publike që prevalon mbi çdo interes tjetër të çdo subjekti dhe garantohet me vendosjen e kufizimeve përkatëse. Institucionet shtetërore garantojnë trajtimin prioritar të pyjeve sipas statusit të tyre “pasuri kombëtare” dhe interesit publik që ato përmbushin.

Parashtrimi i mësipërm është i rëndësishëm për të kuptuar konceptet e garancive që ofron ligji i ri karshi fondit pyjor, duke e vendosur mbrojtjen e tyre mbi çdo interes tjetër.

### I. Detyrat e agjencisë kombëtare të pyjeve.

Agjencia Kombëtare e Pyjeve është krijuar me VKM nr.570 datë 17.07.2019 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, e cila e përcakton si institucion me dy nivele, në nivel qendror dhe rajonal me ngritjen e katër agjencive rajonale (këto të fundit ende nuk janë ngritur)

Në bazë të këtij vendimi, AKP ka detyra në

- Lidhje me vlerësimin e gjendjes së pyjeve dhe të treguesve pyjorë në nivel kombëtar, përgatit projekte të rehabilitimit të fondit pyjor, në rast të dëmtimit, përgatit raporte;
- Në lidhje me inventarizimin, projektin, ndërton, mirëmban dhe përditëson sistemin e integruar të informacionin, duke menaxhuar bazën qendrore të të dhënave si dhe përgatit e mbikëqyr inventarin kombëtar të pyjeve;
- Në lidhje me menaxhimin e pyjeve, harton, zbaton e monitoron zbatimin kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në lejet/autorizimet e dhëna për përdorimin e pyjeve;
- Monitoron/kontrollon të drejtat e akorduara nga njësitë e qeverisjes vendore te operatorët publikë ose privatë, për shfrytëzimin e fondit pyjor, për sa i përket përputhshmërisë dhe



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

respektimit të kriterëve, kërkesave, kufizimeve dhe rekomandimeve të evidentuara në planet e menaxhimit të mbarështimit të pyjeve

- Monitoron/kontrollon veprimtarinë e strukturave të administrimit të inspektimit pyjor në njësitë e qeverisjes vendore, për sa i përket zbatimit dhe respektimit të legjislacionit të fuqi të planeve të miratuara, të cilat ndërhyjnë për marrjen e masave të detyrueshme në rastet kur evidentohej shkelje apo shmangie nga përmbajtja dhe kërkesat e tyre.

Në bazë të ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”, detyrat e agjencisë ndahen në dy kategori:

- **Menaxhuese:**

Në mirëmbajtjen e regjistrit kombëtar të fondit pyjor (RFKP)

Në hartimin e metodologjisë, organizimin dhe drejtimin e punës për inventarizimin e pyjeve në nivel kombëtar.

Agjencia organizon Rrjetin e Përhershëm të Monitorimit të Fondit Pyjor Kombëtar

Në miratimin e projekteve tekniko-ekonomike, për subjektet e pajisur me licenca në shfrytëzimin e pyjeve

Vlerësimin dhe sigurimin e performancës në sektorin e pyjeve

Agjencia projektton, ndërton, mirëmban dhe përditëson sistemin e integruar të informacionit (që përmbledh sistemet ALFIS në sektorin e pyjeve, duke garantuar aksesin dhe shkëmbimin e të dhënave sipas ligjit dhe siguruar ndërveprimin me bashkitë/agjencitë përgjegjëse të zonave të mbrojtura për marrjen e informacionit vendor në kohë reale, nën orientimin e ASIG-ut (Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor).

Projektet e punimeve kulturore lidhet me projektet e pyllëzimit dhe të rehabilitimit të fondit pyjor të cilat mbështeten në rekomandimet e planit të mbarështimit dhe miratohen nga agjencia shtetërore përgjegjëse për pyjet

- **Monitoruese**

Në monitorimin e dokumenteve planifikuese në sektorin e pyjeve

mbikëqyrjen e zbatimit të akteve ligjore/nënligjore, akteve administrative, politikave, programeve dhe planeve në nivel kombëtar nga strukturat e kontrollit të pyjeve në bashki dhe në zonat e mbrojtura, si dhe ndërhyjnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pakufizuar në rastet kur vëren pamundësinë ose mos ushtrimin e kompetencave ligjore nga ana e tyre

Një nga problematikat e konstatuara lidhet me faktin se VKM e krijimit të Agjencisë i përket vitit 2019, ndërsa ligji i ri për pyjet ka dalë në vitin 2020. Nga aktiviteti i deritanishëm i AKP vërehet se nuk ka një harmonizim të plotë mes detyrave që parashtron ligji dhe detyrave të përcaktuara në VKM e krijimit. Pra, rezulton se në dallim nga tradita ligjvënëse ku VKM pason ligjin, në rastin konkret, VKM i ka paraprirë ligjit. Në veçanti, kjo mungesë harmonizimi vërehet te roli monitorues/kontrollues i AKP-së. Ligji në fakt në nenin 35 “Institucionet përgjegjëse për kontrollin” i atashon Agjencisë rolin e mbikëqyrës dhe monitorimit, ndërsa kur flet për struktura vendore, këtyre të fundit i atribuon termin inspektuese. Nga ana tjetër, VKM e krijimit përcakton se AKP kontrollon veprimtarinë e strukturave vendore sa i përket zbatimit nga ana e tyre të legjislacionit dhe monitoron- kontrollon të drejtat e akorduara nga njësitë e qeverisjes vendore te operatorët publikë ose privatë për shfrytëzimin e fondit pyjor, madje gëzon tagrin e ndërhyrjes së drejtpërdrejtë në rast se konstaton mungesë veprimesh.

Më tej, në nenin 34, Agjencia njihet si strukturë kontrolli (ligji përmend strukturën përgjegjëse në AKP), duke përcaktuar se funksioni i kontrollit, që ushtrohet nga strukturat sipas pikës 3 të këtij neni, realizohet përmes proceseve të inspektimit, të cilat organizohen mbi bazën e riskut të vlerësuar dhe në përputhje me metodologjitë e programet përkatëse, duke u shtrirë përgjatë të gjithë ciklit të veprimtarisë në pyje. Madje, në pikën 11 të nenit 36 të ligjit, AKP, konkretisht Drejtori i Përgjithshëm gëzon tagrin për marrjen e masave me gjobë në rastin kur institucionet, strukturat apo personat përgjegjës për fondin pyjor kombëtar, me veprimet apo mosveprimet e





## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

tyre, nuk kanë zbatuar përgjegjësitë ligjore, krahas detyrimit për ushtrimin e ndjekjes së procedurave disiplinore administrative, dënohen edhe me gjobë nga 100 000 lekë deri në 500 000 lekë.

Me shkresën nr.727/3 datë 20.10.2022 nga ana e Drejtorit të APK është informuar Ministria e Turizmit dhe Mjedisit mbi unifikimin e praktikave të inspektimit me Inspektoratin Qendror, proces ky i papërfunduar duke sjellë si pasojë që AKP të jetë jashtë sistemit të inspektimit.

Në këto kushte, AKP ka ushtruar veprimtari të natyrës monitoruese dhe këshilluese, në disa bashki të vendit, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së veprimtarisë së strukturave përgjegjëse për pyjet në nivelin vendor dhe disa subjekte private, duke lënë rekomandime në formën e masave organizative dhe propozuar masa disiplinore.

Sa më sipër, është konstatuar se :

1. Agjencia Kombëtare e Pyjeve është jashtë sistemit të inspektimit, kryesisht për shkak se nuk janë unifikuar me Inspektoratin Qendror praktikave të kontrollit dhe procesit të inspektimit në fondin pyjor kombëtar nga strukturat përgjegjëse në ushtrimin e kompetencave të tyre, sipas nenit 40 të ligjit nr.57/2020 për Pyjet. Për pasojë, kjo Agjenci për periudhën 2020-2022 ka qenë në pamundësi, si juridikisht ashtu edhe nga logjistike (mungojnë procesverbale të konstatimit të dëmeve etj.) për të ushtruar veprimtari të mirëfilltë inspektuese. Paqartësia vet brenda ligjit si dhe mungesa e harmonizimit me ligje të tjera, ka bërë që funksionin e inspektimit të pyjeve ta realizojë Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, institucion ky nuk njihet si institucion monitorues /inspektues sipas ligjit nr.57/2020.
2. Aktet nënligjore plotësuese në zbatim të ligjit nr.57/2020 ende nuk janë miratimit, konkretisht mungojnë rreth 18 VKM dhe udhëzime, ndër të tjera, si më poshtë:
  - a. Në zbatim të nenit 4 pika 2 duhej të ishte miratuar udhëzimi për klasifikimin e pyjeve
  - b. Neni 5, pika 4, nuk është miratuar VKM për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre
  - c. Në zbatim të nenit 38 pika 8, nuk është miratuar udhëzimi me procedura dhe vendimmarrja për dënimin dhe masat përkatëse, ankimi dhe ekzekutimi rregullohen nga legjislacioni në fuqi për kundërvajtjet administrative dhe inspektimin. Përmbajtja dhe modelet e akteve për kundërvajtjet në pyje miratohen me urdhër të ministrit.

### I. FONDI PYJOR DHE INVENTARIZIMI

Në fushën e pyjeve, për rregullimin, administrimin dhe organizimin institucional dhe veçanërisht në sektorin e kadastrës pyjore janë ndërmarrë një sërë masash, si në fushën e legjislacionit, teknologjisë bashkëkohore dhe të procedurave të zbatuara në fushën e administrimit (teknike) të fondit pyjor.

- a- Përmirësimi i bazës së të dhënave në “Lista e transferimit të ngastrave pyjore kullosore në pronësi të bashkisë” të miratuara VKM nr.433, dt dt.08.06. 2016, me VKM-të me listat e reja të viti 2020 dhe konkretisht VKM nr.398, dt.13.05.2020, VKM nr.684, dt. 02.09.2020, VKM nr 134, dt. 03.03.2021. ( për 61 bashkitë). Janë saktësuar pronësia, sipërfaqet dhe kategoria e përdorimit.
- b- Digjitalizimi i fondit pyjor/Kullosor (nën parcelave pyjore) dhe krijimi i “Sistemit të Integruar të Informacionit në pyje” ALFIS, i cili është pasqyruar në ligjin e ri nr.57/2020, datë 30/04/2020, “Për Pyjet”.
- c- Miratimi i VKM-së Nr.171, datë 18.03.2022, “ Ngritjen e bazës së të dhënave për Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor dhe regjistrin e fondit kullosor .....

Për vitin 2021 sektori Inventarizimit dhe Kadastrës Pyjore ka realizuar regjistrin me të dhënat kadastrale të fondit pyjor kullosor mbështetur në “Listat e transferimit të ngastrave pyjore



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

kullosore në pronësi të bashkisë “sipas VKM-ve, të dhënave të gjen eruara nga Planet e Mbarështimit, si dhe nga evidencat e raportuara nga bashkitë mbështetur në Udhëzimit nr.1, datë 26.01.2017, “Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor kombëtar“ .

Transferimi i pyjeve nga qeverisja qendrore në atë vendore u shoqërua dhe me aktet përkatëse administrative. Transferimi i sipërfaqeve pyjore u realizua nëpërmjet VKM-së nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”. Ky transferim u asistua nga Projekti i Shërbimeve Mjedisore, i cili mundësoi procesin e përmirësimit dhe korigjimit të sipërfaqeve të Ekonomive Pyjore në Njësitë Vendore përkatëse, të cilët materialin pasi e analizuan dhe dakortësuan e kaluan në këshillat e Njësitë Vendore, për miratim. Vendimet e këtij procesi u dërguan pranë MTM-së dhe Projektit të shërbimeve Mjedisore, nga i cili u hartuan VKM-të përkatëse për secilën njësi vendore.

Këto “projekt vendime” me listën e inventarit të pyjeve e kullotave ishin baza për regjistrimin e pronës pyjore në ASHK, proces i cili nuk ka përfunduar ende për problematika të ndryshme si më poshtë:

Sipas informacionit në AKP, parimisht 7 bashki (Pukë, Mat, Klos, Dibër, Himarë, Fier, Pustec) nuk kanë pranuar ndryshimet e reflektuara nga projekti i shërbimeve mjedisore në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për pasojë nuk kanë kaluar në këshillat përkatës ndryshimet që do të reflektoheshin në VKM-të e përmirësuara, material i cili do të përdorej me qëllim regjistrimin e sipërfaqeve pyjore në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Sipërfaqja prej 157 130 ha që ju përket këtyre bashkive i referohet VKM-së 433 datë 8.06.2016.

b) Për 54 bashkitë të tjera është rënë dakord dhe kanë pranuar ndryshimet e VKM Nr. 433 datë 8.06.2016 dhe si rrjedhojë kanë dalë VKM-të e përmirësuara për secilën bashki, VKM Nr. 398, datë 15.05.2020, VKM Nr. 684, datë 02.09.2020 dhe VKM Nr. 134, datë 03.03.2021.

Nga verifikimi dhe bashkëpunimi me bashkitë për azhornimin e RKFP në bazë të listave të VKM-ve të përmirësuara janë evidentuar këto mangësi:

a) Në një pjesë të bashkive ka mospërputhje të materialit të miratuar dhe kaluar në këshillat bashkiak me realitetin në terren.

b) Në disa njësi ka mospërputhje dhe problematika ndërmjet materialit të dakordësuar dhe miratuar në këshillat dhe VKM-së përkatëse të përmirësuar të mbështetur mbi këtë material. Përgjegjësia në këtë rast mbetet e strukturave që janë marrë me hartimin e këtyre VKM-ve.

Nga ana tjetër AKP i është drejtuar MTM-së zyrtarisht për të mundësuar materialin përfundimtar sipas VKM-ve të përmirësuara nga Projekti i Shërbimeve Mjedisore në formë elektronike për të ndihmuar procesin e NJQV dhe për ta krahasuar me të dhënat që përmban sistemi ALFIS. Informacioni edhe sot nuk disponohet nga AKP. I gjithë procesi prek dhe ndikon në mënyrë thelbësore në ndërtimin e Regjistrimit Kombëtar të Fondit Pyjor

Aktualisht 61 bashkitë ushtrojnë veprimtarinë administrative në sipërfaqen e fondit pyjor mbështetur në bazën e të dhënave të VKM-ve Nr. 398, datë 13.05.2020, VKM-së Nr.684, datë02.09.2020, VKM-së Nr.134, datë 03.03.2021.

### **BILANCI KADASTRAL I FONDIT PYJOR E KULLOSOR -2021 (Nivel Bashkie) dhe Zonat e Mbrojtura**

Nr	Zëri kadastral	Sip/Ha bashki	Sip/Ha (ZM)	Gjithsej
1	Pyje	969855	176869	1146724
2	Kullota në fondin pyjor	366105	82645	448750
3	Kullota në fondin kullosor		0	0
4	Sipërfaqe me bimësi pyjore	23169.8	0	23169.8



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

5	Inproduktiv në fondin pyjor e kulloror	61843.5	36338	98181.5
	<b>Gjithsej</b>	<b>1,420,973.4</b>	<b>295852</b>	<b>1,716,825</b>

Çka vërehet është se në këtë fond pyjor nuk janë të pasqyruara ato sipërfaqe pyjorë të cilat kanë kaluar në pronësi Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet VKM-së Nr. 707, datë 21.11.2018 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Shkodër-Fier. Sipas nenit 2 të ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”, ligji i shtrin efektet për çdo sipërfaqe pyjore pavarësisht pronësisë, për sa kohë plotësohet kushti i përkufizimit të “pyllit”.

• **FONDI PYJOR DHE KULLOSOR SIPAS PRONËSISË -2021 (Nivel Bashkie)dhe ZM**

Nr	Pronësia		Sip/Ha bashki	Sip/Ha (ZM)	Gjithsej
	<b>Gjithsej</b>	<b>Pyje</b>	<b>969,855</b>	<b>176,869</b>	<b>1,146,724</b>
<b>1</b>	1.1	Pyje publik	941,075	176,869	1,117,944
	1.2	Pyje private	28,780	0	28,780
	<b>Gjithsej</b>	<b>Kullota</b>	<b>366,105</b>	<b>82,645</b>	<b>448,750</b>
<b>2</b>	2.1	Kullota publik	328239	82,645	410,884
	2.2	Kullota private	37866	0	37,866

Në këtë drejtim, është i paqartë roli i AKP-së në lidhje me menaxhimin teknik si fond pyjor të këtyre sipërfaqeve, veçanërisht në rastet e miratimit të investitorëve strategjikë që prekin sipërfaqe pyjore, problematikë kjo e vërejtur në raste konkrete. Kështu, me urdhrin nr.36 datë 17.06.2022 është ngritur grupi i punës me qëllim verifikimin e situatës në terren të kushteve dhe kërkesave të vendimit me nr.11/9 datë 02.12.2021 “Për miratimin e statusit të investitorit strategjik me subjekt aplikues “M. E.”, me shtrirje në një sipërfaqe pyjore prej 6.5 ha në bashkinë Kavajë, njësi administrative Synej. Objekti i këtij urdhri ka qenë verifikimi në terren i gjendjes së grumbujve pyjorë në fondin pyjor të propozuar për zbatimin e projektit si investim strategjik, verifikimin në regjistrin e fondit pyjor kombëtar të kësaj sipërfaqeje dhe përgatitjen e raportit të vlerësimit. Në përfundim, grupi i punës ka konkluduar se “Zona e planifikuar për investim strategjik është e pa pasqyruar në ALFIS, dhe për pasojë ne mund të identifikojmë vetëm parcelat kufitare, kjo për faktin se zona në fjalë është pjesë e Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.707, datë 21.11.2018, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Shkodër–Fier”.

Fakti se sipërfaqet pyjore nuk janë pasqyruar në ALFIS nuk nënkupton se këto sipërfaqe nuk konsiderohen pjesë të fondit pyjor, marrë parasysh se ALFIS është një program i paplotë dhe në të janë pasqyruar vetëm sipërfaqe pyjore nën administrimin e bashkisë. Nga ana tjetër, VKM nr.707 datë 21.11.2018 thjesht bën një ndryshim në administrim të këtyre sipërfaqeve, të cilat sipas ligjit për pyjet janë pjesë e fondit pyjor kombëtar. Ndërkohë, në vendimet e Komitetit të Investimeve Strategjike lihen edhe detyra për heqjen nga fondi pyjor (rasti i M. E.), para marrjes në përdorim të sipërfaqes përkatëse apo ngarkimin e AKP-së me saktësimin e koordinatave apo verifikime të pronës (rasti i “O.” A.” shpk” për një sipërfaqe 60,000 m<sup>2</sup>). Po ashtu, në këtë të fundit kërkohet çregjistrimi nga kadastra dhe regjistri i fondit pyjor si dhe kërkohet nga subjekti përfitues që vlerat përkatëse të pakësimit të volumit të lëndës drusore, të sipërfaqes që do të hiqet nga fondi pyjor dhe të infrastrukturës së saj të paguhen nga subjekti aplikues sipas legjislacionit në fuqi përmes edhe hartimit të një marrëveshjeje të përbashkët mes subjektit dhe MTM lidhur me pyllëzimin e një sipërfaqeje tjetër. Si pasojë, për gjitha këto detyra, Agjencia



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

Kombëtare e Pyjeve gjendet e përjashtuar nga këto procese, së pari ende nuk administrojnë në mënyrë të plotë fondin pyjor, së dyti rezultojnë e përjashtuar nga proceset e kadastrës pyjore, sa i përket çregjistrimit, heqjes nga fondi pyjor dhe zëvendësimit, pasi kjo agjenci nuk ka nxjerrë asnjë akt administrativ mbi këto çështje dhe nuk informohet nga MTM mbi vendimet e Këshillit të Ministrave për heqjen nga fondi pyjor.

Heqja dhe zëvendësimi i fondit pyjor është një çështjet për të cilën në Agjencinë Kombëtare Pyjeve duhet patur një vëmendje e posaçme. Ndonëse për krijimin e nënregjistrimit të “Heqjes nga fondi Pyjor / Kullor publik”, të sipërfaqeve që ndodhen në fondin pyjor/kullor në Sektorin e Inventarizimit dhe Kadastrës Pyjore po punohet me të dhënat që dërgojnë bashkitë. Konkretisht, AKP ende nuk janë përcjellë së pari:

- Heqjet nga fondi pyjor në nivel bashkie
- Heqje nga fondi pyjor në zonat e mbrojtura
- Heqjet nga fondi pyjor për sipërfaqe nën administrim të MTM për investitorët strategjikë

Po ashtu, për 61 bashki për 243 subjekte që operojnë në fusha dhe aktivitete ku preket fondi pyjor nuk ka një informacion mbi sipërfaqen pyjore që janë shfrytëzuar nga këto subjekte dhe për ato që ka informacion nuk ka të dhëna nëse janë krijuar proceset e pyllëzimit dhe rehabilitimit.

### Inventari

Nga krahasimi midis dy inventarëve (2003 dhe 2018) në sipërfaqen totale kemi një diferencë minus 204188 ha, kjo është si rrjedhojë e klasifikimeve të mbulesës së tokës midis dy inventarëve. Në inventarin e fundit tokat me bimësi pyjore, me drurë dhe shkurre të rralla nuk është marrë në konsideratë, vlerësimi i konceptit pyll është vlerësuar nga shkalla e mbulimit mbi 10% kurse inventari i mëparshëm pyll e ka vlerësuar mbi 30% të shkallës së mbulimit.

Nr	Emertimi	Sipërfaqja, Ha sipas Inventarizimit Kombëtar:					Diferenca 2003 me 2018
		1953	1968	1985	2003	2018	
I	Pyje, kullota, bimësi pyjore	1356329		1045450	1907734	1703546	-204188
	Pyje & kullota		255561		1350474	1703546	
1	Pyje				941697	1197258	+255561
	Sipas formes së menaxhimit:		92984				
A	Pyje te larte (Trungishte)	242959	62543	470780	294957	387941	+92984
a	Pyje te larte me halore	94943	30442	164200	84461	147004	+62543
b	Pyje te larte me fletore	148016		206580	210496	240938	+30442
c	Pyje te mesem (Cungishte)	154589	147973	0	0	0	
d	Pyje te ulet (Cungishte)	584688	14604	307280	405016	552989	+147973
e	Shkurre	374093	97511	267490	241724	256328	+14604
B	Kullota				408777	506288	+97511
C	Toka me bimesi pyjore te rralla	0	0	0	557260	0	-557260

Dallimi mes inventarëve mund të matet vetëm përmes njësisë së volumit. Kështu, pyjet e Shqipërisë në vitin 2018 kanë një vëllim të materialit drusor prej rreth 57.7 mln m<sup>3</sup> kundrejt 73.5 mln m<sup>3</sup> që kanë pasur në vitin 2003. Nga vëllimi total drunor, është hequr për 15 vjet një vëllim prej 32.9 mln m<sup>3</sup> (përfshi materialin drusor të djegur nga zjarret në pyll), pra 2.2 mln/m<sup>3</sup>/vit, ose dyfishin e mundësisë vjetore të shfrytëzimit.



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

**Rezultatet: Volumi në vite (viti 1985, 2003 dhe 2018) rezulton: Tabela nr.70**

Nr.	Forma e qeverisjes (menaxhimit) të tokës	V(m <sup>3</sup> /ha) 1985	V(m <sup>3</sup> /ha) 2003	V(m <sup>3</sup> /ha) 2018	Volumi ne milion/ m <sup>3</sup>		
					1985	2003	2018
1	Trungishte	147.7	131,68	109.30	66.7	59.1	42.4
2	Cungishte	38.8	22,82	18.14	11.9	14.2	10.0
3	Shkurre	27.9	0,46	20.7	7.5	0.2	5.3
<b>Totali</b>					<b>86.1</b>	<b>73.5</b>	<b>57.7</b>

Lidhur me ciklin e inventarizimit, sipas nenit 6 të ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”, inventarizimi kombëtar i pyjeve realizon grumbullimin dhe vlerësimin e të dhënave për shtrirjen dhe gjendjen e fondit pyjor kombëtar. Ai synon vlerësimin e ndryshimeve hapësinore dhe kohore të fondit pyjor kombëtar, sigurimin e të dhënave me karakter sasior e cilësor, nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm e ciklik, duke mundësuar përditësimin periodik të të dhënave. Cikli i plotë i riinventarizimit kombëtar të pyjeve është 8-vjeçar, duke inventarizuar 25% çdo 2 vjet të fondit pyjor.

### Dixhitalizimi

Të dhënat e Regjistrimit Kombëtar të Fondit Pyjor sipas procesit të digjitalizimit dhe “Sistemit të Integruar të Informacionit në pyje”, programi ALFIS dhe certifikimi në ZVASHK-së.

Në fushën e pyjeve, hartimi i Regjistrimit Kombëtar të Fondit Pyjor mbështetet në informacionin digjital ku baza e të dhënave kadastrale pasqyrohet në “Sistemin e Integruar të Informacionit në pyje”, programi ALFIS.

**1 - Të dhënat që disponojmë sot në Sektorin e Inventarizimit dhe Kadastrës Pyjore vijojnë :**

- a- Sipërfaqja **totale** FP Kombëtar të dixhitalizuar ALFIS-TEST = **1.213.427,83 ha**, (për 61 bashkitë).
- b- Sipërfaqja e dixhitalizuar e FP për 54 (pesëdhjetë e katër) bashkitë që janë përfshirë në VKM-të e vitit 2020-2021 është: **SIPËRFAQJA = 1.056.297,43 ha**.
- c- Sipërfaqja e dixhitalizuar e FP, për 7(shtatë) bashkitë, që nuk janë përfshirë në VKM-të e vitit 2020-2021 është: **SIPËRFAQJA = 157130.4 ha**.

Sipas të dhënave nga AKP, sistemi “ALFIS” (Sistemi Kombëtar i Informacionit për Pyjet) është një Sistem i Informacionit centralizuar për organizimin e të dhënave dhe shërbimeve për të mbështetur të gjitha aktivitetet e menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave. Sistemi/programi vlerësohet përgjithësisht mirë për funksionalitetet që ofron, por ka dhe disa mangësi që kanë dalë nga përdorimi i tij, gjatë kësaj kohe, që nga implementimi si:

**Komanda jo aktive apo mungesë e tyre.** Janë vërejtur disa komanda (toolse) të cilat janë të krijuara në program, por nuk përgjigjen apo ekzekutojnë kërkesat për të cilat janë krijuar, por ka dhe raste në të cilat nuk janë komandat të krijuara që nga momenti fillimit por përdoruesit si në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore ashtu dhe në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve.

**Popullimi me të dhënat e njësisë bazë të sistemit që është parcela pyjore gjen eruar nga planet e mbarështimit:** Si bazë fillestare historike është përdorur informacioni i vitit 1985, si viti që kishte të gjitha Planet e Mbarështimit në fuqi. Informacion është i dixhitalizuar dhe i ngarkuar në sistemin ALFIS. Aktualisht mungon baza e të dhënave të përditësuara (të dhëna të viteve të fundit) të parcelës pyjore, të dhëna që duhet të gjen erohen automatikisht, gjatë hartimit të Planit të Menaxhimit (FPMP), nga aplikacioni i përpunimit të të dhënave mbas grumbullimit në terren nëpërmjet aplikacionit ZANA. Mungon moduli i kalkulimit të të dhënave dhe gjenerimi i përshkrimit të parcelave.

**Zhvillimi i modulit për gjenerimin/prodhimin e formatit të përshkrimit parcelar të planeve të menaxhimit nga ALFIS:** Mbas përmbylljes së popullimit me të dhëna është i nevojshëm edhe gjenerimi i formularit të përshkrimit parcelar në formatin e sanksionuar në



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

udhëzimin e Hartimit të Planeve të Menaxhimit funksionalitet që mungon në ALFIS. Duhet që formulari të ketë të plotësuar atributet kryesore sipas standardit të kërkuar dhe përditësohet me mbarimin e planit të ri të menaxhimit.

### **Përdorimi i ALFIS-it në të gjitha fazat e hartimit dhe zbatimit të nje Plani**

**mbarështimi/menaxhimi PM.** Konstatohet se në ALFIS ekzistojnë modulet e ndjekjes së të gjitha fazave të hartimit, miratimit të një PM, por për arsye të mungesës së disa tools-ave të përmendura më lart, kapaciteteve, mungesës së mirëmbajtjes nga AKSHI, deri tani asnjë nga bashkitë nuk ka mundur ta realizojë këtë proces nëpërmjet ALFIS-it.

**Raportimi:** ALFIS përveç informacionit të drejtpërdrejtë alfa numerik ofron dhe raporte që gjen erohen automatikisht nëpërmjet lidhjeve mes tabelave. Deri tani ALFIS gjen eron Raporte me të dhëna alfa-numerike në formatin csv. Në plotësim të standardëve të raportimit nevojitet krijimi i moduleve komplekse që gjen erojnë raporte në format word përfshi dhe grafikët. Shtimi i këtij moduli do përmbushte standardët e raportimit (INSPIRE).

**Mirëmbajtja:** Finalizimi i procedurave të mirëmbajtjes nga AKSH-i do të shënonte mundësinë e zyrtarizimit të përdorimit dhe zgjidhjen e një sërë problemesh që janë hasur dhe mund të hasen gjatë përdorimit të sistemit.

**Ngritja e kapaciteteve:** Për përsosjen e finalizimit të shërbimeve që ofron dhe duhet të ofrojë më tepër në të ardhmen nevojitet prezenca e një specialisti IT dhe eksperti të përdorimit të GIS-it pranë AKP-së. Jo vetëm sa përmendëm më lart po nevoja që ka ALFIS për përmirësim kërkon mbështetje me projekte për përmbushjen e të gjitha shërbimeve dhe funksionalitete dhe trajnim të stafit të AKP- së dhe stafeve të bashkive.

**Sa më sipër, në mënyrë të përmbledhur, duke analizuar evidencat dhe informacionet e administruara nga AKP, kolaudojmë si mëposhtëm:**

**Titulli i gjetjes:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, për shkak të mungesës së akteve nënligjore dhe burimeve financiare nuk ka kryer procesin e inventarizimit dhe dixhitalizimit të fondit pyjor.

**Situata:** Në lidhje me procesin inventarizimit të fondit pyjor konstatohet se inventari i fondit i përket vitit 2018 e për rrjedhojë rezultojnë se nuk ka nisur ciklin e radhës 8 vjeçar i ri inventarizimit kombëtar të pyjeve. Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor (RKFP) dhe dixhitalizimit nuk është i plotë, pasi në këtë fond pyjor nuk janë të pasqyruara ato sipërfaqe pyjorë të cilat i kanë kaluar në pronësi Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet VKM-së Nr. 707, datë 21.11.2018.

**Kriteri:** Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”.

**Ndikimi:** Mungesa e të dhënave mbi sipërfaqet e pyjeve ka sjellë që regjistri të mos paraqesë në mënyrë të plotë fondin pyjor.

**Shkaku:** Mungesa e bashkëpunimit mes bashkive, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, mungesa e burimeve financiare dhe akteve nënligjore.

**Rëndësia:** e Lartë.

**Rekomandim:** Për secilën nga çështjet e trajtuara janë lënë rekomandime në mënyrë të veçantë për Agjencinë Kombëtare të Pyjeve.

**-Në zbatim të Pikës 5. Mbi auditimin e menaxhimit dhe mbarështimit të pyjeve, kontrollin dhe monitorimin subjekteve të licencuara në shfrytëzimin e pyjeve, mbikëqyrjen dhe zbatimin e akteve ligjore /nënligjorë, akteve administrative, politikave nga strukturat e kontrollit të pyjeve bashki dhe në zonat e mbrojtura.**

Nga auditimi i kryer në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve rezultojnë se, është një institucion i cili është krijuar në Shtator të vitit 2020, me VKM nr.570, datë 17.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të “Agjencinë Kombëtare të Pyjeve” si dhe Urdhrit nr. 24, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencinë Kombëtare të Pyjeve si dhe me ligjin nr. 57/2020 “Për Pyjet” si i tillë akoma nuk ka



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

kompetencat e duhura sipas legjislacionit në fuqi, si pasojë e kësaj, kanë rol vetëm monitorues, kontrollues, pra që do të thotë dhe pse në ligj është dhe inspektimi, ky institucion akoma nuk kanë tagër për kryerjen e inspektimeve në Fondin pyjorë, sipas përcaktimeve ligjore dhe ligjit 57 “Për Pyjet” pasi nuk është unifikuar inspektimi online i –inspektimeve si dhe nuk është standardizuar një dokument nga Ministri i Mjedisit dhe Turizmit, për kryerjen e Inspektimeve me qëllim parandalimin e dëmtimit në Fondin Pyjorë.

Janë kryer kontrole dhe monitorime, të cilat janë hartuar mbi bazë planesh vjetore dhe programe mujore të miratuara nga titullari, por këto kontrole kanë mbetur vetëm si konstatime ndaj subjekteve që kanë kontrata 10-vjeare, për shfrytëzimin e pyjeve dhe ju është lënë detyra Njësive të Qeverisjes Vendore për marrje masash, pra kjo strukturë ka funksionuar si njësi auditimi të brendshëm e cila nuk ka këtë tagër. Pasi nuk ka një manual apo metodologji për kryerjen e auditit dhe lënë të rekomandimeve.

Nga auditimi rezultoi se;

Për 4-mujorin e fundit të vitit 2020 dhe vitit 2021 janë hartuar plane pune si dhe programe, ku qëllimi i tyre ka qenë njojhja me strukturat në Njësive të Qeverisjes Vendore. Ndërsa për vitin 2022, janë hartuar programe dhe kryer kontrole në Njësive të Qeverisjes Vendore.

Gjatë vitit 2021, në aspektin kryesor të punës nga ana e sektorit të menaxhimit është kryer vlerësimi dhe dhënia e mendimit për planet e menaxhimit të 6 ekonomive pyjore, të miratuara nga bashkitë përkatëse, të përcjella nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si vijon:

Dhënie mendimi për plan mbarështimi të një ekonomie pyjore private në Bashkinë Finiq. Pas plotësimit të dokumentacionit të munguar, si dhe korrigjimit të raportit teknik u dha mendim pozitiv në MTM.

Dhënie mendimi për plan mbarështimi të një ekonomie pyjore private në Bashkinë Lushnje me mbulesë pyjore 1% si një projekt ripyllëzimi, për të cilin u dha mendim pozitiv në MTM.

Dhënie mendimi për plan mbarështimi të ekonomisë pyjore Bruçaj në Bashkinë Shkodër. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur referuar Manualit udhëzues për Planet e Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me shkresën nr. 864, datë 30.01.2019, lidhur me mangësitë e konstatuara në shkeljen e procedurës dhe në përmbajtje, si dhe për mos certifikimin e të dhënave, nga AKP u dha mendim negativ me arsyet dhe rekomandimet përkatëse.

Janë në sistem tre plane menaxhimi të ekonomive pyjore të Bashkisë Tiranë, ku materiali i përcjellë nga MTM ishte me mangësi. Është kërkuar nga MTM dërgimi i materialit të plotë tekni o ligjor, për të vijuar me shqyrtimin dhe dhënien e mendimit për secilin plan menaxhimi. Është marrë informacion i plotë dhe i përditësuar nga të gjitha Njësive të Qeverisjes Vendore lidhur me situatën e planeve të menaxhimit të ekonomive pyjore, ku për 61 bashki me 372 ekonomi pyjore pa plane mbarështimit, janë realizuar 31 plane të mbarështimit të pyjeve, si dhe 13 plane mbarështimi janë në proces. Bashkëlidhur analizës tabela përkatëse e detajuar të Aneksi I.

Problematikat kryesore për sektorin të dala nga mungesa e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, si dhe nga planet e mbarështimit të ardhura për mendim nga ana e ministrisë.

Planet e mbarështimit të pyjeve dhe kullotave hartohen nga ana e NJQV jo në përputhje me Manualin udhëzues për Planet e Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me shkresën nr. prot. 864, datë 30.01.2019, akt i cili duhet të përditësohet në përputhje me dispozitat e reja ligjore në fuqi.

Lidhur me domosdoshmërinë e hartimit të planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore, rritjen e të ardhurave dhe nxitjen e investimeve në pyje, Njësive të Qeverisjes Vendore në zbatim të



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

detyrimeve dhe përgjegjësi që rrjedhin nga neni 17 të ligjit nr. 57, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, duhet të kryejnë:

1. Hartimin e regjistrit të bazës së të dhënave, “Regjistri i Kadastrës Pyjore”;
2. Furnizimin e popullatës me dru zjarri për ngrohje.
3. Thithjen e fondeve IPA të Bashkimit Europian për pyjet.

Duke qenë se këto çështje të rëndësishme burojnë nga Planet e Mbarështimit të Ekonomive Pyjore, është kërkuar nga Bashkitë me shkresat përkatëse që nëpërmjet të ardhurave të realizuara nga aktivitetet në fondin pyjor dhe kullor, nga buxheti i shtetit, si dhe financime të tjera, të fillojnë sa më shpejt hartimin e planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore.

Duke vlerësuar maksimalisht planin e mbarështimit të ekonomive pyjore, si një nga dokumentet themelor planifikues, ku përcaktohet saktë zhvillimi jetësor i këtyre ekonomive për një afat 10 vjeçar, rrjedhin një sërë dokumentesh të tjerë planifikues në funksion të mirëqeverisjes së pyjeve.

Duke u nisur nga ankesat e NJQV për mungesë fondesh për këtë qëllim, krahas detyrimit ligjor që ato kanë për hartimin e këtyre dokumenteve planifikues,

Në vijimësi janë ndjekur praktika për vlerësimin e performancën në sektorin e pyjeve, gjendjes së pyjeve dhe im paktit të sektorit duke u fokusuar në zbatimin e politikave (DPP), strategjive dhe programeve kombëtare në fushën e pyjeve (PKP, PKSP).

Vlerësimin e performancës në përdorimin e burimeve pyjore përkundrejt objektivave dhe nivelit të përmbushjes së treguesve, si dhe marrja e nismave për përmirësimin e performancës. Dhënia/ofrimi i asistencës teknike për institucionet qendrore e vendore, që kanë rol në zhvillimin dhe mbrojtjen e pyjeve;

Angazhime mbi evidentimin dhe monitorimin e ngjarjeve si: furtunat, shtrëngatat, ngricat, përmytjet, thatësira, zjarret, ndotjet e ajrit, ujit dhe tokës në pyje dhe kullota.

Angazhime në dhënie konsonancash e trajnime të ndryshme në përgatitjen e metodologjive të reja, udhëzuesve dhe projekteve për mënyrat e hartimit dhe miratimit të Planeve të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave.

Në organizimin e mbikëqyrjeve të aktiviteteve në punimet pyjore për zbatimin e rregulloreve dhe udhëzuesve gjatë dhe pas ndërhyrjeve operacionale,

### **1. Aktivitete në hartimin e manualeve, udhëzuesve, standardeve dhe normave etj.**

Gjatë kësaj periudhe janë hartuar dokumente nga AKP si:

- Standardi i hartimit të planit operacione të punimeve që do të kryejnë në fondin pyjor, kullor dhe prodhimet jo pyjore.
  - Manuali i modeleve- tip për hartimin projekteve të punimeve të cilët janë të detyrueshme nga strukturat e pyjeve pranë Bashkive (12 tipe projektësh).
  - Udhëzuesi për kryerjen e Inventarit të Pyjeve dhe Kullotave
  - Udhëzues për punimet në pyllëzime, zëvendësime dhe shërbimet kulturore në objektet e punimeve.
  - Udhëzuesin e punimeve në përmirësime,
  - Udhëzuesin e punimeve në kullota,
  - Udhëzuesin e punimeve në prodhimet pyjore jo drusore,
  - Standardi i fidanëve që duhet të përdoren në punimet e pyllëzimit dhe zëvendësimit për llojet kryesore.
  - Standardizimi i normave të punimeve që aplikohen në pyje, kullota, bimët etero vajore e tariforë, punimet në fidanishte dhe punimet që përdoren gjata shfrytëzimit të pyjeve.
- Sipas nenit 15 të ligjit 57 të Pyjeve germa ë) garantimin e funksionalitetit të sistemit të kontrollit dhe të inspektimit të veprimtarive që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar, duke





## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

ndërhyrë sipas përcaktimeve në këtë ligj. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e agjencisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

Në ligj është cituar për inspektimin e veprimtarisë që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar, duke ndërhyrë sipas përcaktimeve në këtë ligj, kjo nuk ka funksionuar për gjithë periudhën object auditimi.

Nga kontrollet e këtyre 10 kontratave konstatohet se AKP nuk administron asnjë dokument pasi kontrata nënshkruhen nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, si dhe shtesat e kontratave 1-vjecare nga Bashkitë përkatëse.

### Kontrata me afat 10-vjecare

-Për vitin 2022, për kontratat me afat 10-vjecare, janë kryer kontrole dhe monitorime në dy bashkinë Gramsh dhe Librazhd, në proces është Bashkia Korçë dhe Bashkia Elbasan nga ku ka rezultuar, se ka shkelje të kushteve të kontratave për të cilat janë përcjellë rekomandime.

**-Nga auditimi rezulton se nuk ka një analizë nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, sipas ligjit 5/2016, "Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë", mënyrën e funksionimit, neni 2, Objekti i këtij ligji është ndalimi i ushtrimit të veprimtarisë së shfrytëzimit të lëndës drusore në fondin pyjor publik/privat në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, tregtimi i produkteve të tij, ndalimi i eksportit të lëndës së drurit të papërpunuar, lëndës së ndërtimit, drurëve të zjarrit, si dhe i qymyrit të drurit, nuk ka funksionuar dhe nuk ka pasë efekte pasi kontrata me afat 10-vjecare kanë vazhduar aktivitetin e tyre. Nuk është bërë një analiza nga Ministria për rezultatet e dhëna nga ky ligj në Fondin Pyjorë, në bashkëpunimi me bashkitë.**

Nga materiale të vëna në dispozicion nga AKP, rezulton se janë lidhur 10 kontrata me afat 10 vjeçare, me objekte "Kontrata për shfrytëzimin e Materialit Drusorë në këmbë në grup ngastra Pyjore, pa rrugë Auto pyjorë"

Këto kontrata janë të nënshkruara nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit si dhe Bashkitë përkatëse, pjesa e madhe e kontratave është në Bashkinë Librazhd Gramash Elbasan Korçë Përkatësisht.

1. Kontrata nr.1 datë 02.10.2008 lidhur ndërmjet Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Gramsh dhe shoqërisë Al M. Ë.
2. Kontrata nr.1 datë 04.07.2011, lidhur ndërmjet Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Gramsh dhe shoqërisë Al M. Ë.
3. Kontrata nr.252 datë 26.03.2013 lidhur ndërmjet Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Korçë dhe shoqërisë A. shpk
4. Kontrata nr.5847 datë 20.08.2013 lidhur ndërmjet Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Elbasan dhe shoqërisë Al-M. Ë.
5. Kontrata nr.3680 datë 25.05.2015 midis Ministrisë së Mjedisit dhe bashkimit të shoqërive "O., 2A dhe "R" në Elbasan.
6. Kontrata me nr.9543 datë 25.09.2014 mes Ministrisë së Mjedisit dhe "S. dhe D.L.", për shfrytëzimin e ekonomisë pyjore në Dardhe-Xhyrë Librazhd.
7. Kontrata me nr. 8793 datë 26.11.2012 mes Drejtorisë së Pyjeve Librazhd dhe shoqërisë Al-M. Ë. dhe S."
8. Kontrata me nr. Prot datë 5480 datë 29.07.2013, lidhur mes Ministrisë së Mjedisit dhe bashkimit të shoqërive "2A" shpk në Librazhd.
9. Kontrata me nr.5479 datë 25.05.2013, mes Ministrisë së Turizmit dhe subjektit "A." në Librazhd.
10. Kontrata me nr. 3681 datë 25.05.2015, mes Ministrisë së Turizmit dhe shoqërisë Al-M. Ë. dhe P." shpk në Librazhd.

-Për periudhën e audituar, ndonëse ka qenë i miratuar ligji nr. 5/2016 "Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë", ky ligj dhe VKM nr.438 datë 08.06.2016



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

që pasoi e lejuan vazhdimësinë e këtyre kontratave me disa kushtëzime si shfrytëzimi i ngastrave të bëhet vetëm me qëllim, shëndetësimin e pyjeve pastrimin e mbeturinave dhe enteve tjera për dru zjarri, kushte këto që nuk janë zbatuar sikurse është konstatuar nga vet kontrollet e kryera nga AKP.

Kontrollet e kryera

### **Bashkia Gramsh**

**I.** Para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për pyjet” dhe ligjit nr. 5/2016 “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”, vetëm një subjekt juridik ka dy kontrata shfrytëzimi të pyjeve në bashkinë Gramsh, shoqëria “Al M. Ë.” sh.p.k.

Në zbatim të kontratave respekt ivë, shoqëria “Al M. Ë.” sh.p.k ka shfrytëzuar lëndë drusore në tre ekonomi pyjore, Holtë-Lukovë, Poroçan dhe Rove, ku për përuhdën kur janë lidhur kontratat e shfrytëzimit të vitit 2008 dhe 2011, për dy ekonomitë pyjore Poroçan dhe Rove nuk kanë patuar plane mbarështimi të miratuara.

Ekonomia Pyjore Holtë-Lukovë ka plan mbarështimi të miratuar në vitin 2004 me afat 10 vjeçar, ku kontrata e dytë e vitit 2011 në objekti Pylli i Zi të kësaj ekonomie pyjore vazhdon me një aneks kontratë edhe pse planit të mbarështimit i ka kaluar afati.

**II.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të marrë nga Bashkia Gramsh, u konstatuan:

1. Kontrata e parë e shfrytëzimit ndërmjet Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Gramsh (në varësi të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave) dhe shoqërinë “Al M. Ë.” sh.p.k me nr. 1, datë 2.10.2008 është lidhur pa afat në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Duke ju referuar legjislacionit të zbatueshëm për periudhën kur është lidhur kjo kontratë, miratimi i saj është bërë nga MMPAU, në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi:

Për ekonomitë pyjore Poroçan dhe Rove nuk ka patuar plan mbarështimi të miratuar.

Për ekonominë pyjore Holtë – Lukovë plani i mbarështimit i miratuar në vitin 2004, (referuar ligjit nr. 7623, datë 13.10.1992, “Për pyjet dhe policinë pyjore” të ndryshuar), mbaronte në vitin 2014 dhe kontrata nuk mund të lidhej për një afat 10 vjeçar sipas ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” të ndryshuar, por duhej të ishte 6 vjeçare deri në vitin 2014.

Kjo kontratë ka vazhduar deri në vitin 2020, ku është bërë një aneks kontrate me afat 1 vjeçar deri në 2021, nga ana e Bashkisë Gramsh si pronare e pyjeve, me nr. 10, datë 22.10.2020.

Kjo kontratë është lidhur në kundërshtim me pikën 1 të nenit 27 të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”.

Shfrytëzimi i materialit drusor lejohet në fondin pyjor kombëtar për qëllime të përfitimit ekonomik dhe vetëm nëpërmjet kryerjes së punimeve të parashikuara në planet e mbarështimit duke u realizuar sipas përcaktimeve në këtë ligj. Në trajtimin dhe shfrytëzimin e fondit pyjor, përdorimi i standardeve për prerjet vjetore të lejueshme, ciklet e prerjeve, teknikat e shfrytëzimit dhe infrastruktura janë të detyrueshme.

2. Kontrata e dytë e shfrytëzimit ndërmjet Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Gramsh dhe shoqërisë “Al M. Ë.” sh.p.k me nr. 1, datë 4.07.2011 është lidhur me afat 14 vjeçar deri në datën 4.7.2025 në kundërshtim me afatin maksimal 10 vjeçar, kur plani i mbarështimit ka mbaruar në vitin 2014.

Kjo kontratë ka vazhduar deri në vitin 2021, ku është lidhur dhe aneks kontrata me nr. 11, datë 12.10.2020 me afat 1 vjeçar, si dhe Aneks Kontrata e shfrytëzimit me nr. 12/1, datë 23.11.2021 në objektin O. të ekonomisë pyjore Holtë – Lukovë me afat 1 vjeçar e cila vazhdon.

3. Aneks kontratat e lidhura në vijim të kontratave respekt ivë të vitit 2008 dhe 2011 nuk kanë miratim nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Këto aneks kontrata janë lidhur në kundërshtim me nenin 11 dhe 27 të ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për pyjet”, si dhe paragrafët 1, 2 dhe 4 të Kreut III të vendimit të Këshillit të



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

Ministrave nr. 438, datë 8.6.2016 “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jo pyjore”.

Referuar dokumentacionit të paraqitur, projekteve teknike dhe proces-verbaleve përkatëse, si dhe kontrollit të ushtruar në terren nga grupi i punës së Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, së bashku me specialistët e pyjeve të bashkisë Gramsh e konkretisht në ekonomitë pyjore të bashkisë Gramsh rezultoi:

Lidhur me kontratën e shfrytëzimit të vitit 2008 dhe aneks kontratën e vitit 2020 subjekti kontakto nuk e ushtron aktivitetin.

Vazhdon shfrytëzimi sipas kontratës së vitit 2011 me afat deri në 4.07.2025 dhe aneks kontratën e vitit 2021 për objektin “P. Z.” të ekonomisë pyjore Holtë-Lukovë.

Lidhur me verifikimin në terren të ngastrave pyjore Nr 4, 15a, 16a dhe 26a të Ekonomisë Pyjore “Holtë Lukovë” sipas Aneks - Kontratës Nr. 11, datë 12.10.2020, (në vijim të kontratës nr. 1, datë 2.10.2008) të lidhur ndërmjet Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Bujqësisë e Mbrojtjes së Konsumatorit të Bashkisë Gramsh dhe subjekti juridik “Al M. E.” shpk, si dhe urdhrave të Kryetarit të Bashkisë Gramsh për damkim nr. 155, datë 27.05.2020 dhe nr. 204, datë 9.07.2020, rezultoi sa vijon:

Kjo Aneks Kontratë, ka patur si objekt shfrytëzimin e materialit drusor në ngastrat e nëngastrat pyjore e objekteve të miratuara nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, sot Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit, për shitjen e materialit drusor në pyjet publike në ankand me mënyrën në këmbë, të paprera dhe të fituara nga shoqëria “Al M. E.” shpk.

Grupi i punës pas kontaktit që mori me specialistët e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Bujqësisë e Mbrojtjes së Konsumatorit në Bashkinë Gramsh, paraqiti urdhrin dhe programin e punës dhe kërkoi dokumentacionin përkatës, Kontrata, Anex-Kontrata, Leje shfrytëzimi, Projektin Teknik, Procesverbale të dorëzimit të ngastrave dhe në ngastrave si dhe Procesverbale të Kolaudimit, liste damkat, e dokumente të tjera.

Në datën 22.06.2022, grupi i punës verifikoi në terren ngastrën pyjore nr. 4, të Ekonomisë Pyjore “Holtë Lukovë” me një sipërfaqe pyjore prej 13.7 hektarë, sipas Planit të Mbarështimit të vitit 2002, e përbërë nga lloji Ah, ku janë kryer prerje regjenerues gjatë periudhës Tetor 2020-Tetor 2021. Gjatë verifikimit të ushtruar rezulton se është kryer prerja në një sipërfaqe prej 13.7 hektarë dhe janë prerë drurët e damkosur të llojit Ah. Filizëria është e instaluar dhe takohet pothuajse në të gjithë sipërfaqen.

Gjatë kontrollit të ushtruar në ngastrën nr.15a të Ekonomisë Pyjore “Holtë Lukovë” e përbërë nga lloji Ah, në ne ngastrën me sipërfaqe prej 19.27 hektarë sipas Planit të Mbarështimit të vitit 2002, rezulton se janë kryer prerjet regjenerues në këtë sipërfaqe dhe janë prerë drurët e damkosur me çekiç damkë. Filizëria e pranishme në këtë ne ngastër është mjaft e mirë dhe pothuajse uniforme.

Në vijimësi u kontrollua sipërfaqja prej 20.57 hektarë e nëngastrës pyjore nr.16a, e përbërë nga lloji Ah e cila gjendet në Ekonomisë Pyjore “Holtë Lukovë”. Edhe në këtë sipërfaqe janë kryer prerje regjenerues gjatë periudhës Tetor 2020 - Tetor 2021. Gjatë verifikimit të nëngastrës rezulton se është kryer prerja e drurëve të damkosur sipas listë-damkës. Në këtë sipërfaqe është instaluar filizëria e cila takohet në të gjithë sipërfaqen.

Po në Ekonominë Pyjore “Holtë Lukovë” u verifikua dhe nëngastra 26a e kësaj ekonomie, e cila ka një sipërfaqe prej 20.20 hektarë sipas Planit të Mbarështimit të vitit 2002. Grumbulli pyjor që shtrihet në këtë ngastër është i përbërë nga llojet Ah dhe Pishë e Zezë.

Në këtë nëngastër, në një sipërfaqe prej 0.7 hektarë të përbërë nga lloji Ah dhe sipërfaqe prej 19.5 hektarë të përbërë nga lloji Pishë e Zezë, janë kryer prerje rigjeneruese gjatë periudhës Tetor 2020 - Tetor 2021. Gjatë verifikimit, rezulton se janë prerë drurët e damkosur me çekiç damkë. Filizëria është instaluar në vatra dhe jo uniforme në të gjithë sipërfaqen.



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

Për të katër parcelat e mësipërme janë mbajtur dhe Proces-Verbalet përfundimtare të kolaudimit nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Bujqësisë e Mbrojtjes së Konsumatorit, të Bashkisë Gramsh.

Në datën 23.06.2022, grupi i punës vijoi punën në terren në Ekonominë Pyjore “Holtë Lukovë”, në objektin “Pylli i Zi” ku u kontrolluan nëngastrat 74a, 76a dhe 78a, nëngastra këto të dhëna për shfrytëzim të materialit drusor në këmbë, sipas Aneks - Kontratës Nr. 12, datë 4.11.2021, në vijim të kontratës Nr.1, datë 4.07.2011, të lidhur ndërmjet Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Bujqësisë e Mbrojtjes së Konsumatorit, të Bashkisë Gramsh dhe subjektit juridik “Al M. Ë.” shpk.

U verifikua në terren, nën ngastra nr. 78a e cila ka një sipërfaqe prej 27.47 hektarë dhe në këtë sipërfaqe takohet grumbull pyjor i përbërë nga llojet Ah dhe Bredh. Gjatë verifikimit rezultoi që është duke u kryer aktiviteti i prerjes së drurëve, ku u konstatuar dhe prerje të drurëve të pa damkosur.

Gjithashtu u konstatua se në parcelën nr. 79 e cila nuk është pjesë e ngastrave të miratuara sipas aneks kontratës për shfrytëzim, janë evidentuar prerje të paligjshme të drurëve të llojit Ah dhe Bredh, si dhe një rrugë e hapur rishtas rreth 450 m që fillonte në kufi të parcelës 78a, përshkonte një pjesë të parcelës nr. 79 dhe përfundonte në kufirin e sipërm të parcelës nr. 78a.

### **II.-Nga AKP me shkresën nr.642/2datë 19.08.2022, janë përcjellë Bashkisë Gramsh propozimet dhe masat për kontrollin e ushtruar si me poshtë :**

1. Zgjidhjen nga ana e Bashkisë Gramsh të Kontratës me nr. 1, datë 2.10.2008, “Për shfrytëzimin e materialit drusor në këmbë në ngastrat e nëngastrat pyjore pa rrugë autopsyjore”, ndërmjet Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Gramsh dhe shoqërisë “Al M. Ë.” sh.p.k.

2. Zgjidhjen nga ana e Bashkisë Gramsh të Kontratës me nr. 1, datë 4.07.2011, “Për shfrytëzimin e materialit drusor në këmbë në grup ngastrat pyjore pa rrugë autopsyjore”, kontratë e lidhur ndërmjet Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Gramsh dhe shoqërisë “Al M. Ë.” sh.p.k

Për rrjedhojë, si dhe për shkeljet e kërkesave ligjore dhe të kushteve dhe të detyrimeve kontraktore, të cilat sipas nenit 698 të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përbëjnë shkak të ligjshëm për zgjidhjen e kontratës, kërkojmë:

3. Zgjidhjen nga ana e Bashkisë Gramsh të aneks kontratave të shfrytëzimit, të cilat janë në fuqi.

4. Mos lidhjen nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Bujqësisë e Mbrojtjes së Konsumatorit të Bashkisë Gramsh të aneks kontratave të reja në vijim, në zbatim të kontratave të shfrytëzimit.

5. Lidhur me shkeljet e konstatuara gjatë kontrollit në terren në ekonominë pyjore të bashkisë Gramsh, lidhur me mos evidentimin dëmeve dhe mos marrjen e masave ndaj kontraktorit nga ana e punonjësve të strukturës kontrolluese të pyjeve, bazuar në pikën 11 të nenit 36 të ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”, **Propozojnë:**

Fillimin e procedimit administrativ për dhënien e masave disiplinore ndaj punonjësve të mëposhtëm:

5.1. Largim nga detyra për punonjësit e bashkisë.

#### **Bashkia Librazhd**

Kontrolli i kryer në Bashkinë Librazhd për subjektet të cilat kanë kontrata të lidhura për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore, plotësimi I kushteve nga ana e tyre.

***rezultojnë 5 kontrata të shfrytëzimit të pyjeve, ku referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Drejtorisë së Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit e bashkisë Librazhd u konstatuan:***



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

**I.** Referuar kontratës me nr. prot. 9543, datë 25.09.2014, “Për vjeljen e materialit drusor në këmbë në grup ngastrat pa rrugë pyjore”, lidhur ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe subjektit juridik bashkimi i shoqërive “S. dhe D. L.”, përfaqësuar nga z. K. S..

Objekti i kontratës është hapja e rrugës auto pyjore dhe vjelja e materialit drusor në këmbë, të ngastrave pyjore nr. 77, 78, 79 dhe 80 me dru Ah, të Ekonomisë Pyjore Dardhë - Xhyrë, të fituar me ankand publik, me afat 10 vjeçar deri më 24.09.2024, ku rezulton sa vijon:

Ekonomia pyjore Dardhë - Xhyrë nuk ka plan mbarështimi të miratuar. Kjo kontratë është lidhur në kundërshtim me pikën 1 të nenit 26, të ligjit nr. 9385, datë 4.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” të ndryshuar.

Në vitin 2019 është hartuar nga subjekt privat i licensuar plani i mbarështimit për ekonominë pyjore Dardhë - Xhyrë, miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak të bashkisë Librazhd nr. 40, datë 25.03.2019, ku pas marrjes së konfirmimit nga ana e Prefektit të Qarkut Elbasan me shkresën me nr. prot. 480/1, datë 3.04.2019, praktika është dërguar nga bashkia për miratim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit me shkresën me nr. prot. 2509, datë 30.04.2019, ku deri më sot nuk ka një akt miratimi për këtë plan mbarështimi.

1. Në mbështetje të kontratës së mësipërme nga ana e bashkisë Librazhd është lidhur Aneks kontrata nr. 9543/7 me nr. prot. 3389, datë 18.06.2021, “Për shfrytëzimin e lëndës drusor në këmbë në ngastrën 78a (II), të ekonomisë pyjore Dardhë - Xhyrë, me afat një vjeçar deri më 10.06.2022, e cila ka përfunduar.

Bashkëlidhur aktit janë listë damka, projekti teknologjik për shfrytëzimin e ngastrës 78a të ekonomisë pyjore Dardhë - Xhyrë, leja e shfrytëzimit nr. 1, datë 18.06.2021 e bashkisë Librazhd, proces-verbali i dorëzimit i datës 19.06.2021 dhe proces-verbali provizor i kolaudimit i datës 15.04.2022.

2. Në datën 21.04.2022 nga ana e bashkisë Librazhd është dhënë leja e shfrytëzimit nr. 2, me proces-verbal dorëzimi të datës 25.04.2022 me afat deri më 10.06.2022, ku kolaudimi i ngastrës është shtyrë në datën 29.07.2022 për arsyet e paraqitura në akt kontrollin e datës 10.06.2022, ku subjektit i janë lënë detyra për të përmbyllur detyrimet kontraktore.

**II.** Referuar kontratës me nr. prot. 793, datë 26.11.2012, “Për vjeljen e materialit drusor në këmbë në grup ngastrat pa rrugë pyjore”, në ngastrat pyjore nr. 81, 82, 83, 84, 85, 86, 87, 88, 89, 90, 91, 92, 93 dhe 94 të Ekonomisë Pyjore Dardhë - Xhyrë, lidhur ndërmjet Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Librazhd në varësi të Ministrisë së Mjedisit dhe subjekti juridik bashkimi i shoqërive “Al M. E. dhe Sinani”, përfaqësuar nga z. E. M, me afat 10 vjeçar deri më 26.11.2022, rezulton sa vijon:

1. Në mbështetje të kontratës së mësipërme të datës 26.11.2012 nga ana e bashkisë Librazhd është lidhur Aneks kontrata nr. 793/8 me nr. prot. 4119, datë 29.07.2021, “Për shfrytëzimin e lëndës drusore në këmbë në ngastrat me nr. 89a (II), 90a (I) dhe 91a(I) të ekonomisë pyjore Dardhë - Xhyrë, me afat një vjeçar deri më 20.07.2022, e cila ka përfunduar.

2. Në datën 21.02.2022 nga ana e bashkisë Librazhd është dhënë leja e shfrytëzimit nr. 2, me afat deri më 20.07.2022, 3 proces-verbale dorëzimi të datës 22.02.2022, ku nuk është kryer kolaudimi përfundimtar.

3. Në mbështetje të kontratës së mësipërme të datës 26.11.2012 nga ana e bashkisë Librazhd është lidhur Aneks kontrata nr. 793/9 me nr. prot. 3124, datë 1.07.2022, “Për shfrytëzimin e lëndës drusore në këmbë në ngastrat me nr. 90a (II) dhe 91a(II), të ekonomisë pyjore Dardhë - Xhyrë, me afat një vjeçar deri më 21.06.2023.

Bashkëlidhur aktit janë listë damkat, projekti teknologjik për shfrytëzimin e ngastrave me nr. 90a (II) dhe 91a(II), të ekonomisë pyjore Dardhë - Xhyrë, leja e shfrytëzimit nr. 1, datë 12.07.2022 e bashkisë Librazhd dhe dy proces-verbale të dorëzimit të datës 12.07.2022.



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

**III.** Referuar kontratës me nr. prot. 5480, datë 29.07.2013, “Për vjeljen e materialit drusor në këmbë në grup ngastrat pa rrugë pyjore, lidhur ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe bashkimit të shoqërive “2A” sh.p.k dhe “Z2AK” sh.p.k, përfaqësuar nga z. A. S. Objekti i kontratës është hapja e rrugës auto pyjore dhe vjeljen e materialit drusor në këmbë të ngastrave pyjore nr. 86a, 87a, 88a, 89a, 97a, 147a, 148a, 149a, 150a, 151a, 152a dhe 153a me dru Ah, të ekonomisë pyjore Polis, të fituar me ankand publik, me afat 10 vjeçar deri më 29.07.2023, rezulton sa vijon:

Plani i mbarështimit është miratuar me urdhrin e Ministrit nr. 355, datë 25.04.2013, me nr. prot. 2971, datë 25.04.2013, “Për miratimin e planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore Polis të bashkisë Librazhd”, përcjellë me shkresën e MMPAU me nr. prot. 2971/1, datë 29.04.2013.

1. Në mbështetje të kontratës së mësipërme me nr. prot. 5480, datë 29.07.2013, nga ana e bashkisë Librazhd është lidhur Aneks kontrata nr. 5480/6 me nr. prot. 4152, datë 29.07.2021, “Për shfrytëzimin e lëndës drusore në këmbë në ngastrën 151a (I) dhe 153a (I), të ekonomisë pyjore Polis me afat një vjeçar deri më 20.07.2022, e cila ka përfunduar.

Bashkëlidhur aktit janë listë damka, projekti teknologjik, si dhe:

1.1 Leja e shfrytëzimit nr. 1, datë 30.07.2021 e bashkisë Librazhd, proces-verbali i dorëzimit i datës 16.07.2021 dhe proces-verbali provizor i kolaudimit i datës 5.01.2022.

1.2 Leja e shfrytëzimit nr. 2, datë 6.01.2022 e bashkisë Librazhd, proces-verbali i dorëzimit i datës 6.01.2022.

2. Në mbështetje të kontratës së mësipërme me nr. prot. 5480, datë 29.07.2013, nga ana e bashkisë Librazhd është lidhur Aneks kontrata nr. 5480/9 me nr. prot. 3900, datë 14.07.2021, “Për shfrytëzimin e lëndës drusore në këmbë në ngastrën 87a (I), të Ekonomisë Pyjore Polis me afat një vjeçar deri më 30.06.2022, e cila ka përfunduar.

3. Në mbështetje të kontratës së mësipërme me nr. prot. 5480, datë 29.07.2013, nga ana e bashkisë Librazhd është lidhur Aneks kontrata nr. 5480/9 me nr. prot. 2353, datë 16.05.2021, “Për shfrytëzimin e lëndës drusore në këmbë për hapjen e trasesë së rrugës auto pyjore midis ngastrave 87a dhe 86a, të Ekonomisë Pyjore Polis me afat një vjeçar deri më 10.05.2023.

Bashkëlidhur aktit janë listë damka, leja e shfrytëzimit nr. 1, datë 27.05.2022 e bashkisë Librazhd dhe proces-verbali i dorëzimit i datës 27.05.2022, ku duhet të kryhet kolaudimi.

Në mbështetje të kontratës së mësipërme nga ana e bashkisë Librazhd është lidhur Aneks kontrata me nr. 5480/10, nr. prot. 3084, datë 30.06.2022 me subjektin “2A” sh.p.k me përfaqësues z. A. S., “Për shfrytëzimin e lëndës drusore në këmbë në ngastrën 87a (II) të Ekonomisë Pyjore Polis me afat një vjeçar, deri më 8.06.2023.

Bashkëlidhur aktit janë listë damka, projekti teknologjik për shfrytëzimin e ngastrës 87a (II) të Ekonomisë pyjore Polis, leja e shfrytëzimit nr.1, datë 30.06.2022 e bashkisë Librazhd, proces-verbali i dorëzimit i datës 30.06.2022.

**IV.** Referuar kontratës me nr. prot. 5479, datë 29.07.2013, “Për vjeljen e materialit drusor në këmbë në grup ngastrat pa rrugë pyjore, lidhur ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe subjektit juridik “A” sh.p.k, përfaqësuar nga z.Sh. A.

Objekti i kontratës është hapja e rrugës auto pyjore dhe vjelja e materialit drusor në këmbë të ngastrave pyjore nr. 84a, 85a, 86a, 87a, 88a dhe 89a me dru Ah, të Ekonomisë Pyjore Neshtë - Prevall, të fituar me ankand publik, me afat 10 vjeçar, deri më 29.07.2023, rezulton sa vijon:

Plani i mbarështimit është miratuar me urdhrin e Ministrit nr. 348, datë 24.04.2013, nr. prot. 2919, datë 24.04.2013, “Për miratimin e planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore Neshtë - Prevall të bashkisë Librazhd”, përcjellë me shkresën e MMPAU me nr. prot. 2971/1, datë 29.04.2013.



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

1. Në mbështetje të kontratës së mësipërme me nr. prot. 5479, datë 29.07.2013, nga ana e bashkisë Librazhd është lidhur Aneks kontrata nr. 5480/8 me nr. prot. 3979, datë 21.07.2021, “Për shfrytëzimin e lëndës drusore në këmbë në ngastrën 85a(I) të ekonomisë pyjore Neshtë - Prevall me afat një vjeçar, deri më 20.07.2022, e cila ka përfunduar.

Bashkëlidhur aktit janë listë damkat, projekti teknologjik për shfrytëzimin e fazës së parë të ngastrës 85a të ekonomisë pyjore Neshtë Prevall, si dhe:

1.1 Leja e shfrytëzimit nr. 1, datë 23.07.2021 e bashkisë Librazhd, proces-verbali i dorëzimit i datës 23.07.2021.

1.2 Leja e shfrytëzimit nr. 2, datë 21.03.2022 e bashkisë Librazhd dhe proces-verbali i dorëzimit i datës 22.03.2022, ku duhet të kryhet kolaudimi përfundimtar.

**V.** Referuar kontratës me nr. prot. 3681, datë 25.05.2015, “Për vjeljen e materialit drusor në këmbë në grup ngastrat pa rrugë pyjore, lidhur ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, dhe bashkimit të shoqërive “A. M” dhe “P” sh.p.k, përfaqësuar nga z. E. M, me objekt vjeljen e materialit drusor në këmbë të ngastrave pyjore nr. 118 dhe nr. 119, të ekonomisë pyjore Dardhë Xhyrë dhe të ngastrave pyjore nr. 75 dhe nr. 76b të ekonomisë pyjore Polis, rezulton se:

Ekonomia pyjore Dardhë - Xhyrë nuk ka plan mbarështimi të miratuar. Kjo kontratë është lidhur në kundërshtim me pikën 1 të nenit 26, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” të ndryshuar.

1. Në mbështetje të kontratës së mësipërme me nr. prot. 3681, datë 25.05.2015, nga ana e bashkisë Librazhd është lidhur Aneks kontrata me nr. prot. 2713, datë 17.05.2021, “Për shfrytëzimin e lëndës drusore në këmbë në ngastrën 76b(II) të ekonomisë pyjore Polis me afat 1 vjeçar, deri më 28.04.2022, e cila ka përfunduar.

1.1 Bashkëlidhur projekti teknik, leja e shfrytëzimit nr. 1, datë 17.05.2021, procesverbali i dorëzimit i datës 18.05.2021 dhe procesverbali i kolaudimit i datës 28.12.2021 për ngastrën 76b pjesa e parë.

1.2 Në vijim është dhënë leja e shfrytëzimit nr. 2, datë 5.01.2022, pjesa e dytë, procesverbali i dorëzimit i datës 6.01.2022 dhe procesverbalet e transportit.

1.3 Në zbatim të shkresës së bashkisë Librazhd të datës 27.07.2021 dhe akt kontrollit të datës 4.06.2021, shoqëria “Pisha” ka paguar sasinë e materialit drusor të rrëzuar, thyer, si dhe të shkukur nga hapja e trasesë. Referuar shkresës së bashkisë Librazhd me nr. prot. 54/1, datë 19.04.2022, akti përfundimtar i kolaudimit është shtyrë në datën 28.07.2022.

**VI.** Duke ju referuar shkeljeve të konstatuara gjatë kontrolleve dhe verifikimeve në terren nga ana e grupit të punës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe përfaqësuesve të Drejtorisë së Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit të bashkisë Librazhd, lidhur me përputhshmërinë e zbatimit të kushteve të kontratave dhe kërkesave ligjore nga ana e subjekteve përgjegjëse, rezultoi:

1. Referuar kontratës me nr. prot. 5480, datë 29.07.2013, “Për vjeljen e materialit drusor në këmbë në grup ngastrat pa rrugë pyjore, lidhur ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe bashkimit të shoqërive “2A” sh.p.k dhe “Z2AK” sh.p.k, përfaqësuar nga z. A. S. u konstatuan këto shkelje:

Gjatë verifikimit në terren të ngastrës pyjore 87a(II), u konstatuan këto shkelje:

Dru i damkosur me listë damkë jo sipas përcaktimit në kontratë dhe tabelën e listë damkave verifikuar me listë damkën L3, si dhe një dru i damkosur me çekiç damkë L4.

3 (tre) drurë me damkë të dëmtuar.

2 (dy) drurë të rrëzuar pa damkë.

Materialit drusor i nxjerrë në anë të rrugës nuk i është bërë marketimi me bojë vaji të dallueshme, në këtë rast ngjyrë e kuqe, sipas aneks kontratës.

2. Referuar kontratës me nr. prot. 5480, datë 29.07.2013, “Për vjeljen e materialit drusor në këmbë në grup ngastrat pa rrugë pyjore, lidhur ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

Administrimit të Ujërave dhe bashkimit të shoqërive “2A” sh.p.k dhe “Z2AK” sh.p.k, në ngastrat pyjore 151a(I) dhe 151a(II) me Ah, u konstatuan këto shkelje:

Gjatë verifikimit në terren në ngastrën pyjore 151a, u konstatuan këto shkelje:

Rezultoni prerja e 4 (katër) drurëve mbi lartësinë e diametrit.

Pastrimi i pjesëve parcelave nuk është bërë si në parashikimin e Aneks-Kontratës me nr. 4152, datë 29.06.2021.

Materialit drusor i nxjerrë në anë të rrugës nuk i është bërë marketimi me bojë vaji të dallueshme, në këtë rast ngjyrë e kuqe, sipas aneks kontratës.

Çekiç damka është vendosur në krahun e sipërm të trungut, ku ka dëmtime në disa drurë.

Lidhur me verifikimin në terren të ngastrës pyjore nr. 153, u konstatuan këto problematika:

Rezultoni prerja e 2 (dy) drurëve mbi lartësinë e diametrit.

Pastrimi i pjesëve parcelave nuk është bërë si në parashikimin e Aneks-kontratës me nr. 4152, datë 29.06.2021.

Çekiç damka është vendosur në krahun e sipërm të trungut ku ka dëmtime në disa drurë, si dhe gjatë kontrollit u konstatua 1 (një) dru me diametër 70 cm, me damkë të dëmtuar.

Materialit drusor i nxjerrë në anë të rrugës nuk i është bërë m arkëtimi me bojë vaji të dallueshme, në këtë rast ngjyrë e kuqe, sipas aneks kontratës.

**3.** Referuar kontratës me nr. prot. 793, datë 26.11.2012, “Për vjeljen e materialit drusor në këmbë në grup ngastrat pa rrugë pyjore”, në ngastrat pyjore nr. 81, 82, 83, 84, 85, 86, 87, 88, 89, 90, 91, 92, 93 dhe 94 të Ekonomisë Pyjore Dardhë - Xhyrë.

Referuar kontratës së lidhur ndërmjet Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Gramsh në varësi të Ministrisë së Mjedisit dhe subjekti juridik bashkimi i shoqërive “Al M. E.” sh.p.k dhe “S.” sh.p.k, në ngastrat pyjore 89a(II) dhe 90a(I) me Ah, u konstatuan këto shkelje:

3.1 Gjatë verifikimit në terren të ngastrës pyjore 89a(II), u konstatuan këto shkelje: 44 (dyzetekatër) drurë të prerë pa damkë.

Pastrimi i parcelës nuk është bërë sipas aneks-kontratës me nr. 793/8, datë 29.07.2021.

Çekiç damka është vendosur në krahun e sipërm të trungut, ku ka dëmtime në disa drurë.

3.2 Gjatë verifikimit në terren të ngastrës pyjore 90a(I) u konstatuan këto shkelje:

19 (nëntëmbëdhjetë) drurë të prerë pa damkë.

3 (tre) drurë të prerë përpara se te jepej ngastra për shfrytëzim, damkosur me L4, damkë e ngastrës 91a.

1 (një) prerje e re ne parcelën e cila ka qenë më parë e shfrytëzuar.

7 (shtatë) drurë me damkë të dëmtuar.

Rezultoni prerja e 2 (dy) drurëve mbi lartësinë e diametrit.

Pastrimi i parcelës nuk është kryer.

Çekiç damka është vendosur në krahun e sipërm të trungut ku ka dëmtime në disa drurë.

Në ngastër ka dy drurë të damkosur të paprerë.

3.3 Lidhur me verifikimin në terren të ngastrës pyjore 91a(I) u konstatua hapje rruge autopsyjore pa projekt teknologjik e cila fillon në kufirin ndarës midis ngastrave 90a dhe 91, në drejtimin juglindor përgjatë ngastrës 91a, me një gjatësi prej 90 m.

6 (gjashtë) drurë të prerë pa damkë.

Çekiç damka është vendosur në krahun e sipërm të trungut, ku ka dëmtime në disa drurë.

Pastrimi i parcelës nuk është kryer.

**4.** Referuar kontratës me nr. prot. 9543, datë 25.09.2014, “Për vjeljen e materialit drusor në këmbë në grup ngastrat pa rrugë pyjore”, lidhur ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe subjekti juridik bashkimi i shoqërive “S. dhe D. L.”, në datën 21.07.2022 u konstatuan këto shkelje:

4.1 Lidhur me verifikimin në terren të ngastrës pyjore 78a(II) u konstatuan këto shkelje:

22 (njëzetedy) drurë të prerë pa damkë.





## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

2 (dy) drurë me damkë të dëmtuar.

Rezulton prerja e 3 (tre) drurëve mbi lartësinë e diametrit.

Çekiç damka është vendosur në krahun e sipërm të trungut ku ka dëmtime në disa drurë.

Pastrimi i parcelës nuk është kryer dhe pse është me kërkesë për zgjatje afati.

5. Referuar Kontratës me nr. prot. 5479, datë 29.07.2013, “Për vjeljen e materialit drusor në këmbë në grup ngastrat pa rrugë pyjore, lidhur ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe subjektit juridik “A.” sh.p.k, me objekt hapjen e rrugës auto pyjore dhe vjeljen e materialit drusor në këmbë të ngastrave pyjore nr. 84a, 85a, 86a, 87a, 88a dhe 89a me dru Ah, të Ekonomisë Pyjore Neshtë - Prevall, në ngastrën 85a(I) me Ah nga kontrolli i datës 22.07.2022, u konstatuan:

5.1 Lidhur me verifikimin në terren të ngastrës pyjore 85a(I) u konstatuan këto shkelje:

4 (katër) drurë të rinj të prerë pa damkë.

Rezulton prerja e 3 (tre) drurëve mbi lartësinë e diametrit.

Çekiç damka është vendosur në krahun e sipërm të trungut ku ka dëmtime në disa drurë.

Nuk është kryer pastrimi i ngastrës.

6. Referuar Kontratës me nr. prot. 3681, datë 25.05.2015, “Për vjeljen e materialit drusor në këmbë në grup ngastrat pa rrugë pyjore, lidhur ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, dhe bashkimit të shoqërive “Al M. Ë. dhe P.” sh.p.k, me objekt vjeljen e materialit drusor në këmbë të ngastrave pyjore nr. 118 dhe nr. 119, të ekonomisë pyjore Dardhë Xhyrë dhe të ngastrave pyjore nr. 75 dhe nr. 76b të ekonomisë pyjore Polis, në kontrollin e ushtruar në datën 25.07.2022 në ngastrën 76b(II) me Ah u konstatuan:

6.1 Lidhur me verifikimin në terren të ngastrës pyjore 76b (II) u konstatuan këto shkelje:

Rezulton prerja e 2 (dy) drurëve mbi lartësinë e diametrit.

Çekiç damka është vendosur në krahun e sipërm të trungut, ku ka dëmtime në disa drurë.

Pastrimi nuk është kryer sipas Aneks-kontratës me nr 3681, datë 17.05.2021.

Në ngastër kishte lëndë drusore, trupa, dru zjarri, si dhe degë të trasha të pa grumbulluara.

Në përfundim është përcjelle e shkresë bashkisë për masa ndaj punonjësve.

**VII.** Nga auditimi I kryer në Bashkinë Korçë, nga grupi I menaxhimit të AKP-së, në përfundimi kontrollit u konstatuan shkeljet dhe janë përcjellë me shkresë zyrtare masat e trajtuara si me poshtë.

-Zgjidhjen nga ana e Bashkisë Korçë, të Kontratës me nr. prot. 252, datë 26.03.2013, “Për vjeljen e materialit drusor në këmbë në grup ngastrat pa rrugë autopyjore”, lidhur ndërmjet Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Korçë, në varësi të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe shoqërisë “A” sh.p.k me objekt shfrytëzimin e materialit drusor në këmbë në 15 ngastra të ekonomisë pyjore “Bofje e Dusharit 1/1”, 1a, 1b, 2a, 2b, 3a, 4a, 4b, 4c, 5a, 6a, 7a, 8a, 9a, 9b, 10b me Ah, me afat 10 vjeçar, deri më 26.03.2023, pasi kjo ekonomi pyjore nuk ka plan mbarështimi të miratuar nga Ministri.

-Zgjidhjen nga ana e Bashkisë Korçë, të Aneks Kontratës nr. 8, me nr. prot. 4834, datë 30.05.2022, “Për shfrytëzimin e lëndës drusore në këmbë, për ngastrat 1b dhe 2b, të ekonomisë pyjore Bofje e Dusharit 1/1”, të lidhur ndërmjet Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave të Bashkisë Korçë dhe shoqërisë “A” sh.p.k.

**Vijimin e procedurave ligjore për vjeljen e vlerës së dëmit të shkaktuar nga ana e shoqërisë “A” sh.p.k, në vlerën 11.966.900 lekë.**

-Fillimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë “A.” Sh.p.k.

-Fillimin e procedimit administrativ për dhënien e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës të Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave të bashkisë Korçë, lidhur me mos përmbushjen e detyrave funksionale e konkretisht, për mos evidentimin e dëmeve dhe mos marrjen e masave ligjore ndaj



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

kontraktorit, bazuar në pikën 11 të nenit 36 të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”, Propozojmë:

-Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra për z. I. K, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit të Pyjeve.

-Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra për z. V. H, me detyrë inspektor/roje i zonës.

**VIII. Nga Auditimi I kryer nga grupi I punës pranë Bashkisë Elbasan, në përfundimet janë konstatuar pa rregulluesi nga grupi I punës dhe janë përcjellës masa bashkisë Elbasan si e poshtë:**

-Zgjidhjen nga ana e Bashkisë Elbasan, të Kontratës së shfrytëzimit të lidhur ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe shoqërisë “Al M. Ë.” sh.p.k, me nr. prot. 5847, datë 20.08.2013, “Për vjeljen e materialit drusor në këmbë në grup ngastrat pa rrugë auto pyjorë” me afat 10 vjeçar, deri më 20.09.2023, pasi ekonomia pyjore “Sh. - 1” nuk ka plan mbarështimi të miratuar.

-Zgjidhjen nga ana e Bashkisë Elbasan, të Kontratës së shfrytëzimit të lidhur ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe bashkimit të shoqërive “O”, 2A dhe R.” sh.p.k me nr. prot. 3680, datë 25.05.2015, “Për vjeljen e materialit drusor në këmbë në grup ngastrat pa rrugë auto pyjorë”, me objekt “Hapjen e rrugës auto pyjorë dhe vjeljen e materialit drusor në këmbë në ngastrat e ekonomisë pyjore “Fushë Kuqe - Zavalinë” me afat 10 vjeçar, deri në datën 18.05.2025, pasi kjo ekonomi pyjore nuk ka plan mbarështimi të miratuar.

-Zgjidhjen nga ana e Bashkisë Elbasan të Aneks Kontratës nr. 8, me nr. prot. 2772, datë 6.06.2022, “Për shfrytëzimin e lëndës drusore në këmbë, në ngastrën 46/b të ekonomisë pyjore “Sh.-1”, lidhur ndërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisit të bashkisë Elbasan dhe shoqërisë “Al M. Ë.” sh.p.k”, lidhur me shkeljen e detyrimeve kontraktore dhe shkeljeve ligjore.

-Vijimin e procedurave ligjore për llogaritjen dhe vjeljen e vlerës së dëmit të shkaktuar nga ana e shoqërisë kontrakturë “Al M. Ë.” sh.p.k.

-Vijimin e procedurave ligjore për llogaritjen dhe vjeljen e vlerës së dëmit të shkaktuar nga ana e shoqërisë kontrakturë “A 2” sh.p.k.

-Vijimin e procedurave nga ana e bashkisë Elbasan për kontrollin e zbatimit të Kontratës Nr. Prot. 4503/5, datë 16.11.2021, “Për shfrytëzimin e lëndës drusore të rrëzuar dhe dëmtuar nga katastrofat natyrore, zjarret në ngastrat pyjore nr. 4b, 5b, 7c dhe 8d të ekonomisë pyjore “Shpat-1” nga shoqëritë kontrakturë “L. - 06” dhe “D.” sh.p.k, ku nga ana e punonjësve përgjegjës të bashkisë Elbasan janë shkelur:

-Neni 11, pika 2/b e ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet” dhe pika 1 e urdhrit nr. 146, datë 11.06.2020, “Për miratimin e mundësisë vjetore të shfrytëzimit për vitin pyjor 2020-2021, për pyjet publike të bashkisë Elbasan”, të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, ku ndërhyrjet duhej të kryheshin mbështetur në planet e mbarështimit, kur ekonomia pyjore “Sh.-1” nuk ka plan mbarështimi të miratuar.

Pika 27 e Kreut VI e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 438, datë 8.06.2016, “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jo pyjore”, ku materiali drusor nuk duhej t’i shitej subjektit.

-Mos lidhjen në vijim nga ana e Bashkisë Elbasan të kontratave të reja për shfrytëzimin e lëndës drusore pa plan mbarështimi të ekonomisë pyjore përkatëse, të miratuar sipas legjislacionit në fuqi.

-Në zbatim të pikës 7, në lidhjen e kontratave të reja që do të lidhen sipas parashikimit në shkronjat a dhe c të pikës 1 të nenit 3 të ligjit nr. 5/2016, “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”, pavarësisht procedurave që ndiqen, domosdoshmërisht duhet të përvëloje dhe të zbatohet detyrimisht në çdo rast pika 27 e Kreut VI, të vendimit të Këshillit të



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

Ministrave nr. 438, datë 8.6.2016, “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jo pyjore”, për ato arsye dhe prioritete të parashikuara në Programin e Qeverisë, referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

“Shitja e materialit drusor të pyjeve publike, me qëllim ngrohjen e popullsisë, bëhet vetëm nga bashkitë, drejtpërsëdrejti te popullata apo enti shtetëror, ndërkohë që transporti i lëndës drusore për ngrohje mund të realizohet nëpërmjet të kontraktuarit të saj, nga vend depozitimi deri në destinacionin e blerësit”.

-Fillimin e procedimit administrativ për dhënien e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës të Drejtorisë së Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisit të bashkisë Elbasan, lidhur me mos përmbushjen e detyrave funksionale e konkretisht:

-Për mos përmbushjen e detyrimeve kontraktore dhe për mos evidentimin e dëmeve dhe mos marrjen e masave ligjore ndaj subjekteve përgjegjëse, bazuar në pikën 11 të nenit 36, të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”;

**-Nga strukturat e AKP Kontrolli dhe monitorimi i subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fondin pyjor.**

**Ushtrimi i përgjegjësive të kontrollit dhe monitorimit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fondin pyjor përbën një nga sfidat më të cilën përballen sot strukturat pyjore bashkiake.**

**Por nga AKP është vërejtur se** në Njësitë e Qeverisjes Vendore strukturat menaxhere dhe inspektuese janë të pa ndara në sektorë më vete. Vetëm bashkitë Korçë, Tiranë, Librazhd dhe Gramsh kanë në struktura të ndara Inspektimin dhe kontrollin e aktiviteteve që kryhen në fondin pyjor.

Të gjitha bashkitë ngrejë problematikën e mungesës së akteve të miratuara nga MTM-ja për procesin e kontroll/inspektimit në pyje. Për pasojë që nga shpërbërja e strukturës së ISHMPUT-së ka munguar kontrolli në fondin pyjor (përsa i takon detyrave dhe përgjegjësive që burojnë nga ligji për pyjet 57/2020 për njësitë e qeverisjes vendore). Edhe në ato bashki ku ushtrohet një kontroll mbi aktivitetin në fondin pyjor, procesi nuk definohet me masa administrative sipas ligjit 57/2020, kjo për mungesë të formateve të akteve të miratuara.

*Janë ngritur në lidhje me aktivitetin e strukturës së pyjeve pranë IKMT-së, aktivitet i kryer jashtë kuadrit ligjor dhe fushës së veprimit dhe pa asnjë lloj koordinimi me strukturat vendore. Si përfundim nga strukturat e AKP janë lenë propozime për Në Njësitë e Qeverisjes Vendore.*

- të ngrihen strukturat inspektuese me minimumin 2 inspektorë të ndarë nga struktura menaxhere.
  - Njësitë e Qeverisjes Vendore duhet të vazhdojnë të ushtrojnë monitorimin e aktivitetit të fondit pyjor duke dokumentuar çdo lloj aktiviteti apo veprimtarie të paligjshme për të patur informacion të plotë mbi aktivitetin në pyje deri në miratimin dhe daljen e formatit të akteve të inspektimit.
  - Të përshpejtohet miratimi i formateve të akteve dhe strukturës së kontroll/inspektimit në AKP si koordinuese e gjithë procesit.
  - Ngritja e grupit të punës të përbashkët me Inspektoratin Qendrorë për përshtatjen e akteve dhe formateve në përputhje me ligjin e Inspektimit nr. 10433/2011 dhe ligjin e pyjeve nr. 57/2020.
- I.** Nga kontrollet e ushtruar nga AKP për kontratat me afat 10-vjecare, për plante e mbarështimit . Planet e mbarështimit si dokumente planifikuese të aktiviteteve që kryhen në sektorin e pyjeve. Plani i mbarështimit është dokumenti bazë për qeverisjen e një ekonomie pyjore, që përmban analizën e gjendjes së pyjeve, përcakton objektivat që duhet të realizohen në funksion të statusit që kanë, si dhe planifikon masat për trajtimin e tyre dhe ndërhyrjet për 10 vitet e ardhshme. Qeverisja teknike e sektorit të pyjeve dhe të kullotave bëhet sipas planeve të mbarështimit.



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

Hartimi i planit të mbarështimit është një detyrim ligjor për pronarët e pyjeve referuar ligjit 57/2020, neni 11.

Nga 385 ekonomi pyjore në gjithë vendin vetëm 76 (20 %) prej tyre janë të pajisura me plane mbarështimi apo plane që janë në proces. Sqarojmë se disa ekonomi janë të ndara mes dy apo më shumë bashkive për shkak të ndarjes së re territoriale, ndaj dhe numri i ekonomive të raportuara për plane mbarështimi rezulton me i lartë 477 (referuar tabelës nr. 6 në aneks).

Për sa më sipër në tabelën në vijim jepen 21 bashkitë që kanë mbuluar 4% - 100% të territorit me plane mbarështimi, pjesa tjetër 40 bashki nuk kanë hartuar asnjë plan mbarështimi të paktën 10 vitet e fundit. Tabela paraqitur ne ankesë.

Përjashtim nga fakti bëjnë bashkitë Berat, Has, Maliq, të cilat pothuajse i kanë mbuluar të gjitha ekonomitë pyjore në territorin e saj me plane mbarështimi ose i kanë në proces përgatitje.

Për planet e mbarështimit të hartuara me mbështetje dhe buxheti të projektit të shërbimeve mjedisore, financuar nga BB konstatojmë se:

- a) Bashkitë Maliq, Berat, dhe Gramsh (ku janë hartuar plane mbarështimi për të gjitha sipërfaqet që u janë transferuar), raportojnë se dokumenti i planit nga ata është dakortësuar, dhe miratuar pranë këshillit bashkiak prej disa muajsh, por procesi nuk është përmbyllur dhe dokumenti ndodhet në MTM.

**Mbulimi i ekonomive pyjore me plane mbarështimi për te 61 bashkitë radhitur sipas madhësisë së sipërfaqes pyjore** Në tabelën Nr.6 në aneks jepet informacion më i detajuar në lidhje me hartimin e PM nga 61 bashkitë.

*Konkluzion;*

***Nga auditimi rezulton se janë kryer veprime ne kundërshtim me ligji 57 të pyjeve pasi 40 bashki nuk kanë hartuar asnjë plan mbarështimi të paktën 10 vitet e fundit.***

***Kjo një detyrë ligjore e përcaktuar qartë në ligj, hartimi i planeve të mbarështimit si një detyrim ligjor në menaxhimin e pyjeve kërkon vëmendje të veçantë.***

*Duke renditur bashkitë nga sipërfaqja e fondit pyjor që kanë në administrim, urgjencë të shkallës së parë për t'u mbështetur financiarisht nga buxheti i shtetit apo donacione për harimin e planeve të mbarështimit evidentojmë bashkitë: Mirditë 71115 ha, Tropojë 59174 ha, Fushë-Arrëz 49305 ha, Kolonjë 48810 ha, Shkodër 48657 ha, Pukë 45775 ha, Bulqizë 43209.64 ha, Himarë 43326 ha, Kukës 41616 ha, Skrapar 37544 ha.*

- *Struktura përkatëse në MTM, nuk kanë ndjekur si dhe as nuk kanë finalizuar procesin e hartimit dhe miratimit të planeve të mbarështimit të financuar nga projekti i shërbimeve mjedisore.*

**Zvarritja e procesit është bërë problem për vazhdimin e punës në bashki.**

- b) Bashkia Korçë ka përfutur hartimin e 6 planeve, por në ndryshim nga rastet e sipërcituara ata e kanë kthyer produktin pasi pretendojnë se planet e mbarështimit kanë probleme të karakterit teknik.
- c) Stafi i specialistëve të bashkisë Malësi e Madhe, e cila gjithashtu ishte pjesë e mbështetjes për bashkitë nga projekti i shërbimeve mjedisore, nuk ka miratuar planet e mbarështimit me pretendimin se nuk janë kryer matje në territorin e saj dhe nuk është zbatuar udhëzuesi në fuqi për hartimin e planit të mbarështimit. Ky qëndrim i është bërë i ditur edhe strukturës përkatëse në MTM si dhe drejtuesve të projektit të shërbimeve mjedisore.

Struktura përkatëse në MTM duhet të ndjekë procesin pasi ajo ka kryer kontrollin sipas procesit në grumbullimin dhe hartimin e dokumentit final të planit të mbarështimit jo vetëm në rastin e bashkisë Korçë, por për të gjitha planet e hartuara me mbështetje dhe financime të projektit të shërbimeve mjedisore.

Shumica e bashkive me buxhetet që disponojnë e kanë të pamundur të financojnë e hartimin e planeve të mbarështimit për të gjithë fondin pyjor që kanë në zotërim.



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

Mungesa e Planeve të Menaxhimit do të pamundësojë aplikimin e bashkive në përfitimin e financimit nga IPARD III dhe në të gjitha projektet dhe mbështetjen që mund të kemi nga donatorë të ndryshëm.

Hartimi i Planeve të Menaxhimit do të mundësonte zgjidhjen e disa prej mangësive të Regjistrimit Kombëtar të Fondit Pyjor dhe Kullosor.

**Krahas kontrolleve tjera nga AKP është kontrolluar edhe mbi grumbullimin dhe përdorimin e të ardhurave të sektorit të pyjeve pranë njësive të vetëqeverisjes vendore (bashkive).**

Mbështetur në legjislationin në fuqi si rrjedhojë e menaxhimit të fondit të pyjeve, fondit të kullotave, fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tariforë etj, organet e NJQV kanë mundësi për të siguruar të ardhura nga;

- Prodhimi i lëndës dhe druve të zjarrit për fshatarësinë dhe për entet publike.
- Të ardhurat nga koncesionet në pyje .
- Të ardhurat e siguruar nga heqja e sipërfaqeve nga fondi pyjor e kullosor që kanë në administrim.
- Dhënia me qira e sipërfaqeve të fondit pyjor e kullosor.
- Shitja e kreditove të karbonit.
- Të ardhurat e siguruar nga grumbullimi i bimëve medicinale tanifere eterovajore
- Të ardhurat e siguruar nga grumbullimi i prodhimeve të dyta pyjore jo drusore
- Aktivitete të tjera

Nga administrimi i informacionit të ardhur në AKP përmes komunikimit zyrtar me 61 bashkitë rezulton se në fondin pyjor dhe kullosor të ardhurat e grumbulluara janë të konsiderueshme:

**Të ardhurat e realizuara për vitin 2019 dhe 2020 janë:**

**551 807 239 lek, pra rreth 550 milionë lekë.**

Vlen të veçojmë/përmendim Bashkitë (tabela mëposhtëm) që kanë realizuar mbi 10 milionë lekë të ardhura ku kryeson listën bashkia Librazhd dhe Skrapar. Bashkitë e tjera kanë realizuar me pak se 10 milionë lekë duke shtuar këtu 6 bashki me të ardhura zero: bashkia Divjakë, Roskovec, Peqin, pustec, Shijak dhe Kamze të cilat menaxhojnë sipërfaqe të vogla të fondit pyjor.

*Mbështetur në nenin 13, pika 3, të Ligjit Nr. 57/2020 datë 30.04.2020 "Për pyjet", të ardhurat nga të gjitha aktivitetet e mundshme në fondin pyjor përdoren 100%, për investime në fondin pyjor/kullosor.*

Strukturat e pyjeve pranë bashkisë në shumicën dërmuese të tyre nuk kanë informacion dhe nuk japin asnjë sqarim se ku ka shkuar fondi i grumbulluar, për një periudhë gati 8 vjeçare, nga të ardhurat nga pyjet dhe kullotat që bashkitë administrojnë.

Në pjesën më të madhe të bashkive rezulton se nuk ka gjetur zbatim investimi i fondit të grumbulluar për hartimin e projekteve për rehabilitimin (*me pyllëzime*) të sipërfaqeve të djegura dhe të degraduara. Vetëm 2 bashki kanë hartuar projekte për pyllëzime si bashkia **Korçë dhe Kukës** që me fondet e grumbulluara kanë realizuar punime të pyllëzimit, kurse bashkitë **Elbasan, Librazhd, Gramsh dhe Maliq**, pyllëzimet i kanë realizuar nga fondet e detyrimeve të subjekteve që kryejnë aktivitetet dhe kanë detyrime kontraktuale.

Ka bashki që gjatë gjithë periudhës 8 vjeçare që administrojnë pyjet nuk kanë shpenzuar asnjë lekë si zë investimesh në fondin pyjor që administrojnë.

Në disa raste të ardhurat e përfituara nga bashkitë nga përdorimi i fondit pyjor janë shpenzuar për zërin paga për punonjës të ndryshëm që kanë afruar në strukturën që menaxhon pyjet, që në gjykimin tonë nuk është investim i drejtpërdrejtë në pyje.



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

Investimet në pyje për vitin 2021 arrijnë vlerën e rreth 19 milionë lekëve ose 17 % e sasië totale të të ardhurave në gjithë bashkitë. Informacioni i ardhur nga bashkitë shpesh ka mangësi mbasi struktura e pyjeve nuk ka informacion dhe për këto të dhëna jemi në përditësim te vazhdueshëm ne komunikimin zyrtar me bashkitë.

Siç paraqitet ne tabelën vijuese, janë 23 bashki me raportim investimesh ku kryeson bashkia Has me rreth 16 milionë lek të investuara në pyje.

Konkluzion:

- Ndaj Bashkive në mos zbatim i Ligjit nr. 57/2020 “Për Pyjet” në lidhje me përdorimin e të ardhurave, duhet të merren masa konfirmo ligjit.
- Të behët raportimi periodik i realizimit të të ardhurave në AKP, shoqëruar me propozime të projekteve për investime në pyje.
- Mendimet dhe mbështetje teknike nga AKP-ja dhe projekte për hartim e zbatim projektesh.

-Nga auditimi rezultoi se në asnjë raste nuk ka një informacion për të përcaktuar në planet e mbarështimit të pyjeve shtetërore dhe privat, si dhe nga materiali drusor që rezulton nga realizimi i përmirësimeve pyjore nëpërmjet investimeve.

Veprime në kundërshtim me urdhrin nr.438, datë 8.6.2016“Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jo pyjore” neni 4.Sasia e shfrytëzimit vjetor, pavarësisht nga nevojat e popullsisë për ngrohje, caktohet brenda mundësisë vjetore të shfrytëzimit, të përcaktuar në planet e mbarështimit të pyjeve shtetërore dhe privat, si dhe nga materiali drusor që rezulton nga realizimi i përmirësimeve pyjore nëpërmjet investimeve.

### **Mangësit;**

-Nga auditimi rezultoi se në vkm nr.570 datë17.7.2019“Për Krijimin organizimin dhe Funkionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, pika 5.4 “Në lidhje me menaxhimin e pyjeve pika ç) harton, zbaton dhe monitoron ndikimet dhe efektshme rinë e planeve të menaxhimit të pyjeve dhe të planeve të mbarështimit” kjo nuk ka funksionuar përgjatë periudhës objekt auditimi pasi hartimin dhe miratimi e planeve të mbarështimit janë përgatitur dhe miratuar nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, si dhe nga Njësite e Qeverisjes Vendore. Rezulton se kontratat e nënshkruara nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit si dhe bashkitë përkatëse, janë që në nënshkrim me shkelje pasi jo të gjitha kontratat kanë planë të menaxhimit, veprimeve shkelja me ligjin e sipërcituar.

-Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Menaxhimit në AKP, ka kryer kontroll sipas ligjit nr .57 të Pyjeve, në katër Bashki nga të cilat në dy Bashkia ka dal në vendim përfundimtarë ku ka përcjellë bashkive gjetje dhe rekomandime, këto veprime nuk janë në përputhjeje me ligjin e sipërcituar.

-Nga auditimi rezultoi se në asnjë raste nuk janë njoftuar strukturat përgjegjëse për rastet e shkeljeve, në fondin pyjore apo të mos plotësimit të kushteve të kontratës, sipas kodit penale, nga strukturat e Agjencia Kombëtare e Pyjeve,

- Për periudhën e audituar, ndonëse ka qenë i miratuar ligji nr. 5/2016 “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”, ky ligj dhe VKM nr.438 datë 08.06.2016 që pasi e lejuan vazhdimësinë e kontratave të subjekteve private për shfrytëzimin e pyjeve me disa kushtëzime si shfrytëzimi i ngastrave të bëhet vetëm me qellim ,shëndetësimin e pyjeve pastrimin e mbeturinave dhe enteve tjera për dru zjarri, kushte këto që nuk janë zbatuar sikurse është konstatuar nga vet kontrollet e kryera nga AKP.

-Agjencia Kombëtare e Pyjeve, nga auitimet e ushtruara në Bashkitë përkatëse ,për subjektet që ushtojnë aktivitet, për përdorimin e sipërfaqeve me lënde drysore, nuk ka dhëne



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

rekomandime sipas përcaktimeve të nenit 38 “Procedimi në fondin pyjor” **pika 6**. Për subjektet e dënuara, struktura përgjegjëse për pyjet, sipas këtij ligji, paraqet kërkesën për heqjen e licencës përkatëse dhe autoritetet përgjegjëse janë të detyruara të marrin vendim për heqjen e licencës brenda pesë ditëve. Subjekti, të cilit i është hequr licenca, nuk mund të pajiset më me të njëjtën licencë për 5 vjetët në vijim.

*-Nga auditimi I kryer në Agjencia Kombëtare e Pyjeve rezulton se, nuk është njoftuar ndërhyr në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pakufizuar në rastet kur vëren pamundësinë ose mos ushtrimin e kompetencave ligjore nga ana e tyre, sipas neni 35 “Institucionet përgjegjëse kontrolluese” pika b) ndërhyr në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pakufizuar në rastet kur vëren pamundësinë ose mos ushtrimin e kompetencave ligjore nga ana e tyre.*

- Nga auditimi I kryer në AKP rezulton, në të shamatat e rasteve nuk ka Hartim të planeve të mbarështimit si një detyrim ligjor, në menaxhimin e pyjeve kërkon vëmendje të veçantë.

Nga 385 ekonomi pyjore në gjithë vendin vetëm 76 (20 %) prej tyre janë të pajisura me plane mbarështimi apo plane që janë në proces. Sqarojmë se disa ekonomi janë të ndara mes dy apo më shumë bashkive për shkak të ndarjes së re territoriale, ndaj dhe numri i ekonomive të raportuara për plane mbarështimi rezulton me i lartë 477.

Në 21 bashkitë që kanë mbuluar 4% - 100% të territorit me plane mbarështimi, pjesa tjetër 40 bashki nuk kanë hartuar asnjë plan mbarështimi të paktën 10 vitet e fundit.

veprime në kundërshtim të ligjit 57/2020, neni 11. Hartimi i planit të mbarështimit është një detyrim ligjor për pronarët e pyjeve .

- Nga auditimi i kryer në Agjencia Kombëtare e Pyjeve rezulton, së të gjitha bashkitë ngrejë problematikën e mungesës së akteve të miratuara nga MTM-ja për procesin e kontroll/inspektimit në pyje. Për pasojë që nga shpërbërja e strukturës së ISHMPUT-së, ka munguar kontrolli në fondin pyjor (përsa i takon detyrave dhe përgjegjësi që burojnë nga ligji për pyjet 57/2020 për njësitë e qeverisjes vendore). Edhe në ato bashki ku ushtrohet kontrolli mbi aktivitetin në fondin pyjor, procesi nuk definohet me masa administrative sipas ligjit 57/2020, kjo për mungesë të formateve të akteve të miratuara.

-Nga auditimi I kryer në AKP, rezulton se janë ngritur struktura paralele në lidhje me aktivitetin e strukturës së pyjeve pranë IKMT-së, aktivitet i kryer jashtë kuadrit ligjor dhe fushës së veprimit dhe pa asnjë lloj kordinimi me strukturat vendore.

- Nga auditimi I kryer në AKP, rezulton se; Strukturat e pyjeve pranë bashkive në të shumtat e rasteve nuk kanë informacion dhe nuk japin asnjë sqarim se përcfarë është përdorur fondi i grumbulluar, për një periudhe gati 8 vjeçare, nga të ardhurat nga pyjet dhe kullotat që bashkitë administrojnë.

Në pjesën më të madhe të bashkive rezulton se nuk ka gjetur zbatim investimi i fondit të grumbulluar për hartimin e projekteve për rehabilitimin (*me pyllëzime*) të sipërfaqeve të djegura dhe të degraduara, veprim në kundërshtim me nenin 13, pika 3, të Ligjit nr. 57/2020 datë 30.04.2020” Për pyjet”, të ardhurat nga të gjitha aktivitetet e mundshme në fondin pyjor përdoren 100%, për investime në fondin pyjor/kullosor, **96,031,896 lekë**.

-Nga kontrollat e këtyre 10 kontratave konstatohet se AKP nuk administron asnjë dokument pasi kontrata nënshkruhen nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, si dhe shtesat e kontratave 1-vjeçare nga Bashkitë përkatëse.

-Për periudhën e audituar, ndonëse ka qenë i miratuar ligji nr. 5/2016 “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”, ky ligj dhe VKM nr.438 datë 08.06.2016 që pasoi e lejuan vazhdimësinë e kontratave të subjekteve private për shfrytëzimin e pyjeve me disa kushtëzime si shfrytëzimi i ngastrave të bëhet vetëm me qellim, shëndetësimin e pyjeve pastrimin e mbeturinave dhe enteve tjera për dru zjarri, kushte këto që nuk janë zbatuar sikurse është konstatuar nga vet kontrollat e kryera nga AKP.



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

**Titulli i gjetjes:** përgjithësi periudhën objekt auditimi nuk është marre mendim për hartimin dhe miratimin e plane të mbarështimit në ekonomitë pyjorë në bashki

**Situata:** Nga auditimi në tërësi rezulton se dhe kontrollet e kryera nga AKP nuk kane im paktin e duhur, pasi nuk kanë asnjë të dhënë për planet e menaxhimit.

**Kriteri;** Nga auditimi rezultoi se ne vkm nr.570 datë 17.7.2019 “Për Krijimin organizimin dhe Funksonimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, pika 5.4 “Në lidhje me menaxhimin e pyjeve pika ç) harton, zbaton dhe monitoron ndikimet dhe efektshme rinë e planeve të menaxhimit të pyjeve dhe të planeve të mbarështimit “kjo nuk ka funksionuar përgjithësi periudhën objekt auditimi pasi hartimin dhe miratimi e plane të mbarështimit janë përgatitur dhe miratuar nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, si dhe nga Njësitet e Qeverisjes Vendore

**Shkaku:** mos pasje kompetencash nga AKP.

**Ndikimi:** nuk ka asnjë informacion mbi planet e menaxhimit në ekonomitë pyjore

**Rëndësia:** e Lartë

**Rekomandimi:** Titullari i AKP –së, të marrë masa në bashkëpunim me Drejtoritë përkatëse pranë Ministrisë së Mjedisit “Në lidhje me menaxhimin e pyjeve pika ç) sipas vkm-së 570570 datë 17.7.2019 “Për Krijimin organizimin dhe Funksonimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”.

**Titulli i gjetjes:** Nga 385 ekonomi pyjore në gjithë vendin vetëm 76 (20 %) prej tyre janë të pajisura me plane mbarështimi apo plane që janë në proces, pra në 40 bashki nuk ka të miratuar plane menaxhimi,

**Situata:** AKP nuk ka tagër për dhënie mendimi për planet e menaxhimit, pasi këto i trajton Ministria e Mjedisit dhe Turizmit.

**Kriteri;** Nuk është zbatuar ligji për pyjet 57/2020 neni 11, hartimi i planit të mbarështimit është një detyrim ligjor për pronarët e pyjeve.

**Shkaku:** mos pasje kompetencash nga AKP.

**Ndikimi:** nuk ka asnjë informacion mbi planet e menaxhimit në ekonomitë pyjore

**Rëndësia:** e Lartë

**Rekomandimi:** AKP strukturat e kontrollit /monitorimit në bashkëpunim me Struktura përkatëse në Ministrinë Mjedisit dhe Turizmit duhet të ndjekë dhe finalizojë procesin e hartimit dhe miratimit të planeve të mbarështimit të financuar nga projekti i shërbimeve mjedisore.

**Titulli i gjetjes:** nga kontrollet kryera në 2 bashki për subjektet që ushtrojnë akvitet, nuk janë lënë rekomandime për heqjen e licencës përkatëse.

**Situata:** AKP, drejtoritë përkatëse nuk kanë lënë rekomandime për heqje licencë në rastet e konstatuar me pa rregulluesi.

**Kriteri;** Ligji për pyjet 57/2020 neni 38 “Procedimi në fondin pyjor”.

**Shkaku;** Institucionet krijuara para 2 vitesh, të pa plotësuar me baze ligjore, si vendime urdhra etj...

**Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, strukturat e kontrollit /monitorimit dhe inspektimit në çdo rast që konstatojnë shkelje të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fundin pyjorë të marrim masa dhe të paraqet kërkesën strukturave përgjegjëse për heqjen e licencës përkatëse.

**Me observacionin nr.1148.datë 15.12.2022,** janë përcjelle nga subjekti shkresa përcjellëse në lidhje me akt-konstatimin nr.4,dhe akt-konstatimin nr. 5 ku subjekti ka shprehur dakortësin për gjetjet dhe rekomandimet e lëna nga grupi i auditimit.





## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

### IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

#### B. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për të 3 vitet 2020, 2021, 2022, referuar ligjeve “*Për buxhetin e vitit 2020, 2021, 2022*”, të ndryshuar, nga ana e këtij institucioni është dwrguar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, kërkesa nr. 49, datë 21.09.2020, ku paraqitet gjendja financiare dhe fakti i mungesës së buxhetit, si rrjedhojë pamundësia e përmbushjes së detyrave të caktuara më aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Për vitin 2021, sipas tabelës së paraqitur rezulton se buxheti i vitit 2021 është realizuar në masën 94 %, pra me mosrealizim, dhe në vlerë absolute me një vlerë prej 3,080,225 lekë diferencë e parealizuar.

Mosrealizimet e rezultuara, tregojnë në mënyrë eksplicite faktin se sa i shkëputur ka qenë procesi i hartimit të planit nga situata dhe nevojat faktike, sidomos për mirëmbajtjen a automjeteve, të pajisjeve të zyrave, deri tek zëri “*Shpenzime për të tjera materiale dhe shërbime*”.

**1.1. Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen, të argumentojë kërkesat për fonde me vërtetësi dhe realizëm, duke shmangur si keqpërdorimin e fondeve në rastin e planifikimit të fryrë, ashtu edhe mosrealizimin e detyrave ligjore operative të institucionit në funksion të ligjit, me qëllim rritjen e performancës në aktivitetin e tij. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 13-23 të Raportit përfundimtarë të Auditimit*).

**Në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për të 3 vitet 2020, 2021, 2022, *nuk ishin hapur ditarët e analitikë dhe pasqyrat financiare të viteve 2020 dhe 2021 ishin përgatitur nga jashtë (extra kontabël)*.

-mungonin dhe nuk kryheshin veprime kontabël në ditarët e bankës, magazinës, të ardhurave dhe shpenzimeve, ditarin e veprimeve të ndryshme, ditari i pagave, dhe të gjithë ditarët e tjerë, analizat, centralizatori / libri i madh, *në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15, dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 28.si dhe llogaritë 214,215 218, në regjistër të aktiveve, veprime në kundërshtim me pikën 30, të Udhëzim-it të Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.11.2011. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet 40-46 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).*

**2.1. Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për hartimin e ditarëve analitikë të bankës, magazinës, të ardhurave dhe shpenzimeve, ditarin e veprimeve të ndryshme, ditari i pagave, dhe të gjithë ditarët e tjerë, centralizatori/libri i madh, etj., si dhe mbi bazën e këtyre të përgatisë pasqyrat financiare të vitit 2022. Të saktësohen vlerat dhe të kryhen ndryshimet e nevojshme, në pasqyrat financiare të vitit 2022. Të përgatiten inventarët dhe analizat sipas posteve të bilancit si dhe të krijohet e të mbahet regjistri i aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv.

***Në pasqyrat financiare 2022 dhe në vijimësi***

**3. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për vitet 2020-2021, në paraqitjen e llogarive të amortizimit në pasqyrat financiare, *nuk paraqiten shumat e amortizimit të akumuluar 219, 681 “Kuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytëzimit” nuk është plotësuar me amortizimin vjetor (Kosto historike minus*



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

*amortizimin e akumuluar), veprim ky moszbatim të me Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 31. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet 40-46 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).*

**3.1. Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa në paraqitjen e llogarive të amortizimit në pasqyrat financiare, të evidentojë shumat e akumuluarat të amortizimit, në llogaritë 209 dhe 219, llogarinë 1013, llogarinë nr. 681 dhe të saktësojë shumat vjetore të amortizimit të AAGJ.

### *Në pasqyrat financiare 2022 dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), lidhur me shënimet shpjeguese (Pasqyra F5) nuk ishin plotësuar me të gjitha ekstremet rubrikat si më poshtë:

*Rubrika 1 Rubrika 2: pasqyrave financiare.*

Sa sipër bie në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 03.09.2019, pika 3.7 “Rregullat për dhënien e shpjegimeve për pasqyrat financiare individuale”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet 27-40 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).

**4.1. Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të plotësuar me të gjitha ekstremet rubrikat 1 dhe 2, në pasqyrat financiare (Pasqyra F5).

### *Në pasqyrat financiare 2022 dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), lidhur me plotësimin e llogarive të aktiveve afatgjatë dhe rakordimin me inventarët kontabël dhe fizikë, kishte plotësuar llogarinë sintetike 215 “Mjete Transporti” për shumën me vlerë të mbetur 9,750,526 lekë e cila nuk përputhet me vlerën e 5 automjeteve deri më datë 31.12.2021, të cilat janë bërë hyrje me vlerë fillestare 19,529,571 lekë dhe **në vlerë neto 6,550,526 lekë.**

Vlera e mësipërme nuk rakordon me vlerën e bilancit për mjetet e transportit prej 9,750,526 lekë me një diferencë më pak prej 3,200,250 lekë.

Theksojmë se inventari bashkëlidhur pasqyrave financiare është paraqitur kontabël por edhe fizik, në një kohë që në inventarin fizik të komisionit të inventarizimit nuk është paraqitur automjeti copë 1 x 3,250,250.

Diferenca ka ardhur për shkak se në inventarin bashkëlidhur pasqyrave financiare, inventar kontabël dhe fizik, është përfshirë edhe vlera e automjetit. Në mungesë të ditarit analitik edhe për vitin 2022, nuk mund të verifikohet kontabilizimi i kryer nga financa. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 46-54. të Raportit përfundimtarë të Auditimit).

**5.1. Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa dhe të bëjë korrigjimin në pasqyrat financiare të vitit 2022, lidhur me llogarinë sintetike 215 “Mjete Transporti”, duke shtuar në këto pasqyra vlerën e automjetit Chevrolet fuori stradë Targë SH 5675 E, copë 1 x 3,250,250= **3,200,250 lekë.**

### *Në pasqyrat financiare 2022 dhe në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), lidhur me veprimet e kryera nëpërmjet bankës, në 4 raste të shërbimeve të kryera automjeteve, nga ana e Sektorit të Financës nuk është aplikuar administrimi i pjesëve të vjetra, **në 1 rast**, Shërbim riparim automjeti, 36,000 lekë pjesëve të këmbimit, të cilat duheshin bërë



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

hyrje në magazinë të veçantë (rikupero). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3,faqet 46-54 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).*

**6.1. Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa dhe të krijojë magazinë rikupero lidhur me administrimin e pjesëve të vjetra të automjeteve në rastet e shërbimeve të kryera dhe trajtimin e mëtejshëm të tyre.

**Në vijimësi**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se titullari i institucionit nuk ka nxjerrë urdhër për krijimin e komisioneve për procesin e vlerësimit të aktiveve dhe procesin e nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi, në kundërshtim me pikën 5, pikën 96, të Udhëzimit-it të Ministrisë së Financave Nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet 46-54 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).*

**7.1 Rekomandimi:** Drejtuesi i Agjencisë Kombëtare të Pyjeve (me propozim të nëpunësit zbatues) të marrë masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për procesin e vlerësimit të aktiveve dhe procesin e nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi.

**Menjëherë**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se blerjet e ndryshme janë dokumentuar me fletëdaljet dhe fletëhyrjet, por nuk janë reregjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin analitik të magazinës, -fletëhyrjen ku janë pasqyruar aktivet e transferuara nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, nuk përmban shënimin "*vlera në ruajtje*", në kundërshtim me pikën 49, të Udhëzimit-it Nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", si dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", neni 3 dhe Udhëzimit Nr.8, datë 9.3.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore, në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*", pika 28, -Gjithashtu lidhur me fletë –daljet e magazinës nuk janë prerë në bazë të urdhër-dorëzimeve të lëshuara nga urdhëruesi,UMF pika 38. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet 46-54 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).*

**8.1.Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa që të gjitha veprimet dhe faktet ekonomike të kryera nga njësia ti regjistrojë në mënyrë kronologjike në ditarin analitik të magazinës, si dhe daljet nga magazina, ti kryejë në bazë të urdhërdorëzimeve, fletë kërkesave të firmosur nga titullari i institucionit , planit të shpërndarjes të kartelës limit. Aktivet e marra në ruajtje të dokumentohen menjëherë me fletëhyrjen që përmban shënimin "*vlera në ruajtje*". Të bëhet korigjimi i fletë hyrjeve.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**9. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve nga auditimi rezultoi së është jashtë sistemit të inspektimit, kryesisht për shkak se nuk janë unifikuar me Inspektoratin Qendror praktikat e kontrollit dhe inspektimit në fondin pyjor kombëtar nga strukturat përgjegjëse në ushtrimin e kompetencave të tyre, sipas nenit 40 të ligjit nr.57/2020 për Pyjet. Për pasojë, kjo Agjenci për periudhën 2020-2022, ka qenë në pamundësi, si juridikisht ashtu edhe nga logjistike (mungojnë procesverbale të konstatimit të dëmeve etj.) për të ushtruar veprimtari të mirëfilltë inspektuese. Paqartësia vet brenda ligjit si dhe mungesa e harmonizimit me ligje të tjera, ka bërë që funksionin e inspektimit të pyjeve ta realizojë Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, institucion ky nuk njihet si institucion monitorues inspektues sipas ligjit nr.57/2020. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet 54-63 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).*



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

**9.1.Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit si dhe me Inspektoratin Qendror, të marrë masa për unifikimin e praktikave të kontrollit dhe procesit të inspektimit në fondin pyjor.

### Menjëherë dhe në vazhdimësi

**10. Gjetje nga auditimi:** Aktet nënligjore plotësuese në zbatim të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet” ende nuk janë miratuar, konkretisht mungojnë rreth 18 VKM dhe udhëzime, ndër të tjera, si më poshtë:

Në zbatim të nenit 4 pika 2 duhej të ishte miratuar udhëzimi për klasifikimin e pyjeve.

Në zbatim të nenit 5, pika 4, nuk është miratuar VKM për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre

c. Në zbatim të nenit 38 pika 8, nuk është miratuar udhëzimi me procedura dhe vendimmarrja për dënimin dhe masat përkatëse, ankimi dhe ekzekutimi rregullohen nga legjislacioni në fuqi për kundërvajtjet administrative dhe inspektimin. Përmbajtja dhe modelet e akteve për kundërvajtjet në pyje miratohen me urdhër të ministrit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 54-63 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).*

**10.1.Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për identifikimin e të gjitha akteve nënligjore që nuk janë miratuar dhe miratimin e tyre.

### Menjëherë dhe në vazhdimësi

**11. Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me procesin inventarizimit të fondit pyjor konstatohet se inventari i fundit i përket vitit 2018 e për rrjedhojë rezulton se nuk ka nisur cikli i radhës 8 vjeçar i riinventarizimit kombëtar të pyjeve, duke inventarizuar 25% çdo 2 vjet të fondit pyjor, në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet. Nga krahasimi i inventarëve 2003-2018, nga vëllimi total drunor, është hequr për 15 vjet një vëllim prej 32.9 mln m<sup>3</sup> (përfshi materialin drusor të djegur nga zjarret në pyll), pra 2.2 mln/m<sup>3</sup>/vit, ose dyfishin e mundësisë vjetore të shfrytëzimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet 54-63, të Raportit përfundimtarë të Auditimit).*

**11.1.Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa që të nisë procesin e inventarizimit të fondit pyjor, duke parashikuar në buxhetin e vitit 2023 të gjitha kostot e mundshme, përfshirë ngritjen e agjencive rajonale të pyjeve, për përfundimin e procesit.

### Menjëherë dhe në vazhdimësi

**12. Gjetje nga auditimi:** Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor (RKFP) nuk është i plotë, pasi në këtë fond pyjor nuk janë të pasqyruara ato sipërfaqe pyjorë të cilat i kanë kaluar në pronësi Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet VKM-së Nr. 707, datë 21.11.2018 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Shkodër-Fier”. Sipas nenit 2 të ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”, ligji i shtrin efektet për çdo sipërfaqe pyjore pavarësisht pronësisë, për sa kohë plotësohet kushti i përkufizimit të “pyllit”, pavarësisht administrimit qoftë privat apo publik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 54-63 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).*

**12.1.Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa për përditësimin e regjistrit kombëtar të fondit pyjor me sipërfaqet që i kanë kaluar në administrim Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

### Menjëherë dhe në vazhdimësi



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

**13.Gjetje nga auditimi:** Me vendimet e Komitetit të Investimeve Strategjike lihen detyra për heqjen nga fondi pyjor para marrjes në përdorim të sipërfaqes përkatëse apo ngarkimin e AKP-së me saktësimin e koordinatave apo verifikime të pronës. Po ashtu, kërkohet çregjistrimi nga kadastra dhe fondi pyjor, shoqëruar me detyrimin e subjektit përfitues që të paguajë vlerat përkatëse të pakësimit të volumit të lëndës drusore, të sipërfaqes që do të hiqet nga fondi pyjor si dhe pyllëzimin e një sipërfaqeje tjetër. Për këto detyra, rezulton se Agjencia Kombëtare e Pyjeve gjendet e përjashtuar nga këto procese, së pari ende nuk administron në mënyrë të plotë fondin pyjor, së dyti rezulton e përjashtuar nga proceset e kadastrës pyjore, sa i përket çregjistrimit, heqjes nga fondi pyjor dhe zëvendësimit, pasi kjo agjenci nuk harton/miraton asnjë akt administrativ mbi këto çështje dhe nuk informohet nga MTM mbi vendimet e Këshillit të Ministrave për heqjen nga fondi pyjor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 54-63 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).*

**13.1.Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa që procedurat për heqjen nga regjistri i fondi pyjor të sipërfaqeve që preken nga investimet strategjike, t'i nisë vetëm pas administrimit të projekteve për zëvendësimit e këtyre sipërfaqeve dhe marrjes së konfirmimit nga MTM për nxjerrjen e akteve(VKM apo Ligji) për heqjen nga fondi pyjor.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**14.Gjetje nga auditimi:** Procesi i dixhitalizimi të fondit pyjor në sistemin ALFIS është i paplotë, pasi rezulton se është pasqyruar pjesërisht vetëm fondi pyjor nën administrimin e bashkive dhe jo sipërfaqet pyjore të ministrive dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Sipërfaqja totale kombëtare e dixhitalizuar është 1.213.427,83 ha, (për 61 bashkitë). Në veçanti, sipërfaqet pyjore që preken nga investimet strategjike nuk janë të pasqyruara në ALFIS. Nga kontrolli i VKM-ve të miratuara sipas “Listave të transferimit të ngastrave pyjore kullimore në pronësi të bashkisë” për periudhën 2020-2021, rezulton me mospërputhje të konsiderueshme në zërat kadastral si “Kategoria e Përdorimit të Territorit”, “Pronësia”, “Sipërfaqja” etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 54-63 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).*

**14.1.Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në bashkëpunim me AKSHI-n, të marrë masa për ngritjen e një grupi ekspertësh të fushës së pyjeve, specialistë IT dhe programues për analizimin e popullimit të të dhënave të hasura me probleme dhe plotësimin e sistemit ALFIS me sipërfaqet që janë nën administrim të Agjencisë së Zonave të Mbrojtura dhe Ministrive.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**15.Gjetje nga auditimi:** Problematikë kryesore në sektorin e inventarizimit vitin 2021 ka qenë mungesa e të dhënave mbi VKM-të e hartuara ndër vite për sipërfaqet e hequra nga fondi pyjor/kullor si dhe sipërfaqet pyjore kullimore pronë private. Në evidencat e tregueseve kadastral që përcaktojnë fondin pyjor/kullor të bashkive, nuk janë hedhur të dhënat kadastrale të konfirmuara nga planet e reja të mbarështimi të 3-4 viteve të fundit. Konkretisht problematike janë bashkitë, Berat, Maliq, Malësi e Madhe, Has, të cilat janë realizuar me program pilot. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 54-63 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).*

**15.1.Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, të marrë masa që të krijojë një nën regjistër të veçantë për sipërfaqet e hequra ndër vite nga fondi pyjor si dhe të informojë bashkitë për përditësimin e të dhënave kadastrale sipas planeve të mbarështimit.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se në Agjencia Kombëtare të Pyjeve, nuk ka gjete zbatimi Vkm-ja nr.570 datë 17.7.2019 “Për Krijimin organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, pika 5.4 “Në lidhje me menaxhimin e pyjeve pika ç) harton, zbaton dhe monitoron ndikimet dhe efektshme rinë e planeve të menaxhimit të pyjeve dhe të planeve të mbarështimit” nuk ka funksionuar në çdo raste pasi hartimin dhe miratimi e planeve të mbarështimit janë përgatitur dhe miratuar nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, si dhe nga Njësiti e Qeverisjes Vendore .

-Nga 385 ekonomi pyjore në gjithë vendin vetëm (20 %) prej tyre janë të pajisura me plane mbarështimi apo plane që janë në proces.

-Në 21 bashkitë që kanë mbuluar 4% - 100% të territorit me plane mbarështimi, pjesa tjetër prej 40 bashkish nuk kanë hartuar asnjë plan mbarështimi të paktën 10 vitet e fundit, veprime në kundërshtim të ligjit 57/2020, neni 11. Hartimi i planit të mbarështimit është një detyrim ligjor për pronarët e pyjeve(*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 63-81 të Raportit përfundimtarë të Auditimit*).

**16.1.Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe drejtoritë përkatëse të marrin masa që në çdo rast planet e menaxhimit të përcillen para në Agjencisë Kombëtare të Pyjeve për dhënie mendimi, deri në finalizimet procesit të hartimit dhe miratimit të planeve të mbarështimit.

### Menjëherë dhe në vazhdimësi

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Menaxhimit në AKP, ka kryer kontrolle sipas ligjit nr. 57 të Pyjeve, në katër Bashki nga të cilat në dy Bashkia ka dal në vendim përfundimtarë ku ka përcjellë bashkive gjetje dhe rekomandime, këto veprime nuk janë në përputhjeje me ligjin e sipërcituar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 63-81 të Raportit përfundimtarë të Auditimit*).

**17.1.Rekomandim:** Drejtoria e Menaxhimit pranë Agjencia Kombëtare e Pyjeve, të marre masa për të hartuar metodologji, manual apo urdhër të Drejtorit, në përputhje me kontrollet e kryera për daljen në përfundim për gjetje dhe rekomandime.

### Menjëherë

**18. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, nga auditimet e ushtruara në Bashkitë përkatëse, për subjektet që ushtojnë aktivitetet, për përdorimin e sipërfaqeve me lënde drusore, nuk ka dhëne rekomandime sipas përcaktimeve të nenit 38 “Procedimi në fondin pyjor” pika 6. Për subjektet e dënuara, struktura përgjegjëse për pyjet, sipas këtij ligji, paraqet kërkesën për heqjen e licencës përkatëse dhe autoritetet përgjegjëse janë të detyruara të marrin vendim për heqjen e licencës brenda pesë ditëve. Subjekti, të cilit i është hequr licenca, nuk mund të pajiset më me të njëjtën licencë për 5 vjetët në vijim. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 63-81 të Raportit përfundimtarë të Auditimit*).

**18.1.Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, strukturat e kontrollit /monitorimit, në çdo rast që konstatojnë shkelje të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fondin pyje të marrin masa për heqjen e licencës përkatëse.

### Menjëherë dhe në vazhdimësi

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer në Agjencia Kombëtare e Pyjeve rezulton se; Strukturat e pyjeve pranë bashkive në të shumtat e rasteve nuk kanë informacion dhe nuk japin



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

asnjë sqarim se për çfarë është përdorur fondi i grumbulluar, për një periudhë gati 8 vjeçare, nga të ardhurat nga pyjet dhe kullotat që bashkitë administrojnë, në vlerën prej **96,031,896** lekë. Në pjesën më të madhe të bashkive rezulton se nuk ka gjetur zbatim investimi i fondit të grumbulluar për hartimin e projekteve për rehabilitimin (*me pyllëzime*) të sipërfaqeve të djegura dhe të degraduara, veprim në kundërshtim me nenin 13, pika 3, të Ligjit nr. 57/2020 datë 30.04.2020 “Për pyjet”, të ardhurat nga të gjitha aktivitetet e mundshme në fondin pyjor përdoren 100%, për investime në fondin pyjor/kullozor. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet 63-81 të Raportit përfundimtarë të Auditimit*).

**19.1.Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe strukturat e Bashkive të marrin masa, që të ardhurat e krijuara nga fondi pyjor të përdoren për investime në vitin e ardhshëm.

### Menjëherë dhe në vazhdimësi

**20. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën e audituar, ndonëse ka qenë i miratuar ligji nr. 5/2016 “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”, ky ligj dhe VKM nr.438 datë 08.06.2016 që pasoi e lejuan vazhdimësinë e kontratave të subjekteve private për shfrytëzimin e pyjeve me disa kushtëzime si shfrytëzimi i ngastrave të bëhet vetëm me qellim, shëndetësimin e pyjeve pastrimin e mbeturinave dhe enteve tjera për dru zjarri, kushte këto që nuk janë zbatuar sikurse është konstatuar nga vet kontrollet e kryera nga AKP. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet 63-81 të Raportit përfundimtarë të Auditimit*).

**20.1.Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marri masa për kryerjen e vlerësimit të moratoriumit në pyje, përfshirë dhe kontratat e subjekteve private me një afat 10–vjeçar.

### Menjëherë dhe në vazhdimësi

**21.Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit u konstatua se, për nëpunësit e Agjencia Kombëtare e Pyjeve, zbatohen procedurat e legjislacionit për nëpunësin civil parashikuar për institucionet e administratës shtetërore. Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të personelit rezultoi se, ato administrohen të inventarizuara në zbatim VKM nr.117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet 23-27 të Raportit përfundimtarë të Auditimit*).

**21.1. Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Sektori Personelit) të sistemojë dhe kompletojë dosjet e punonjësve me dokumentacionin përkatës si dhe të kryhet rekrutimi i punonjësve për plotësimin e vendeve të punës.

### Në vazhdimësi

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1.Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), në 4 raste, për shumën **44,419** lekë, sipas urdhër shpenzimeve nr. 19, datë 04.03.2021, nr. 17, datë 25.02.2021, nr. 45, datë 15.04.2022, nr. 27, datë 02.03.2022, ka likuiduar DRSHTRR Tiranë për pagesa gjobash për vonesa, brenda vlerës së përgjithshme, sipas dokumenteve për taksa makine, *gjoba për te cilat duhej të nxirrej përgjegjësia dhe të paguheshin prej personave përgjegjës*, për rrjedhojë nuk duhej të paguhej **shuma prej 44,419** lekë nga AKP.

-Sa sipër bie në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 46-54 të Raportit përfundimtarë të Auditimit*).



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

**1.1. Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të përcaktojë përgjegjësitë lidhur me gjobat e paguara sipas urdhër shpenzimeve nr. 19, datë 04.03.2021, nr. 17, datë 25.02.2021, nr. 45, datë 15.04.2022, nr. 27, datë 02.03.2022 dhe më pas të ndjekë gjithë rrugët ligjore për arkëtimin e shumës **44,419 lekë** sipas dokumenteve për taksa makine, prej përfituesit në të kundërt shuma të zhdëmtohet nga personat përgjegjës.

Brenda muajit Mars 2023

### **B.1. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1.Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në 22 raste për shumën e përgjithshme **13,625,229 lekë**, si rezultat i dhënies së masave ekstreme disiplinore “Largim nga Shërbimi Civil” si dhe zgjidhjes së kundërligjshme të kontratave të punonjësve të pabazuara në ligj dhe në Kodin e Punës, kanë sjellë kundërpërgjigje nga punonjësit e institucionit të cilët kanë bërë padi në gjykatë ku kanë fituar të drejtën e tyre në shkallën e parë ose edhe në shkallën e dytë të gjykimit dhe për pasojë nga shteti janë shpenzuar **13,625,229 lekë**, ku përfshihet edhe pagesa e përmbaruesve gjyqësorë për kompensimin e punonjësve të larguar padrejtësisht, duke shkaktuar efekte ekonomike negative në administrimin e fondeve publike, me pagesën e 2 personave për të njëjtin vend pune.

Sa sipër është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës I Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjin për Shërbimin Civil në RSH.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 54-63 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).*

**1.1.Rekomandim:** Drejtori i Agjencisë Kombëtare e Pyjeve, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa në të ardhmen për eliminimin e rasteve, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me efekt negativ për likuidimin e vendimeve gjyqësore, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për shërbimin civil “krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike” si dhe Kodit të Punës.

Në vijimësi

## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT





## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

### ANEKSE

#### Tabela nr.1

#### Grupi I- Aktivet Afat shkurtra:

#### *Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje Inventari qarkullues”*

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2020	Viti 2019	Diferenca 2020-2019
2	<i>Gjendje Inventari qarkullues</i>	1,088,767	-	1,088,767
31	Materiale	531,494	-	531,494
32	Inventari Imët	557,273	-	557,273
34	Produkte	-	-	-
35	Mallra	-	-	-
36	Kafshe ne rritje e majmëri	-	-	-
37	Gjendje te pa mbritura,ose pranë te tretëve	-	-	-
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	-	-	-
39	Provizione per zhvlersimin e inventarit (-)	-	-	-
	<b>Totali</b>	<b>1,088,767</b>	<b>-</b>	<b>1,088,767</b>

#### Tabela nr.2

#### *Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të Arkëtueshme”*

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2020	Viti 2019	Diferenca 2020-2019
3	<i>Llogari të arkëtueshme</i>	2,276,853	-	2,276,853
411	Klientë e llogari te ngjashme	-	-	-
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	-	-	-
431	Tatim e Taksa	-	-	-
432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal	-	-	-
433	Fatkeqësi natyrore qe mbulohen nga shteti	-	-	-
435	Sigurime Shoqërore	-	-	-
436	Sigurime Shëndetësorë	-	-	-
437,438,	Organizma te tjere shteterore	-	-	-
44	Institucione te tjera publike	-	-	-
465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere	-	-	-
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	-	-	-
468	Debitore te ndryshem KLSH	-	-	-
4342	Operacione me shtetin(të drejta)	1,936,975	-	1,936,975
45	Mardh. midis institucioneve apo njesive ekonomike	339,878	-	339,878
49	Shuma të parashikuara per xhvleresim(-)	-	-	-
4	<i>Të tjera aktive afatshkurtra</i>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

#### Tabela nr. 3

Llogaritë kontabël	Emertimi i llogarive	Viti 2020	Viti 2019	Diferenca 2020-2019
21	<i>2-Aktive Afatgjata materiale</i>	16,736,421	-	16,736,421
210	Toka, Troje, Terene	0	-	0
211	Pyje, Plantacione	-	-	-
212	Ndertesat e Konstruksione	-	-	-
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	-	-	-
214	Instalime teknike, makineri e paisje	10,653,172	-	10,653,172
215	Mjete Transporti	3,265,084	-	3,265,084
218	Inventar Ekonomik	2,818,165	-	2,818,165

#### Tabela nr. 4

#### *Pasqyra e amortizimit vitit 2020, AAGJ/JO M dhe AAGJM, (Nxjerrë nga formati 7/b)*

Nr. Llog.	Emërtimi	Gjendja amortizimit viti 2019	Shtesa amortizimit viti 2020	Pakësim amortizimit viti 2020	Gjendja në fund të vitit 2020
	AAGJ/MATERIALE	-	20,792,061	-	20,792,061
214	Instalime,makineri,pajisje	-	3,627,008	-	3,627,008



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

215	Mjete transporti	-	11,806,137	-	11,806,137
218	Inventar Ekonomik	-	5,358,916	-	5,358,916
	<b>TOTALI</b>	-	<b>20,792,061</b>	-	<b>20,792,061</b>

Tabela nr. 5

### Pasqyra e Aseteve llog. 214, 215, 218

Nr. Llog.	Emërtimi	Gjendja me datë 31.12.2019	Shtesë transf.kap. viti 2020	Pakësime të tjera viti 2020	Gjendja në fund me datë 31.12. 2020
214	Instalime, Makineri, pajisje	-	14,280,180	-	10,653,172
215	Mjete transporti	-	15,071,221	-	3,265,084
218	Inventar Ekonomik	-	8,177,080	-	2,818,165
	<b>TOTALI</b>	-	<b>37,528,482</b>	-	<b>16,736,421</b>

### Pasqyra e ndryshimeve klasa 3-Materiale dhe objekte inventari

Nr. Llog.	Emërtimi	Gjendja me datë 31.12.2019	Shtesa Mat. konsumi viti 2020	Pakësim Konsumi viti 2020	Gjendja në fund të vitit 2020
31	Materiale	-	531,494	-	531,494
32	Inventar i Imët	-	557,273	-	557,273
	<b>TOTALI</b>	-	<b>1,088,767</b>	-	<b>1,088,767</b>

Tabela nr. 6

### Llogaritë e klasës 4

Llogaritë	Viti 2020	Viti 2019	Dif /ndryshimi
<b>I.Pasivet Afat shkurtra</b>	<b>2,276,853</b>	-	
<b>I.Llogari të Pagueshme</b>	<b>2,276,853</b>	-	
401-408 Furnitorë e llogari të lidhura me to	-	-	
42 Detyrime ndaj personelit	1,505,502	-	
16,17,18 Hua Afat shkurtra	339,878	-	
460 Huadhënës	-	-	
431 Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	126,071	-	
432 Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal	-	-	
433 Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore	-	-	
435 Sigurime Shoqërore	248,969	-	
436 Sigurime Shëndetësorë	56,433	-	
437,438, Organizma te tjerë shtetërore	-	-	
44 Institucione te tjera publike	-	-	
45 Marrëdhënie midis institucioneve apo njërive ekonomike	-	-	
464 Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere	-	-	
466 Kreditore për mjete ne ruajtje	-	-	
467 Kreditore te ndryshëm	-	-	
4341 Operacione me shtetin( detyrime	-	-	
49 Shuma te parashikuara per zhvlerësim(-)	-	-	

Tabela 7

Nr.	PËRMBAJTJA	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhëse
<b>I</b>	<b>VEPRIMTARITË E SHFRYTËZIMIT</b>	<b>2,757,450</b>	-
<b>1</b>	<b>Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime korente(+)</b>	<b>8,810,000</b>	-
	<b>Arkëtime e të hyra(Cash), gjatë vitit ushtrimor</b>	<b>0</b>	-
	Të hyra, Sponnsorizime nga të tretë (+)	0	-
<b>3.</b>	<b>Pagesa për Detyrime e Shpenzime korente</b>	<b>-6,052,550</b>	-
	Për detyrime e shpenzime nga viti i kaluar(-)		-
	Për detyrime e shpenzime te viti ushtrimor(-)	<b>-6,052,550</b>	-
<b>II</b>	<b>VEPRIMTARITË E INVESTIMEVE</b>	-	-
	Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime kapitale(+)	-	-
	Për detyrime e Investime te viti ishtrimor(-)	-	-



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

	Dividentë të paguar(-) <b>5% garanci punimi</b>	-	-
<b>III</b>	<b>TRANSFERTA E TË TJERA</b>	<b>-2,757,450</b>	<b>-</b>
	Transferime në buxhet të Fondeve të pa përdorura(-)	-2,757,450	-
<b>IV</b>	<b>Rritja/Rënia neto e Mjeteve monetare</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>V</b>	<b>Teprica në fillim të vitit ushtrimor</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>VI</b>	<b>Teprica e Likuiditeve në fund të vitit ushtrimor</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

Tabela nr. 8

### Grupi I- Aktivët Afat shkurtër:

#### Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje Inventari qarkullues”

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti 2020	Diferenca 2021-2020
2	Gjendje Inventari qarkullues	2,140,690	1,088,767	1,051,923
31	Materiale	1,583,417	531,494	1,051,923
32	Inventari Imët	557,273	557,273	-
34	Produkte		-	
35	Mallra		-	
36	Kafshe ne rritje e majmëri		-	
37	Gjendje te pa mbritura,ose pranë te tretëve		-	
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit		-	
39	Provizione per zhvlersimin e inventarit (-)		-	
	<b>Totali</b>	<b>2,140,690</b>	<b>1,088,767</b>	<b>1,051,923</b>

Tabela nr. 9

#### Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të Arkëtueshme”

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti 2020	Diferenca 2021-2020
3	Llogari të arkëtueshme	2,729,742	2,276,853	452,889
411	Klientë e llogari te ngjashme		-	
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba		-	
431	Tatim e Taksa		-	
432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		-	
433	Fatkeqësi natyrore qe mbulohen nga shteti		-	
435	Sigurime Shoqërore		-	
436	Sigurime Shëndetësorë		-	
437,438,	Organizma te tjerë shtetërore		-	
44	Institucione te tjera publike		-	
465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		-	
466	Kreditorë për mjete në ruajtje		-	
468	Debitorë te ndryshem KLSH		-	
4342	Operacione me shtetin(të drejta)	2,389,864	1,936,975	452,889
45	Mardh. midis institucioneve apo njesive ekonomike	339,878	339,878	-
49	Shuma të parashikuara per zhvlresim(-)		-	
4	<b>Të tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	

Tabela nr. 10

Llogaritë kontabël	Emertimi i llogarive	Viti 2021	Viti 2020	Diferenca 2021-2020
21	<b>2-Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>28,964,695</b>	<b>16,736,421</b>	<b>12,228,274</b>
210	Toka, Troje, Terene		0	
211	Pyje, Plantacione		-	
212	Ndertesë e Konstruksione		-	
213	Rruge, rrjete, vepra ujore		-	
214	Instalime teknike, makineri e paisje	7,989,879	10,653,172	-2,663,293
215	Mjete Transporti	9,750,526	3,265,084	6,485,442
218	Inventar Ekonomik	11,224,289	2,818,165	8,406,124

Tabela 11



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

Nr. Llog.	Emërtimi	Gjendja amortizimit viti 2020	Shtesa amortizimit viti 2021	Pakësim amortizimit viti 2021	Gjendja në fund të vitit 2021
	<b>AAGJ/MATERIALE</b>	<b>20,792,061</b>	<b>5,114,293</b>	-	<b>25,906,354</b>
214	Instalime, makineri, pajisje	3,627,008	2,663,293	-	6,290,301
215	Mjete transporti	11,806,137	1,173,158	-	12,979,295
218	Inventar Ekonomik	5,358,916	1,277,843	-	6,636,758
	<b>T O T A L I</b>	<b>20,792,061</b>	<b>5,114,293</b>	-	<b>25,906,354</b>

### Pasqyra e Aseteve llog. 214, 215, 218

Nr. Llog.	Emërtimi	Gjendja me datë 31.12.2020	Shtesë transf.kap. viti 2021	Pakësime të tjera viti 2021	Gjendja në fund me datë 31.12. 2021
214	Instalime, Makineri, pajisje	14,280,180	-	-	14,280,180
215	Mjete transporti	15,071,221	7,658,600	-	22,729,821
218	Inventar Ekonomik	8,177,080	9,683,967	-	17,861,047
	<b>T O T A L I</b>	<b>37,528,482</b>	<b>17,342,567</b>	-	<b>54,871,049</b>

### Pasqyra e ndryshimeve klasa 3-Materiale dhe objekte inventari

Nr. Llog.	Emërtimi	Gjendja me datë 31.12.2019	Shtesa Mat. konsumi viti 2020	Pakësim Konsumi viti 2020	Gjendja në fund të vitit 2020
31	Materiale	531,494	1,051,823	-	1,583,417
32	Inventar i Imët	557,273	-	-	557,273
	<b>T O T A L I</b>	<b>1,088,767</b>	<b>557,273</b>	-	<b>2,140,690</b>

Tabela 12.

Llogaritë	Viti 2021	Viti 2020	Dif /ndryshimi
<b>I.Pasivet Afat shkurtra</b>	<b>2,729,742</b>	<b>2,276,853</b>	
<b>1.Llogari të Pagueshme</b>	<b>2,729,742</b>	<b>2,276,853</b>	
401-408 Furnitorë e llogari të lidhura me to	-	-	
42 Detyrime ndaj personelit	1,870,426	1,505,502	
16,17,18 Hua Afat shkurtra	339,878	339,878	
431 Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	136,997	126,071	
432 Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		-	
433 Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore		-	
435 Sigurime Shoqërore	311,771	248,969	
436 Sigurime Shëndetësorë	70,670	56,433	
437,438, Organizma te tjerë shtetërore		-	
44 Institucione te tjera publike		-	
45 Marrëdhënie midis institucioneve apo njësisve ekonomike		-	
464 Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		-	
466 Kreditore për mjete ne ruajtje		-	
467 Kreditore te ndryshëm		-	
4341 Operacione me shtetin( detyrime		-	
49 Shuma te parashikuara per zhvlerësime(-)		-	

Tabela nr. 13

Llog.	Viti 2021	Viti 2020	Diferenca/ndryshimi
<b>D Fondi i Konsoliduar</b>	<b>31,105,385</b>	<b>17,825,188</b>	<b>13,280,197</b>
101 Teprica(Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar	28,116,487	22,788,961	5,327,526
12 Rezultatet e mbartura		-	



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	2,988,898	-4,963,773	7,952,671
111	Rezerva	-	-	-
115	Nga Fondet e veta të investimeve	-	-	-
15	Shuma të parashikuara për rreziqe e zhvlerësime	-	-	-
105	Teprica e grandeve Kapitale të Brendshme	-	-	-
106	Teprica e grandeve Kapitale të Huaja	-	-	-
107	Vlera e mjeteve të caktuara në përdorim	-	-	-
109	Rezerva nga Rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata	-	-	-
	Të Tjera	-	-	-
<b>E</b>	<b>TOTALI I PASIVEVE (B+C)</b>	<b>33,835,127</b>	<b>20,102,041</b>	<b>13,733,086</b>

Tabela 14

Llog.		Viti 2021	Viti 2020	Diferenca/ndryshimi
72	<b>V- Grante Korente</b>	<b>47,759,636</b>	<b>1,936,975</b>	<b>45,822,661</b>
720	<b>I.Grant korent I Brendshëm</b>	<b>47,759,636</b>	<b>1,936,975</b>	<b>45,822,661</b>
7200	Nga Buxheti për NJQP(Qëndrore)	45,369,775	-	45,822,661
7201	Nga Buxheti për NJQP(Vendore)		-	
7202	Nga Buxh.për pagesa të posaçme ISSH		-	
7203	Nga Buxh. mbulim defic.(ISSH-ISKSH)		-	
7204	Pjesëmarrje e instit. në tatime nacionale		-	
7205	Financ.shtese për të ardh. e krijuara brenda sistemit		-	
<b>7206</b>	<b>Financim i pritur nga buxheti</b>	<b>2,389,864</b>	<b>1,936,975</b>	<b>452,889</b>
7207	Sponsorizime te brendshme( nga te trete)		-	

Tabela 15.

Nr.	PËRMBAJTJA	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhëse
<b>I</b>	<b>VEPRIMTARITË E SHFRYTËZIMIT</b>	<b>3,089,225</b>	<b>2,757,450</b>
<b>1</b>	<b>Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime korente(+)</b>	48,450,000	8,810,000
	<b>Arkëtime e të hyra(Cash), gjatë vitit ushtritor</b>		<b>0</b>
	Të hyra, Sponsorizime nga të tretë (+)		0
<b>3.</b>	<b>Pagesa për Detyrime e Shpenzime korente</b>	<b>-45,369,775</b>	<b>-6,052,550</b>
	Për detyrime e shpenzime nga viti i kaluar(-)		
	Për detyrime e shpenzime te viti ushtritor(-)	-45,369,775	<b>-6,052,550</b>
<b>II</b>	<b>VEPRIMTARITË E INVESTIMEVE</b>		-
	Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime kapitale(+)		-
	Për detyrime e Investime te viti ishtritor(-)		-
	Dividentë të paguar(-) <b>5% garanci punimi</b>		-
<b>III</b>	<b>TRANSFERTA E TË TJERA</b>	<b>3,080,225</b>	<b>-2,757,450</b>
	Transferime në buxhet të Fondeve të pa përdorura(-)	3,080,225	-2,757,450
<b>IV</b>	<b>Rritja/Rënia neto e Mjeteve monetare</b>	<b>6,160,450</b>	<b>-6,052,550</b>
<b>V</b>	<b>Teprica në fillim të vitit ushtritor</b>	-	-
<b>VI</b>	<b>Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtritor</b>	-	-

Tabela 16

**Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto, formati 4**

Numër llogarie	Emërtimi		Rezultatet e Ushtrimit	GJITHSEJ
			Tepricë/Deficit	Aktive/Neto Fonde/Neto
			5	6
<b>101</b>	<b>LAKTIVET NETO/FONDET NETO</b>	<b>22,788,961</b>	<b>31,233,880</b>	<b>54,022,841</b>
	<b>II.NDRYSHIMET NË AKTIVET/FONDET NETO</b>	<b>-4,963,773</b>	<b>-17,953,683</b>	<b>-22,917,456</b>
	<b>I.NGA BURIME TË BRENDSHME</b>	<b>-4,963,773</b>	<b>-17,953,683</b>	<b>-22,917,456</b>
<b>105</b>	<i>Nga grantet e brendshme kapitale(+)</i>			
<b>85</b>	<i>Nga rezultatet e vitit ushtritor(+,-)</i>	<b>-4,963,773</b>	<b>7,952,671</b>	<b>2,988,898</b>
<b>115</b>	<i>Nga Fondet e veta të investimeve (+,-)</i>			
<b>1013</b>	<i>Nga konsumi i AAGJ(-) Amortizimi</i>		<b>-25,906,354</b>	<b>-25,906,354</b>
	<b>2. NGA BURIME TË JASHTME</b>			



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

106	Nga grantet e Jashtme kapitale(+)			
	<b>TOTALI I FONDEVE TË VETA (I+II)</b>	<b>17,825,188</b>	<b>13,280,197</b>	<b>31,105,385</b>

Tabela Nr.1

Nr.rendor	Nr.fletëhyrjes/ datë	Shërbimi	Dokumenta bashkëngjitur	Mungesa
1.	Fletëhyrja Nr. 1, datë 13.10.2020	Furnizim me karburant	Marrëveshja me AKZM	
2	Fletëhyrja Nr. 2, datë 1.12.2020	Materiale Kancelarike	Procesverbal për marrjen në dorëzim , faturë tatimore	
3.	Fletëhyrja Nr.3, datë 14.12.2020	Blerje tonera	Procesverbal për marrjen në dorëzim , faturë tatimore	
4.	Fletëhyrja Nr.1, datë 03.03.2021	Materiale kancelarike	Procesverbal për marrjen në dorëzim , faturë tatimore	Mungon shuma totale në fletëhyrjen
5.	Fletëhyrja Nr.2, datë 01.04.2021	Materiale pastrimi	Procesverbal për marrjen në dorëzim , faturë tatimore	Mungon shuma totale në fletëhyrje
6.	Fletëhyrja Nr.3, datë 01.04.2021	Blerje naftë	Procesverbal për marrjen në dorëzim, faturë tatimore	
7.	Fletëhyrja Nr.4, datë 26.04.2021	Blerje bateri dhe goma makinash	Procesverbal për marrjen në dorëzim , faturë tatimore	
8.	Fletëhyrja Nr.5, datë 17.05.2021	Riparim automjeteve	Procesverbal për mbikqyrjen e realizimit të shërbimit të riparimit të automjeteve, faturë tatimore	
9.	Fletëhyrja Nr.6, datë 23.09.2021	Blerje tonera për printer	Procesverbal për marrjen në dorëzim , faturë tatimore	
10.	Fletëhyrja Nr.7, datë 25.11.2021	Fletëpalosje	Procesverbal për marrjen në dorëzim , faturë tatimore	
11	Fletëhyrja Nr.1, datë 1.06.2022	Materiale pastrimi	Procesverbal për marrjen në dorëzim	Mungon fatura tatimore
12.	Fletëhyrja Nr.2, datë 14.07.2022	Mjete kancelarike	Procesverbal për marrjen në dorëzim	Mungon fatura tatimore
13.	Fletëhyrja Nr.3, datë 22.09.2022	Blerje naftë	Procesverbal për marrjen në dorëzim	Mungon fatura tatimore

Tabela nr.2.

Nr	Nr. Fletëdaljes/datë	Shërbimi	Dokumentat bashkëngjitur	Mungon
1.	Fletëdalja Nr.1 , datë 2.11.2020	Marrje naftë		Mungon kërkesa, konfirmimi i titullarit, urdhërdorëzimi
2.	Fletëdalja Nr.2 , datë 4.11.2020	Marrje naftë		Mungon kërkesa, konfirmimi i titullarit, urdhërdorëzimi
3.	Fletëdalja Nr.3 , datë 9.11.2020	Naftë		Mungon kërkesa, konfirmimi i titullarit, urdhërdorëzimi
4.	Fletëdalja Nr.6 , datë 3.12.2020	Naftë		Mungon kërkesa, konfirmimi i titullarit, urdhërdorëzimi
5.	Fletëdalja Nr.8 , datë 9.12.2020	Naftë		Mungon kërkesa, konfirmimi i titullarit, urdhërdorëzimi
6.	Fletëdalja Nr.11 , datë 23.12.2020	Mjete kancelarike	Plan shpërdarjeje	Mungon kërkesa, konfirmimi i titullarit, urdhërdorëzimi



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

7.	Fletëdalja Nr.12 , datë 23.12.2020	Mjete kancelarike	Plan shpërndarje	Mungon kërkesa, konfirmimi i titullarit, urdhërdorëzimi
8.	Fletëdalja Nr.16 , datë 23.12.2020	Toner	Plan shpërndarjeje	Mungon kërkesa, konfirmimi i titullarit, urdhërdorëzimi
9.	Fletëdalja Nr.15 , datë 09.06.2021	Kancelari	Kërkesë	Nuk ka konfirmim nga titullari, plan shpërndarjeje, urdhërdorëzimi
10.	Fletëdalja Nr.16 , datë 14.06.2021	Mjete kancelarike	Kërkesë	Nuk ka konfirmim nga titullari, plan shpërndarjeje, urdhërdorëzimi
11.	Fletëdalja Nr.18, datë 09.07.2021	Mjete kancelarike	Kërkesë	Nuk ka konfirmim nga titullari, plan shpërndarjeje, urdhërdorëzimi
12.	Fletëdalja Nr.19, datë 13.07.2021	Materiale pastrimi	Kërkesë	Nuk ka konfirmim nga titullari, plan shpërndarjeje, urdhërdorëzimi
13.	Fletëdalja Nr.23, datë 24.09.2021	Mjete kancelarike	Kërkesë	Nuk ka konfirmim nga titullari, plan shpërndarjeje, urdhërdorëzimi
14.	Fletëdalja Nr.1, datë 22.02.2022	Mjete kancelarike	Kërkesë	Nuk ka konfirmim nga titullari dhe plan shpërndarjeje
15.	Fletëdalja Nr.3, datë 22.02.2022	Toner	Kërkesë	Nuk ka konfirmim nga titullari, plan shpërndarjeje, urdhërdorëzimi
16.	Fletëdalja Nr.6, datë 22.02.2022	Mjete kancelarike	Kërkesë	Nuk ka konfirmim nga titullari, plan shpërndarjeje, urdhërdorëzimi.
17.	Fletëdalja Nr.10, datë 18.04.2022	Toner	Kërkesë + konfirmim nga titullari	Nuk ka konfirmim nga titullari, plan shpërndarjeje, urdhërdorëzimi.
18.	Fletëdalja Nr.13, datë 16.05.2022	Mjete kancelarike	Kërkesë + konfirmim nga titullari	Nuk ka konfirmim nga titullari, plan shpërndarjeje, urdhërdorëzimi
19.	Fletëdalja Nr.19, datë 29.08.2022	Mjete kancelarike	Kërkesë + konfirmim nga titullari	Nuk ka konfirmim nga titullari, plan shpërndarjeje, urdhërdorëzimi
20.	Fletëdalja Nr.25, datë 05.10.2022	Mjete kancelarike	Kërkesë + konfirmim nga titullari	Nuk ka konfirmim nga titullari, plan shpërndarjeje, urdhërdorëzimi

**Tabela 1. Lista e bashkive me mbi 10 milionë lek të ardhura,**

Nr.	Bashkia	Sipërfaqja fond pyjor (Pyje e Kullota ) ha	Të ardhura nga pyjet dhe kullotat, lek 2019+2020	Investimet e parashikuara për vitin 2021 në lek
1	Has	33,860	6,197,469	16,276,089
2	Fier	4,141	902,600	9,900,074
3	Himarë	43,326	4,200,000	8,033,442
4	Mat	35,160	6,481,554	8,000,000
5	Pukë	45,775	6,802,722	7,076,400
6	Dimal	2,137	6,506,000	6,694,000
7	Rrogozhinë	208	1,872,366	6,000,000
8	Lushnje	956	50,200	5,169,000
9	Maliq	34,070	9,186,000	5,140,000
10	Memaliaj	17,722	4,107,000	5,085,413



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

11	Dibër	36,662	7,256,111	4,652,311
12	Librazhd	37,803	107,195,000	3,140,000
13	Pustec	709		2,000,000
14	Vlorë	11,201	1,855,000	2,000,000
15	Fushë-Arrëz	49,305	10,399,323	1,650,000
16	Tiranë	38,443	20,312,655	1,500,000
17	Shkodër	48,657	3,588,000	1,340,262
18	Mallakastër	12,948	7,556,078	1,282,800
19	Roskovec	3,165		1,087,000
20	Durrës	6,205	1,687,474	3,700
21	Lezhë	20,783	204,000	705
22	Berat	16,402	3,671,000	400
23	Selenicë	26,900	10,695,907	300
<b>Totali</b>				<b>96,031,896</b>

**Tabela 4. Planet e mbarështimit.**

ON R	Emri i bashkise	Siperfaqja ha	Siperfaqja fond pyjor (Pyje e Kullota) ha	Nr. I Ek pyjore transferuar me VKM 433	Nr. I Ek pyjore te riorganizuar nga bashkete per vitin 2022	PM aktive	PM proces	PM per tu hartuar	% e mbulimit me plane mbarështimi
1	Belsh	19644	1,727	4	4			4	0
2	Berat	37998	16,402	8	5		5		100
3	Bulqizë	67851	43,210	19	19			19	0
4	Cërrik	18965	5,497	8	8			8	0
5	Delvine	18290	12,852	3	3			3	0
6	Devoll	45327	13,644	6	4			4	0
7	Dibër	93788	36,662	10	10			10	0
8	Dimal	15656	2,137	3	3			3	0
9	Divjake	30958	710	1	1			1	0
10	Dropull	44825	25,475	5	5	1		4	20
11	Durrës	33830	6,205	7	7			7	0
12	Elbasan	87203	54,979	16	16	2	4	10	38
13	Fier	61990	4,141	14	14			14	0
14	Finiq	44120	21,913	7	6			6	0
15	Fushe-Arrez	54042	49,305	18	18		2	16	11
16	Gjirokastër	46925	22,716	5	5			5	0
17	Gramsh	73922	54,103	21	13		5	8	38
18	Has	39962	33,860	4	4	4			100
19	Himare	57194	43,326	5	5			5	0
20	Kamez	3718	155	1	1			1	0
21	Kavaje	19881	2,455	5	5			5	0
22	Këlcyre	30465	12,940	3	3			3	0
23	Klos	35748	23,254	11	11			11	0
24	Kolonjë	84606	48,810	15	15		2	13	13
25	Konispol	22188	11,903	2	2			2	0
26	Korçë	80599	47,827	16	12	2	5	5	58
27	Krujë	33902	9,164	8	7			7	0
28	Kuçovë	16023	3,668	2	2			2	0
29	Kukes	93386	41,616	13	12			12	0





## Kontrolli i Lartë i Shtetit

### Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

30	Kurbin	263	12,077	7	5			5	0
31	Lezhe	50910	20,783	8	6	1		5	17
32	Libohove	24824	3,574	2	2			2	0
33	Librazhd	79336	37,803	14	14	8		6	57
34	Lushnje	37272	956	4	4			4	0
35	M. Madhe	95101	66,168	18	18		10	8	56
36	Maliq	65634	34,070	18	7		7		100
37	Mallakastër	32919	12,948	12	12	1		11	8
38	Mat	49350	35,160	10	10			10	0
39	Memaliaj	37207	17,722	3	3			3	0
40	Mirdite	86971	71,115	24	24		1	23	4
41	Patos	8255	683	4	4			4	0
42	Peqin	19779	7,907	6	6			6	0
43	Përmet	60195	18,433	8	8		1	7	13
44	Pogradec	59477	26,356	15	13	1	1	11	15
45	Polican	27202	12,254	6	6			6	0
46	Prrenjas	32295	16,240	7	7	1	1	5	29
47	Puke	50553	45,775	14	14			14	0
48	Pustec	19868	709	1	1			1	0
49	Roskovec	11801	3,165	2	2			2	0
50	Rrogozhine	22350	208	3	3			3	0
51	Sarandë	5896	1,292	1	1			1	0
52	Selenicë	56124	26,900	6	6			6	0
53	Shijak	9219	427	3	2			2	0
54	Shkoder	87271	48,657	14	14	2		12	14
55	Skrapar	83144	37,544	13	13			13	0
56	Tepelene	43124	29,340	4	4			4	0
57	Tiranë	111,003	38,443	19	9	6		3	67
58	Tropoje	105,730	59,174	14	14			14	0
59	Vau i Dejes	49909	31,118	17	17		2	15	12
60	Vlorë	61685	11,201	4	4		1	3	25
61	Vore	8272	1,791	4	4			4	0
	<b>TOTAL</b>	<b>2805945</b>	<b>1,380,650</b>	<b>525</b>	<b>477</b>	<b>29</b>	<b>47</b>	<b>401</b>	<b>16</b>



## Kontrolli i Lartë i Shtetit

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë

**Tabela 5. Mbulimi i territorit me plane mbarështimi**

NR	Emri I bashkise	Siperfaqja fond pyjor (Pyje e Kullota ) ha	Nr. I Ek. pyjore te riorganizuara nga bashkite per vitin 2022	PM aktive	PM ne proces	PM per tu hartuar	% e mbulimit me plane mbarwshtimi
1	Berat	16,402	5		5		100
2	Has	33,860	4	4			100
3	Maliq	34,070	7		7		100
4	Tiranë	38,443	9	6		3	67
5	Korçë	47,827	12	2	5	5	58
6	Librazhd	37,803	14	8		6	57
7	M. Madhe	66,168	18		10	8	56
8	Gramsh	54,103	13		5	8	38
9	Elbasan	54,979	16	2	4	10	38
10	Prenjas	16,240	7	1	1	5	29
11	Vlorë	11,201	4		1	3	25
12	Dropull	25,475	5	1		4	20
13	Lezhe	20,783	6	1		5	17
14	Pogradec	26,356	13	1	1	11	15
15	Shkoder	48,657	14	2		12	14
16	Kolonjë	48,810	15		2	13	13
17	Përmet	18,433	8		1	7	13
18	Vau i Dejes	31,118	17		2	15	12
19	Fushe-Arrez	49,305	18		2	16	11
20	Mallakastër	12,948	12	1		11	8
21	Mirdite	71,115	24		1	23	4